

Një nga romanet e shkurtra më të mëdha të shekullit XX, në një botim që shënon 115-vjetorin e lindjes së autorit, me një përkthim të ri nga Mira Meksi.

ERNESTO SABATO "TUNELI"

Ceremonia e dorëzimit të çmimit "Kadare" ishte madhështore dhe krejt e pazakontë, në një sallë të madhe të Piramidës ku, mes dhjetëra njerëzve të kulturës të ardhur nga të gjitha trevat shqiptare, mes të cilëve edhe Kadareja, por edhe të shumë personaliteteve të huaja të kulturës, Sabato shpalli se tani që kishte parë malet e Shqipërisë e kish hequr, më në fund, "pengun" e jetës së tij dhe ndihej krenar për origjinën e nënës së vet... (fragment nga pashënia e Mira Meksit)



Fjalë e mbajtur në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave
Namik Dokle,
libër jete në (fq. 5)
80-vjetorin e lindjes

Nga Akad. Prof. Dr. Vasil S. Tole

Krahas vlerave njohëse, besojmë se trilogjia "Atje ku dielli lind dy herë-Saga e Gorës", krahas lexuesve të zakonshëm, do të vazhdojë të tërheqë edhe më tej vëmendjen e studiuesve, kureshtinë profesionale të historianëve letrarë dhe të kritikës sonë në përgjithësi.

SHËNIME MBI LIBRAT

Fjalori i gjuhës shqipe - një monument i kombit

Nga Prof. Dr. Begzad Baliu (fq. 8)

Kjo është vepra më e madhe shkencore me të cilën Shqipëria dhe shqiptarët brenda e jashtë saj presin të hyjnë në Europën e Bashkuar.

Anton Nikë Berisha, Martin Camaj: *Letërsia ashtë jeta ime e vërtetë* - 50 letra të Martin Camajt dhe teksti i bisedës me të në vitin 1990. ITSHKSH, Shkup 2021.

Letrat - dëshmi të rëndësishme për ta njohur mirëfilli Martin Camajn

Nga Mikel Gojani (fq. 22)

Letrat e Camajt, të shkruara kryesisht midis viteve 1979-1990, e përbëjnë bërthamën e këtij vëllimi. Ato dokumentojnë marrëdhënien e tij me Anton Nikë Berishën, me shkrimtarë dhe studiues shqiptarë, si dhe përpjekjet për botimin dhe shpërndarjen e veprave në Shqipëri dhe në Kosovë.

Përtej antologjisë poetike "Katërdhetë e nandë shpirtën në një" të Ernest Markut

Përse jo pesëdhjetë?

Nga Mark Simoni (fq. 10)

Bota si një galeri: Si arti na mëson të shohim, të kuptojmë dhe të jetojmë më bukur

Përse njerëzit e suksesshëm e njohin artin

Nga Dr. Bledar Kurti (fq. 15)



(fq. 6)

Koha kur ishte yll kinemaje *Me Bekim Fehmiun*

Nga Ibrahim Kadriu

Bekimi përballet me aq shumë dritë, prej aq shumë reflektorëve e kamerave të drejtuara kah ai. Bekimi vazhdon qeshjen dhe shikon...

Studim krahasues: "Nata me hënë" i I. Kadaresë dhe "Nderi i humbur i Katerina Blumit" të H. Bëlit
Nga Vjollca Dibra

Stefan Zweig Sekretet e krijimit artistik

Përktheu dhe përgatiti Xhevair Lleshi



(fq. 22)

BIBLIOTEKË

Roland Gjoza (fq. 14)

Pornografia

Sali Bashota (fq. 18)

Edhe kur nuk jam aty

Konstandin Dharmo (fq. 19)

Në studion e skulptorit DP

Arben Meksi (fq. 24)

Karikatura e së shtunës

Fate Velaj çel në Vjenë

ekspozitën "E kuqja

mes teje dhe meje" (fq. 12)

DUET PASIONESH NË SOLO
Një performancë e trishtë

Nga Dr. Eduard A. Skufi

Gjergj Kacarosi ishte tip i veçantë: flegmatik, i rezervuar, me edukatë e kulturë të admirueshme, i hijeshuar nga një mirësjellje fisnike. Por qysh në fillim të karrierës u përball me sfida tinëzore të fatit. (fq. 13)

Libri shqip
në Amerikë

Dërgesa të shpejta e të sigurta
brenda SHBA-së

www.albblibris.al



Një nga romanet e shkurtra më të mëdha të shekullit XX, në një botim që shënon 115-vjetorin e lindjes së autorit, me një përkthim të ri nga Mira Meksi.

ERNESTO SABATO

"TUNELI"

Parathënie nga Ernesto Sabato

Përzemërsisht, por me vendosmëri, Hans Meinke më kërkoi një parathënie për këtë vepër, duke më bërë që të përsërisja idetë e mia mbi trillimin, përpos disa anekdotave zbatimëse dhe deri dramatike, që ndoshta mund të jenë të nevojshme për lexuesit apo për të rinjtë që nisin të shkruajnë dhe kanë vështirësi për t'u botuar. Tuneli ishte romani im i parë dhe u refuzua me forcë nga botuesit, dhe deri me entuziazëm në rastin e botuesit Guillermo de Torre, çka nuk është për t'u çuditur, sepse në përgjithësi botojnë shkrimtarët që kanë përvojë botimi, njëlloj si bankat që u huajnë para atyre që vërtetojnë se nuk u nevojiten. Ç'të bëja kur përvoja ime e botimit do t'i përkiste së ardhmes? Deri kur një shpirt bamirës, Alfredo Weiss-i, e pagoi "Sur"-in për të shmangur rrënimin e kësaj shtëpie botuese të shquar, por të vogël. Nuk e kam harruar kurrë këtë gjest miqësor, sikundër edhe besimin e tij në atë që kisha shkruar, dhe mendoj se është vendi për ta kujtuar në këtë shkrim, nëse më dëgjon që nga varri.

Ndër episodet më piktoreske do të veçoj pyetjet që shumëkush më bën gjer edhe në rrugë, për të marrë vesh një herë e mirë nëse Hunter-i ishte apo jo dashnori i María-s; apo se çfarë deshi të thoshte i shoqi i saj kur i ulëriti "I çmendur!" Castel-it, pasi mësoi krimin që kishte bërë. Kur u them se nuk di më shumë se ajo që është në libër, më vështrojnë me ironi. Të tjerë këmbëngulin të marrin vesh nëse e gjithë kjo më ka ndodhur mua, sepse historia u duket absolutisht e vërtetë. U them vetëm se kurrë nuk kam vuarë njeri dhe nëse një romancier nuk është në gjendje të provokojë ndjesinë e diçkaje të jetuar, më mirë të merret me ndonjë mjeshtëri tjetër, shumica e të cilave janë më të nderuara: muratoria apo bujqësia, për shembull. Unë vetë, në mes të peripecive të dhembshme që më sollti të qenët shkrimtar, ëndërrova të kisha një oficinëz biçikletash në ndonjë lagje të panjohur, tek mendoja për kënaqësitë modeste, por të bukura, që do të më jepte rregullimi i biçikletës së një vogëlushi. Por ç'të bësh: ndryshe nga letërsia, jeta është përherë një draft dhe është e pamundur ta korrigjosh.

Përgjigjet për këto lloje pyetjesh dhe kureshtish i kam dhënë në libra, si Shkrimtari dhe fantazmat e tij, aq thellësisht sa kam mundur, ndonëse duke pasur dyshimin e trishtë se përherë janë të paplota; sepse trillimet, të paktën ato që u përpoqa të shkruaj në jetën time të trazuar, dalin nga një zonë e errët, e paqartë dhe e zhveshur nga logjika, që disa psikologë mendojnë se, në fund të fundit, mund të reduktohen në arsye. Tezë që nuk e mbështes: ashtu si ëndrrat, ato nuk reduktohen në asnjë shpjegim, sepse shprehin, në të vetmen mënyrë të mundshme, nëpërmjet simboleve të çuditshme, ato vizione që vijnë nga pjesa më enigmatike e shpirtit njerëzor.

Sido që të jetë, do t'i them disa fjalë edhe më të paplota se esetë e gjata që kam botuar, për të qetësuar sa Hans Meinke-n ashtu edhe ata që vendosin të lexojnë këtë trillim të pakëndshëm që kanë në duar. Nuk e them

nga modestia, por sepse kështu është, siç do ta shihni shpejt.

Ndërsa shkruaja Tunelin, tërhiqesha zhang nga ndjenja të turbullta dhe impulse të përkundërta, duke u ndalur i mëdyshur përpara asaj që po më dilte, aq e ndryshme nga ajo që kisha parashikuar. Qëllimi im fillestar ishte rrëfimi për një piktor që çmendej nga pamundësia e komunikimit me njerëzit, madje edhe me gruan që dukej se e kishte kuptuar përmes njëres prej tablove të tij, motiv për të cilin mendoja se do të vetëvritej. Por, sa më shumë ecja përpara, më shumë ndërlikoheshin episodet, dilnin personazhe të treta apo të katërta, piktori nuk vetëvritej dhe gjithçka shmangej nga ajo që kisha planifikuar, sepse këto fantazma krijojnë jetën e vet dhe autori duhet t'u vejë pas sado të çuditshme t'i duken reagimet e tyre, dhe sidomos kur janë të çuditshme, sepse jeta asnjëherë nuk është e arsyeshme, dhe nëse një personazh nuk bën gjëra të pashpjegueshme, i mungon

parakushti i ekzistencës, meqenëse qeniet njerëzore lëvizin përpara së gjithash nga ajo që Paskali e quante "les raisons du coeur" (arsyet e zemrës). Romanet që përllogariten ftohtësisht janë romanet policeske, ato prodhime që një ditë do të shkruhen me kompjuter, siç besoj se fabrikohen tani në Shtetet e Bashkuara, sipas studimeve paraprake të marketingut dhe mbledhjeve të bordit.

Si shkrimtar me origjinë të dyshimtë, më duhet të mbështetem te një i padiskutueshëm. Dostojevski, i shqetësuar si patriot për alkoolizmin në Rusi, vendosi të shkruante një broshurë të vogël që do ta quante Pijanecët, me qëllim për të luftuar këtë fatkeqësi, siç thuhet nëpër gazeta. I doli Krim dhe ndëshkim, që kishte të përbashkët me atë akt bamirësie vetëm sasinë e vodkaes që pinin personazhet. Është për t'u besuar, për t'u përgjigjur kalimthi disa prej pyetjeve të zakonshme, se Raskolnikov i është zëdhënësi i krijesit të tij, ngase është

protagonisti, por edhe për idetë e tij, të cilat për një çast ngajnë dyshimshëm me ato të pronarit të tij. Por në çast të fundit i doli Svidrigailovi që mishëron anën më të errët të Dostojevskit, përpara të cilit i gji student është një shpirt njeriu. Kush, pra, e përfaqëson autorin? Të gjithë dhe askush.

Ibseni tanimë e ka thënë se personazhet i dilnin nga zemra, frazë që mund ta firmosë çdo shpikës historik që nuk janë thjesht fantazi. Por kjo zemër është një lloj çmendine, ku rrëmujshtë bashkëjetojnë armiq: të mëshirshëm përkrah të pamëshirshmeve, kriminelë përballë shenjtorëve, hajdutë së bashku me qytetarë fort të nderuar. Siç e pohoi vetë Dostojevski, Zoti dhe djalli luftojnë për shpirtin e njeriut, dhe fusha ku zhvillohet kjo betejë e pafundme dhe mizore është vetë zemra e tij.


Atëherë si t'ia bëjë shkrimtari që të japë shpjegime për disa pyetje naive? Si mund të japë llogari për veprimet e personazheve të tij? Është mendimi se meqenëse dalin prej tij ai duhet të dijë gjithçka që atyre u ndodh, kuptimin e fjalëve të tyre, çfarë drejtin duan të thonë. Ndoshta do të ishte e volitshme për ata që kështu besojnë që të kujtojnë ëndrrat e liga që kanë parë, ku një i panjohur i frikshëm i ka bërë të zgjohen duke ulëritur. Por nga doli ky i panjohur nëse jo nga pavetëdija e tyre?

"Madamë Bovaria jam unë", - deklaroi Flober. Çka është e vërtetë në njëfarë mase, por e pasaktë në mënyrë groteske në masën më të madhe. Sepse, si mund të jetë ajo grua e gjorë e një mjeku fshati gjeniu që është pamatshëmrisht mbi të? E megjithatë, megjithatë, diçka nga ajo romantike patetike ka në shpirtin e krijesit të saj, diçka si karikatura e atij romantiku të madh, një mishërim në të cilin ai me dhembje tallet me vetveten, vë në lojë atë që gjithmonë ka qenë papajtueshmëria e tij me botën, ajo papajtueshmëri që është çelësi i çdo artisti, i cili për këtë arsye krijon një tjetër realitet, krijon një botë që nuk ekziston, në vend që të kopjojë këtë tjetrin të tmerrshëm, budalla, të ndyrë, vulgar, mediokër, të mangët, qesharak, që i ka dhënë fati. Arsyet pse artisti i vërtetë asnjëherë nuk krijon një "pasqyrim" të realitetit, siç këmbëngulte ngathtëzi Plejanovi, por, si ëndrra, një akt antagonist ndaj kësaj bote që e urren. Për Platonin, që me raste kundërshtoi veten, Zoti krijoi Idenë e tryezës, zdruckthetari bën me dru një imitim të trashë të saj dhe një piktor i keq një kopje të këtij imitimi. Është fati i trishtë i gjithë artit natyralist që në mënyrë simetrike mrekullonte Stalinin dhe Hitlerin, të cilët Matisse-in, Soutine-in, Braque-un dhe Rouault-in i konsideronin si shpirtat të degjeneruar që nuk dinin, përveç kësaj, as të riprodhonin mollët që hamë; pa u shkuar mendja se ato që pikturojnë këto lloje qeniesh nuk janë për t'u ngrënë, por për të shprehur refuzimin e tyre ndaj universit të jashtëm, për të shfaqur botën e tyre të brendshme, përherë një lloj autobiografie. Gjer në atë masë sa kur sodisim për herë të parë që larg, pa e parë ende firmën, një qiri mbi një karrige xunkthi, zakonisht themi: "Kjo me siguri është e Van Gogh-ut", në vend të frazës në thelb të saktë: "Ky është Van Gogh-ut", shpirti i tij i munduar.

Po, sigurisht, atëherë Flober i kish të drejtë të deklaronte: "Madamë Bovaria jam unë." Por duhet të kish shtuar se ishte edhe dr. Bovaria, se ishte gjithashtu, në mënyrë qesharake dhe të neveritshme, ai dashnori i Emës me retorikën e tij të rreme dashurore, tallje zyrtane që shkrimtari i bën vetë pasionit të tij për fjalët, ai pasion që është karakteristikë e shumicës së shkrimtarëve dhe në të njëjtën kohë, tundim i frikshëm të cilit duhet t'i ruhesh si djallit. Çka shpjegon se ka shumë shkrimtarucë dhe kaq pak shkrimtarë të vërtetë. Sepse, siç ka thënë paharrueshëm Niçja, mund të shkruhet diçka me vlerë të vërtetë vetëm kur nis ta kesh neveri letërsinë. Është si ajo që ndiejnë shpirtat e vërtetë fetarë për disa klerikë.

Santos Lugares, verë 1990

ERNESTO SABATO



Përkthim i ri nga origjinali: Mira Meksi

OnufriRoman

Testamenti shpirtëror i Ernesto Sabato-s

Shkrimi që Ernesto Sabato i dërgoi Mira Meksit në vitin 1996, përpara vizitës së tij në Tiranë.

Më quajnë Ernesto, sepse, kur u lindi, më 24 qershor 1911, ditën e lindjes së Shën Huanit, sapo kishte vdekur tjetri, Ernestoja i vërtetë, ai, të cilin ime më, edhe kur u plak, vazhdoi ta thërriste Ernestito, sepse vdiq kur ishte ende ferishte. Nuk më kujtohet ta kem parë ndonjëherë time ëmë duke qarë – kaq stoike dhe burrërore ishte gjatë tërë jetës së saj – megjithëse, ndoshta, me siguri, duhet të ketë qarë fshehurazi. Dhe ishte 90 vjeçe kur e përmendi për herë të fundit atë vogëlush, me sytë të mbushur me lot. Kjo vërteton se vitet, fatkeqësitë, zhgënjimet, jo vetëm që nuk e lehtësojnë harrimin, siç kujtojnë njerëzit, por për gjërat thelbësore dhe të dhembshme, fatkeqësisht, e theksojnë ca më tepër kujtimin.

Ai emër, ai varr, gjithmonë patën për mua diçka mbrëmësore dhe ndoshta kaqenë shkaku i kësaj ekzistencës sime kaq të vështirë, të halucinacioneve të mia, të somnambulizmit tim në fëmijëri. Një ekzistencë e mbushur me kërkime të pashpresa, duke marrë shpesh udhë të gabuara – në mes të pyllit të errët – i verbuar nga dyshimet, pasionet dhe nevoja për diçka të sigurt, një nga ato faret e largëta në mes të një furtune në errësirë. Introversioni dhe melankolia ime, kjo melankoli që më ka pritur përherë kur merrte fund një eufori e pashpjegueshme, transformohej, befasi, në mallkime, sarkazma dhe ironia, shpesh të padrejta. Sa? Por, a s'që fjala ironi një nga fjalët më të pëlqyeshme të romantikëve gjermanë? A nuk u strehova që adoleshent tek ata poetë? A nuk pelegrinuam me Matildën, përpara shumë, shumë vitesh, në vendet ku ata jetuan, studiuam dhe u shuan?

Njeriu nuk është qenie logjike, është qenie lojcake dhe paradoksale, shkon dhe vjen mes ndjenjave të përkundërta, duke vrapuar si i çmendur apo si i pavetëdijshëm nga një ekstrem në ekstrem tjetër. A nuk janë, vallë, shpirtra fetarë ata që vjellin blasfemi kundër Zotit? E ç'mund të bëjnë tjetër këta të gjerë, përveçse të fshihen tek arti? Dhe shpesh jo në fund të jetës së tyre, por në adoleshencë, kur fillon t'u dhembë jeta atyre që nisin udhën drejt shkatërrimit të idealeve që kanë, pasi kanë braktisur strehën e ngrohtë të barkut të nënës dhe më pas, pasi kanë kapërcyer vitet e para të jetës, periudhën kur riprodhojnë kohët e para të specit, kur bëhen qeniet arkaikë të kohës sonë, ato qenie të cilat arroganca e erës moderne i quan të egra, ata që jetonin në harmoni me kozmosin dhe perënditë e tyre; ëndrrat e të cilëve nuk ishin vetëm ato të natës, porse ëndrrat zgjuar a gjysmëzgjuar të miteve dhe legjendave të tyre kur pikturonin skena të mrekullueshme, magjepsëse, nëpër shpella, që aq shumë i ngjajnë barkut të nënës. Njëlljo si ata të vegjlit që nisin të pikturojnë vizionet e tyre magjike, në të cilat nëna është më e madhe se një shtëpi, që e kanë të lehtë të mos përfillin proporcione dhe perspektivën, gjersa shkolla fillore i kthen në mediokër, kur nisin të zbulojnë falsitetin e të rriturve.

Jeta, jeta jonë, është plot e përplot me gënjeshtër, përveç artit të madh, sepse ai rrjedh nga pavetëdija, nuk gënjen kurrë. Por është tepër e vështirë të thuash gjithmonë të vërtetën; nuk është hipokrizi, por mirësi, t'i thuash një gruajë të dhembshur se është e shëmtuar. Por nuk duhen gënjerë fëmijët, adoleshentët që fillojnë të zbulojnë se të rriturit jetojnë në gënjeshtër dhe mistifikim. Një nga shkaqet e terrorizmit. Nuk duhen



Ernesto Sabato dhe Mira Meksi, Tiranë, 16 prill 1996

gënjerë qenie si Nënë Tereza, as qenie si donkishotesku Guevara, që nuk e braktisin më kot burokracinë për të kërkuar atë të cilën Rilke do ta quante vetëdëkje, në një luftë të çmendur në xhunglën boliviane, i sëmurë nga astma, që të përfundonte, pa pasur shërim për dhembjen e tij, i vrarë dhe i masakruar nga kafshë të pamëshirshme e të neveritshme. E ç'më duhet materializmi i tij dialektik, sepse e tërë kjo provon pafajësinë e tij, autenticitetin e tij; luftonte për njeriun e ri, në mes të këtij batakut. Kjo është madhështia e tij, që disa e konsiderojnë si budallallëkun e tij.

Po u afrohen tashmë të tetëdhjetepastave. E si të mos e vras mendjen për fundin enigmatik kur të mos mundem më të pikturoj gjithçka që ëndërroj, shumë më

tepër se ajo që kam arritur gjer më sot? Këtë dëshmi, apo epilog, apo testament shpirtëror – si të doni ta klasifikoni – po e gdhend në saje të kujtesës digjitale të makinës sime të vjetër të shkrimit, pasi drita e syve po më shuhet gjithashtu. Nën presionin e dashur dhe deri këmbëngulës të miqve të mi, pothuaj sikur të më akuzonin se po bishtnoj një detyrë, po i shkruaj këto faqe, të cilat, edhe pse pa ndonjë farë rregulli, mund të ishin të dobishme – më sigurojnë miqtë e mi – për shumë njerëz në këtë botë të minuar nga pabesia; sidomos për ata adoleshentë që me anë letrash më pyesin se ku po shkojnë, jo vetëm në këtë vend të shkatërruar, por në të gjithë botën. Dhe për kuptimin e ekzistencës. Në një arkiv ku koleksionoj letra, artikuj

të prerë që më ndihmojnë të jetoj, kam një fotografi të tërmetit që shkatërroi qytetin e Concepción-it të Kilit – një indiane e gjerë, pasi e ka ngritur në këmbë kasollen e saj, po fshin me fshesë copëzën e tokës që ndodhet para kasolles. Dhe njeriut i mbijnë në kokë pyetjet teologjike! A ka gjë më demonstrative se kjo indianë e gjerë që fshin shtëpinë, që u thërret fëmijëve të saj, në vend që të vetëvritet?

Po i shkruaj këto radhë sidomos për adoleshentët dhe të rinjtë, por edhe për ata që, si unë, i afrohen vdekjes dhe pyesin veten se përse kemi jetuar dhe duruar, ëndërruar, shkruar, pikturoar... I shkruaj këto radhë, sepse brendësia ime më e thellë, më misteriozja dhe më irracionale, më detyron ta bëj. Dhe ndoshta – sa shumë ndoshta do

Koha Jonë 19
Kulturë
E Mërkurë 17 Prill 1996

Shkrimtari i madh në intervistë për "Koha Jonë" në Paris

Sabato: "Gjithnjë ëndërroja vendin e të parëve"

Nga Ernesto Sabato, kisha lexuar kohë më parë një tregim të botuar në shqip si dhe librin e fundit të tij "Enjëlli i errësirave", një roman tronditës, që më 1977, ishte shpallur në Francë si libri më i mirë i huaj i atij viti. Mikja e Sabato, shkrimtarja Mira Meksi, drejtuese e fondacionit "Vela", i cili e ka thuar Sabato në Tiranë për të marrë çmimin "Kadare", më kishte telefonuar para ca ditësh se Sabato kishte ngritur në Paris, për të ardhur me pas në Shqipëri. Menjëherë, e kërkova në telefon, në hotelin e tij, dhe në linjë degjova zërin e shtruar, të ngrohtë por të lodhur të Sabato: "Një intervistë për "Koha Jonë"... Me shumë dëshirë!"

Etakova të nesërmen pasdite, në hotel "Le Madison", në oborrin e të cilit është monumenti i Diderot. Përballë duken kafeneja e njëjta "Les Deux Magots" si dhe kisha e Saint-Germain, kisha më e vjetër e Parisit, edhe në katedralja e famshme e "Notre-Dame". Një hotel ku ai vinte që prej njezet vjetësh dhe që i kujtoonte vitet e rinisë kur studiojonte në Paris dhe kur mbledhjeve kalonte në kafenë të këshimit ku takohet me shkrimtarë të tjerë.

dimet e mesme ai i kreu në një kolezh të La Plata-s, larg familjes, ndërsa ato Universitare në Buenos Aires. Në vitin 1938, si doktor i shkencave fizike e matematike të universitetit të La Plata-s, ai mori një bursë nga Shoqata për Progresin dhe Shkencën, e drejtuar nga prof. Housay, "Çmimi Nobel", për të mundët që të studioje rreth radioaktivitetit në Francë. Kështu ai u nis të punonte pranë laboratorëve të Marie dhe Jelliot Curie, në Paris. Më 1945, botoi romanin e tij të parë "El Tunnel" dhe vlerësohet me çmimin e parë për letërsinë në Buenos Aires. Më 1948, shkrimtari Albert Camus, merret me botimin e këtij romani në gjuhën frëze, botim i shtëpisë botuese "Gallimard" çka e bërë atë menjëherë të njohur në të gjithë botën letrare. Pas një sërë shkrimesh e librash kritikë dhe ese, ai botoi romanin e tij të dytë "Alejandra" apo "Sobre los... y tombs", i cili vlerësohet me disa çmime ndërkombëtare. Më 1974 botoi librin e tij të tretë të rëndësishëm "Abaddon el Exterminadas" apo "Enjëlli i errësirave", duke u vlerësuar me Çmimin e Madh të Nderit të shoqërisë së shkrimtarëve në Tiranë.

Kalabri, nën mbrojtjen e mbretit të Napolit, mik dhe aleat i Skënderbeut, ishte edhe familja e nënës sime, e cila u vendos fillimisht në Santa Martino de Finita (përpara qytetit Santa Martino de Finito). Mbraj mend që gjysheja e nënës sime quhej Maria Gjusepina e San Marcos (ishatë ku jetonin në atë kohë), një grua e hekurit dhe me karakter të fortë, por edhe një femër e mrekullueshme. Kur nëna ime ishte martuar, ajo i kishte dhënë një unazë të vjetër të familjes me inicialet M.S. pra San Marco. Këtë unazë, nëna ime, para se të vdiste ja dha gruas sime, Matildë, ndërsa ajo, tashmë ja ka dhënë mbesës sime që quhet Marina Sabato. Kështu kjo unazë e vjetër shqiptare shëngëton nga brezi në brez.

-A e keni vizituar ndonjëherë atë vend?

-Po, kisha shumë dëshirë të njihja vendbanimin e herëshëm të të parëve të mij dhe prandaj dhe e kam vizituar. Tashmë dua të kthehem edhe një herë, ndoshta për herë të fundit. Dua të shkoj në kujtim të nënës sime që e thërrisja "mama", dhe ta shoh patjetër atë fshat. Historia e gjyshe sime është interesante. Një sh-cr në një njeri gjysëm i verbër. Unë nuk mund të lexoj, kështu i jam kthyer pasionit tim të dikurshëm, pikturës, ku në tablo të mëdha mund të heh vizionet e mia. Unë e takova Kadarenë, para jush, më duket sa një tip timid, aq edhe një personazh i fortë, me një personalitet të fuqishëm. Kam dëgjuar shumë për jetonin e veprave të tij.

-Kam parasysh jetën tuaj të vështirë dhe në veçanti në momentet e diktaturës ushtarake në Argjentinë. Përse ju nuk ikët nga Argjentina në atë kohë të errët dhe të kërkoni strehim politik në Francë apo gjatë?

-Detyra ime ishte që qëndroja, edhe pse e dija se rrezikojja. Nuk di se si kam mbetur gjallë. Me sa duket ata e kuptuan se nuk mund të më zhdoknin se kjo do të kishte një eho ndërkombëtare. Megjithatë ata shumë herë më kanë kërcënuar me vdekje. Madoje më kanë kërcënuar edhe me vdekjen e nipit tim. Me kujtohet një ditë kur një nga djemtë e mij më tha: "Te mos harrojnë baba, se ka 30 milion njerëz që nuk mund të ikin nga ky vend për shkak të diktaturës..." Unë personalisht nuk mund të gjykoj për ata



"Nëna ime ishte shqiptare dhe fliste shqip. Ajo ishte si një perëndi për mua. Në Shqipëri do të kem rastin të njoh vendin e paraardhësve. Jam shumë i prekur nga ftesa që më është bërë"

edhe në Shqipëri është vendosur një sistem demokratik, padyshim mjaftë i brishtë për momentin dhe me shumë probleme që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, pluralizmin përse ai iku ashtu në mënyrë enigmatike. Sigurisht diçka ka ndodhur... Ai ishte një hero dhe njerëzimi ka nevojë për heronj të tillë.

-Ju jeni një utopist?

të gjeni në këto fletë – ju shërbejnë për të gjetur një kuptim transhendent në këtë botë të mbushur me tortura dhe gjenocid; por edhe me zogj që më gufojnë shpirtin kur i shoh që nga tryeza ime e shkrimit që pa gdhirë; me qen besnikë, me luanesha që lëpijnë ëmbël këlyshët e tyre, me lule, që shpesh janë aq të vockla, sa duhen vështruar nga shumë afër, si ato lulkat që në fshatin e fëmijërisë sime i quanin zemër nuseje, mesazhe të thjeshta që fryma hyjnore na jep për ekzistencën e saj. Si budalla u besoj simboleve dhe idealeve.


Sot, më 9 korrik, dita e pavarësisë sonë nga Spanja, më vijnë ndër mend ata që ëndërruan, ata burra që jo vetëm ëndërruan, por luftuan dhe ranë në beteja të pafundme, u torturuan e u masakruan dhe akoma më keq, vdiqën në syrgjyn, duke i marrë malli deri edhe për të metat tona. Vendosa të shkruaj këto që ende nuk e di se çdo të jenë.

Njerëz të dashur më shtynë të rrëfej përpjekjet e mia, fjalë që e vendos midis thonjzave, pasi jam harraq, andej dhe kam qenë nxënës i dobët në histori dhe gjeografi. Përherë e kam vuajtur këtë mangësi, pak të rëndësishme për gjëra jo fort të rëndësishme, por që më pengon, për fat të keq, të kujtoj poema të pavdekshme për kohën dhe vdekjen, që do të më ngushëllonin në këto çaste finale. Dhe nuk e kam fjalën vetëm për poemat në vargje, që në më të shumtën e herëve nuk janë poezi në kuptimin e madh dhe origjinal të fjalës, por për fragmente imagjinatash të mëdha, dhe deri imagjinata të tëra. Çastet kur e konsideroj veten të pavlerë. Andaj kultura ime është e pasigurt dhe e mbushur plot me vrima të mëdha, sikur të përbëhet nga gërmadha tempujsh të shkëlqyer, nga ata që u kanë mbetur copëza mes plehrash dhe bimësh të egra.

Vështroj bibliotekën time, këta mijëra e mijëra libra, të cilët s'do të mund t'i lexoj më kurrë, që më mallëngjyen, më transformuan, më ndihmuan të jetoj dhe shpejt do të më ndihmojnë edhe të vdes. Sa trishtim; i ulur në një kolltuk vështroj raftet e mbushura me libra dhe e ndiej veten si të zhveshur, si një anije e mbytur në mes të furtunës së madhe. Prandaj e shmanga titullin KUJTIME. Dhe më pas titullin KUJTIME TË NJË HARRAQLI, sepse m'u duk gati si një lojë fjalësh, e papërshtatshme për këtë lloj testamenti, të shkruar në periudhën më të trishtuar të jetës sime. Por ka edhe diçka tjetër, që ndoshta nuk i favorizon këto faqe dhe që është – madje, vazhdon të jetë – motivi i dyshimeve të mia: nuk do të kuptoni, nuk mundet të kuptoni të vërtetat e mia të fundit, më enigmatiket, por edhe më autentiket. Do të ishte si rrëfim i një jete pa ëndrrat e saj, sepse vetëm në ëndrra zbulohen të vërtetat më të mëdha. Fatkeqësisht, asnjëherë nuk kam mundur të kujtoj ëndrrat e mia, andaj edhe më kanë mbetur vetëm fantazitë e mia, që i zëvendësojnë dhe i pohojnë ato, sepse vijnë drejtpërdrejt nga pavetëdija.

Më vijnë shumë letra nga djem dhe vajza që ndodhen buzë gremine. Një 17-vjeçar më shkruante nga një qytet i Francës. U tmerrova, sepse e ndjeva se mund të vriste veten nga çasti në çast. Në letërën e tij të shkruar me dorë më fliste, në kulm të dëshpërimit, për Rimbaud-në. Iu përgjigja duke i thënë se nëse nuk vriste veten do të arrinte një ditë të ishte po aq i madh sa Rimbaud-ja. Nuk më erdhi më kurrë letër prej tij, por intuuta më thotë që jo vetëm nuk e ka vrarë veten, porse një ditë do të më vijë origjinali i njërit prej atyre librave që nuk shkruhen për të fituar para, por për të mos vdekur. Të rinjtë, veçanërisht idealistët, kanë filluar të mos besojnë më asgjë, në zgrip të një honi vdekjeprurës dhe çdoherë e më tepër po strehohen te droga, që t'u arratisen ëndrrave të liga. Përkundrazi, në kohën time, përqafonin lëvizje që tentonin në ndryshonin botën. Sigurisht që ka kriza ideologjish, por asnjëherë nuk ka për të pasur kriza idealesh: njerëzit përherë do të aspirojnë të mos ketë fëmijë që vdesin nga uria, të mos ketë popuj të shtypur nga fuqitë e mëdha, raca që përndiqen nga të tjera raca që i konsiderojnë si superiore. Gjithmonë do të jetë bukur të ekzistojnë të rinjtë që do të mbajnë gjallë shpresën. Do të më thoni se është e vështirë të kesh shpresë te diçka në këtë kohë, pse ndodhemi në një natë të ekzistencës. Është e vërtetë, por pas natës gjithmonë vjen dita, siç ka thënë Hölderlin-i; dhe kur nis të zbardhë dita dhe dëgjojmë si këndojnë zogjtë, këta shpendë kaq të pafajshëm, buron sërish shpresa, e cila buron përherë nga më e keqja, nga plehrat dhe dëshpërimi më i thellë. Nuk është diçka e re; përherë ka qenë kështu. Pas tërë atyre shkatërrimeve, pushtimeve të lahtarshme gjatë tërë historisë, pas tërë atyre torturave dhe dhunimeve të fëmijëve dhe adoleshentëve, buroi sërish jeta. Dhe sa e çuditshme, nga vuajtja mësojmë. Po, tani gjithçka është përdhosur. Ky është një motiv i rëndësishëm për t'u kthyer plot shpresë idealeve të mëdha, e rëndësishme është nevoja për të mos i hidhëruar ata që na duan dhe që do të shuheshin pas vetëvrasjes sonë. I thashë: mos harro që nuk jemi vetëm; gjithmonë do të ketë njerëz që do të vuajnë nga dezertimi ynë: një nënë, një baba, një vëlla, një mik i shtrenjtë, një qen besnik që do të mbetet në mes të rrugës. Nuk duhet të mendosh vetëm për vete, por për ata që do të mbeten pas teje. Edhe unë në rini kam dashur të vras veten, por arrita të shpëtoja, duke menduar për gjithçka thashë më sipër, për meskinitetin që po gatuaja. Dhe vazhdova të luftoja për këto ideale të shenjta, që më kanë bërë të jem krah teje në këto çaste kaq të trishta për shpirtin tënd. Më përqafoi tek u ngrit, pa më thënë një fjalë – por, a ka gjë më të bukur dhe më premtuese se ky përqafim – dhe iku pa më lënë adresën, dhe unë nuk pata mundësi t'i dërgoja një nga librat e mi, ca më të vlefshëm se këto fjalët e mia që i merr era.

Shqipëroi: Mira Meksi



Ernesto Sabato në Tiranë Pasthënie nga Mira Meksi

Origjina arbërore e nënës së Sabatos, malet e Shqipërisë si pengu i jetëvdekjes së atij që u quajt një nga tigrat e letërsisë latinoamerikane, por edhe Skënderbeu, lidhen me ekzistencën dhe historinë e çmimit letrar ndërkombëtar që u krijua nga fondacioni kulturor privat "Velija" në vitin 1995. Juria letrare prej pesëmbëdhjetë anëtarësh (kishte edhe personalitete kulturore nga Kosova dhe Maqedonia) e fondacionit "Velija", të cilin e drejtoja, e pranoi idenë time për të krijuar një çmim letrar ndërkombëtar. Mesazhi ishte i qartë për promovimin e kulturës sonë: në dialogun e madh kulturor të popujve, ku s'ka kultura të mëdha dhe të vogla, mëtonim të hynim si të barabartë mes të barabartësh. Çmimi ndërkombëtar letrar mori emrin e shkrimtarit më të madh të gjuhës shqipe, u quajt "Çmimi Kadare".

Sfida ishte shumë e madhe: duhej qëlluar në shenjë me emrin e parë, jo vetëm për t'i dhënë çmimit vlerën dhe dinjitetin që meritonte, por edhe për të krijuar traditën e tij. Emri i argentinasi Ernesto Sabato, shkrimtarit 85-vjeçar, kishte dritë hyjnore: ishte një nga shkrimtarët e mëdhenj botërorë dhe e dinim që kishte deklaruar me krenari faqe botës se kishte në deje gjak shqiptari. Në studion e tij të punës mbante një pikturë të heroit tonë kombëtar, Skënderbeut. Më kujtohet biseda ime e parë me të në telefon, mbaj mend që nuk e fshihte mallëngjimin e thellë dhe fjalët i dilnin bashkë me ngashërimet: "Nuk doja të vdisja pa parë malet e Shqipërisë, vendin dhe origjinën të nënës sime, por as që e imagjinoja se mundësia do të më vinte me anë të një çmimi letrar..." Vepra e Sabato-s asokohe ishte botuar në shqip vetëm në Prishtinë dhe *Tuneli* që unë e përktheva me një frymë u botua në Tiranë më 1996, pikërisht nga shtëpia botuese e Kadaresë, "Onufri", pas ardhjes së tij në Shqipëri.

Mes shumë peripecive, më 17 prill 1996, Sabato mbërriti në Tiranë, i shoqëruar nga Elvira Fraga, partnerja e tij: ishte personaliteti më i madh i kulturës botërore që kish shkelur ndonjëherë tokën e arbrit. Për një javë të tërë kryeqyteti njohu shumë ngjarje kulturore që lidheshin me të. Tri ditë përpara se të mbërrinte në Tiranë, Sabato i dërgoi me faks Shqipërisë, siç shprehej, *Testamentin e tij shpirtëror* disafaqësh, një lloj biografie jetësore, biografi idesh, por edhe shpirtërore njëkohësisht, që u botua në shtypin e kohës. E vendosëm në vilën e dikurshme të Enver Hoxhës, Vila 31. Aty nga mesnata më telefonoi në shtëpi i tmerruar (nuk e morëm vesh kurrë se kush ia kish thënë) që e kishim vendosur të jetonte atë javë në shtëpinë e dikurshme të diktatorit. Ndaj të gdhirë mundëm ta rehatonim në një suitë të Hotel Tiranës. Të nesërmen në mbrëmje – nuk u ndava prej tij atë javë që ai ndenji – në dhomën e verërave të restorant "Piazza"-s më besoi zëulët arsien e vërtetë përse ishte larguar për tërë natën nga Vila 31. "Nuk desha, në asnjë mënyrë, të pikturoja fantazma diktatorësh, - më tha, - sepse, domosdo, do të më duhej ta bëja".

E kam ende fletën e shkëputur nga një fletore shkollari, ku kam shkruar ngutazi një varg tangoje (që Sabato e recitoi), i cili thotë: *Ku ishte ti Zot/kur vdiq i dashuri im?* dhe ku poshtë tij, po atë mbrëmje te "Piazza", Sabato pikturoi një lule supernatyaliste. E kishte më të lehtë që në librat apo albumet që na dhuroi të vizatonte një pakogjë si përkushtim sesa të shkruante fjalë. Drita e syve ishte mpakur shumë. Mjekët ia kishin ndaluar shkrimin, tani vetëm pikturonte. Sapo kisha dalë nga një sëmundje e rëndë. Dy javë më parë kisha përfunduar radioterapinë dhe në dekoltenë time ishte e dukshme gjurma e lëkurës së nxirë prej rrezeve. Ankthi ekzistencial më kaplonte shpesh dhe kish raste kur vetë jeta vihej në pyetje. Sabato ishte, ndoshta, një nga njerëzit që e kish vuajtur më shumë në lëkurë atë gjendje. "Ma ka transmetuar ime ëmë që në bark", - më shpjegoi. - "Kur linda unë, sapo kish vdekur Ernestito-ja, im vëlla. Mora emrin e tij, bashkë me dhembjen dhe ankthin e nënës sime". Më pas më shpjegoi se romani *Tuneli*, roman psikologjik tejet i errët, nga më të dëgjuarit në botë, ishte shkruar nën ndikimin e anktheve të forta ekzistenciale. E kujtoj shpesh këshillën që më dha, madje dëgjoj edhe zërin e tij të ulët, të rëndë dhe të ngrohtë: "Dëgjo sa më shumë muzikë, Mira, që kur hap sytë në mëngjes. Dominoje nëndërgjegjen dhe shndërroji ankthet në fjalë. Hidhi në letër."

Ceremonia e dorëzimit të çmimit "Kadare" ishte madhështore dhe krejt e pazakontë, në një sallë të madhe të Piramidës ku, mes dhjetëra njerëzve të kulturës të ardhur nga të gjitha trevat shqiptare, mes të cilëve edhe Kadareja, por edhe të shumë personaliteteve të huaja të kulturës, Sabato shpalli se tani që kishte parë malet e Shqipërisë e kish hequr, më në fund, "pengun" e jetës së tij dhe ndihej krenar për origjinën e nënës së vet, ku shkrimtari Visar Zhiti i solli një grusht dhë nga trualli i arbëreshëve të Italisë që ia përndriti sytë dhe ku të gjithë, me krijues dhe dashamirës të çmimit "Kadare", iu gëzuan triumfit të tij të plotë. Shtypi i rëndësishëm botëror shkroi për ngjarjen.

Kur ia dërgova *Tunelin* në shqip, botuar nga "Onufri", i cili vonoi jo pak për të mbërritur në Santos Lugares, në Buenos Aires të Argentinës, Elvira më tregoi se i gëzohej librit si fëmijë. Kohë më pas nisëm një shkëmbim të dendur me fakte për të saktësuar kujtimet dhe mbresat e tij nga vizita në Tiranë, sidomos emrat e shkrimtarëve dhe të atyre që kishte takuar dhe që i kishin lënë mbresa. Sabato po diktonte librin-testament, të cilin e quajti *Përpara fundit*. Me Elvirën fola shpesh në telefon ato kohë, gjithmonë në funksion të librit që ishte në proces shkrimi. Ndërsa me Sabaton vetëm një herë të fundit, pasi libri ishte botuar dhe më kish mbërritur një kopje e tij në Tiranë. Më telefonoi për të më thënë se më ishte mirënjohës jo vetëm se i kisha mundësuar vizitën në dheun e të parëve, por edhe për ndihmesën e vyer për të shkruar librin *Përpara fundit*.

Në librin-testament shkruante se vokacionin për pikturën e kishte nga damari mesdhetar dhe se mund të vdiste zemërlumtur në çdo çast të ditës që pas vitit 1996, kur arriti të shihte malet e Shqipërisë, vendin e nënës së tij. U shua më 30 prill 2011, pothuaj 100 vjeç.

Kam kënaqësinë që të përshëndes këtë aktivitet në nderim të z. Namik Dokle, shkrimtarit dhe kolegut tim të Komisionit të Përhershëm të Arteve në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Ky përvjetor i rëndësishëm i jetës së tij e gjen atë me një botim të ri: "Atje ku dielli lind dy herë, Saga e Gorës". Nuk besoj se ka krenim më të bukur ditëlindjeje se sa kjo: libër për krahinën dhe njerëzit e tij të origjinës, roman i kërkesave të larta ndaj vetes si artist dhe njeri publik, bilanc jete, dijesh e përjetimesh të gjithanshme.

Disa fjalë për Trilogjinë e Gorës, nëse mund ti drejtohem shkurt. Trilogjia ka ruajtur në tërësinë e saj karakteristikat e një sage, në kuptimin etimologjik të llojit letrar: karakterin historik e legjendar, rrëfimin për fatin dhe ndodhitë e një njeriu, të një familjeje apo të një fisi a grupi etnik gjatë disa brezave. Duke e nën titulluar 'Saga e Gorës' autori i përmbahet premtimit të llojit, rrëfen në mënyrë epike, ka bazë historike të qartë, të mirë përcaktuar duke gërshetuar elementët realistë me elementë legjendarë.

"Atje ku dielli lind dy herë" është afresk i bukur e i pasur që përjetëson artistikisht jetën e Gorës, për një periudhë kohore që shkon edhe përtej fëmijërisë së autorit, pasi kujtesa e tij njerëzore është vazhdim i kujtesës së të parëve të tij të cilën mrekullisht e ka trashëguar nga vatra familjare, nëpërmjet historive të dëgjua, nëpërmjet fjalorit dhe frazeologjive tipike të zonës, nëpërmjet traditave e njohjeje më sistimore intelektuale.

Kujtesa e fëmijës-rrëfimtari, mendësia, vetëdija dhe fizionomia e të cilit strukturon dhe materializon artistikisht librin e parë, "Vajzat e mjegullës" bëhet ndërjegje e ndërlidhëse mes atyre që e jetuan realisht Gorën në të shkuarën e saj dhe mes atyre që do të ngushëllohen duke e përfytyruar, duke jetuar emocionalisht në habitatin e pasur të rrëfimeve të Namik Dokles. E thënë ndryshe, më tepër se një shekull jetë e një treve me fat të trazuar, diktuar edhe nga luftërat ndërkombëtare, ndarë mes shtetesh të ndryshme, me fizionomi të dalluar kulturore e historike është tashmë monument letrar, me ngjyra e pamje të gjallë nga pena e shkrimtarit.

Nga lartësia tragjike e këtij episodi, ndonëse është në fillim të sagës goriane, autori nuk zbret më, e ruan nivelin emocional nëpërmjet fakteve konkrete, nëpërmjet forcës së detajeve në episode gjithfarësh.

"Vajzat e mjegullës" çelet me episodin e vrasjes së arushës, ekspozimin e saj në popull dhe përfundon me pushkatimin e



Fjalë e mbajtur në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave

Namik Dokle, libër jete në 80-vjetorin e lindjes

Nga Akad. Prof. Dr. Vasil S. Tole



Mësuesit, i mbiquajtur "Djali i Shkodrës", zhdukjen e eshtrave të tij si për të përsëritur dhunimin pas vdekjes së Poetit të Madh, me ndërtimin e muranës, çdo ditë e nga një gur, sjellë fshehur prej çdo kujt, në nderim të tij, dhe me vdekjen e nënës treqind vjeçare, Majkës, si bashkim vullnetar i saj me Mësuesin, me qiellin, me yjet.

Mes këtyre dy momenteve skajore që shënojnë territoret e veprës tekste pasurohet me digresione të ndryshme, me fragmente ditari, me shënime, e mbi të gjitha me rrëfenja që zhyten sa në histori, rasti i Sinan pashës, deri në botën përrallore, herë me idile dashurore, herë me histori individësh të zakonshëm, që tek i mbrojnë doket, normat, kanunet e zonës, përgjaken, këputen, asgjësohen po aq shpesh sa dhe prej varfërisë. Një institucion i ri ligjor e shpirtëror hyn në jetën e banorë të zonës, si kudo në Shqipëri: Organizata, nënkupto: organizata e partisë; me të lidhen shpresat, ndëshkimet, projektimet shpirtërore; ORGANIZA ka hijen e rëndë të reje të zezë por shpesh herë, rrëfimet për të lehtësohen duke me penelata humorit e grotesku, sipas rastit.

Libri i dytë i trilogjisë, "Ditët e lakuriqëve të natës" e ruan frymën dhe natyrën e librit të parë, por i redukton restrospektivat në histori e në përralla, në ngjarje të jashtëzakonshme. Libri nis me "makina e internimit qëndroi poshtë dritares", dhe përfundon me shpërndarjen e fletëve të raportit shkencor të profesor Rekës, mbi dheun e freskët të varrit të një të riu që ka vdekur së fundi, edhe ai nga mungesa shkatërrimtare e dashurisë, për shkak të saj. Subjekti është më i konverguar rreth një problemi të vetëm, qendror: sëmundja në masë, epidemia: metaforë e fuqishme e një bote pa rini, pa dashuri, pa bukurinë, pa vitalitetin dhe fuqinë përtëritëse të jetës që mbart vetvetiu moshë rinore, një botë pa gjysmën e saj më e lidhur prej natyre me delikatesën dhe hijeshinë: vajzat kanë ikur aksioniste. Ky paradoks social i diktuar nga politika shtetërore sjell pasojat: merr formën e një aventure groteske për profesorin e ngarkuar ta gjejë me kërkime laboratorike, me ekzaminime në terren, me mjete shkencore origjinë e problemit, çrregullimin pandemik të zonës. Lirizmi, tragjizmi por dhe absurdi komik i japin


fizionomi origjinale këtij libri, kësaj pjese të trilogjisë.

Pjesa e tretë, "Gora pa zogj" që përmbyll sagën romanore është rrëfim për bashkëkohësinë, për një realitet social-politik që nuk po përmbillet ende: tranzicioni pas viteve nëntëdhjetë. Nëse në librin e parë kujtesa e narratorit fëmijë dhe kujtesa kolektive të çonin në ngjarje, në tipa e karaktere të mbas Luftës së Dytë Botërore deri në periudhën otomane, nëse në librin e dytë kemi një gjetje të jashtëzakonshme për dashurinë dhe femëroren rinore, në këtë libër kemi mozaikun e tranzicionit ku lulëzojnë gjithfarë vesesh e shfaqen plagë të reja sociale, përqesime të psikologjisë njerëzore por dhe të vijnësisë së jetës në trevat e të parëve, në Gorë. Afresku është i pasur, rrëfimi degëzohet e pasurohet me episode anësore që i japin veprës edhe karakter etik, edhe karakter nostalgjik, edhe përmasë poetike-zakonore, dimension i përhershëm të ky autor.

Autori luan me sukses simbolikën, kryesisht me simbolikën stigmatizuese-qesharake. Në librin e parë e parë simbol i pushtetit, krahas Organizatës është veprimtari më i shquar i saj, i quajtur Stalin, nga bashkëfshatarët; në librin e dytë, që mbulon periudhën pasuese në historinë e Gorës e të Shqipërisë, simbol pushteti është po ai, por kësaj here i mbiquajtur Skilja e kuqe. Në librin e tretë, në mungesë të një simboli përbashkues, hero qendror, në kuptimin negativ të fjalës është i quajtur Çopur Çabraku. Pagëzimi i këtij personazhi me emër jo aq të përdorshëm, të kujton emrat e disa personazheve në prozat satirike të Dritëro Agollit. Me sa duket Dokle e ka një simpati të shtrirë deri në ndikim nga miku dhe kolegu i tij letrar. Por, historia romanore nuk mbizotërohet nga e keqja, nuk modelohet nga prurjet e Çopurit; ajo pasurohet me dhjetëra episode e personazhe që e ruajnë dinjitetin, e mbartin me krenari fatin e tyre e i japin veprës, krahas pasurisë jetësore edhe thellësi morale, vlera të rralla humaniste dhe ngjyra autentike etno-zakonore.

Në mirëseardhjen e librit të ri të Namik Dokles: "Atje ku dielli lind dy herë", ky ishte një parashtrim mbresash i joni nga pozita të lexuesit që nuk dëshiron të përzihet me termat teorikë të një fushe tjetër arti, siç është letërsia fikzionale. Referuar kolegëve të mi, studiues të letërsisë, mund të themi pa hezitim se ndihet fort dora mjeshtërore në kompozimin e kësaj vepre të pasur nga ana përmbajtësore por dhe e kristalizuar qartë nga ana konceptore: harmonia mes pjesëve, në plotësim a në kontrast me njëra-tjetrën, ritmi, kadencat, kreshendot, kontrapunkti e të tjera elementë gati universalë që njohin kompozimet artistikë dëshmohen ndjeshëm në këtë vepër. Dhe për këto arsye, krahas vlerave njohëse, besojmë se trilogjia "Atje ku dielli lind dy herë-Saga e Gorës", krahas lexuesve të zakonshëm, do të vazhdojë të tërheqë edhe më tej vëmendjen e studiuesve, kureshtinë profesionale të historianëve letrarë dhe të kritikës sonë në përgjithësi.

Edhe 100 i dashur Namik!



Parapëlqej të merrem me atmosferën e ndodhur, kur ndodhi edhe ardhja e Bekim Fehmiut (1936- 2010) në ambient spektakli, të cilit i paraprinte autoriteti i artistit të madh, me arritje fenomenale aktorese, por jo edhe me moshë. Ndodhja e asaj atmosfere, e cila mund të përshkruhet si e ndodhur mbi tepih të kuq, aludim në spektaklet e Holivudit, erdhi fill pasi që emri i Bekimit kishte kapërcyer kufijtë; ishte shembulli më i mirë i aktorit të cilin e dëshironin kompanitë më të mëdha të filmit botëror, regjisorët që kishin fituar pedigrenë e të qenit të mëdhenj, artistët dhe artistet që e dëshironin partneritetin me yllin që, në mënyrë spektakulare, shndriti

E kishim për qejfi afirmimin e tij, dhe ndjenim kureshtje, bile ta shihnim, e lëre më të flisnim me të. Pavarësisht nga ndonjë takim i hershëm, nga ndonjë bashkëbisedë o pirje kafe, në vetvete zinte vend dyshimi se nuk mund të ndodhte shoqërimi i mëhershëm, për shkak të ndonjë mendjemadhësie të imagjinuar, apo edhe të mos pasjes kohë nga ana e artistit, për shkak se ai (tash e tutje) takimet do t'i kishte të reduktuara, do t'i kushtojë agjendave... por, Bekim Fehmiu ishte diçka tjetër, ishte jashtë asaj që mendonim ne me logjikë mediokritetesh. Ai ishte ndryshe, ishte i vetvetes, me vetveten, por edhe me të tjerët. Ishte me nderime të jashtëzakonshme për të vetët, kombëtarisht i ngritur mbi të tjerët, plot informacion për çdo fushë dhe i gatshëm të shprehej.

Ishte i tillë kur ndodhi ardhja e tij në pritjen që organizonte, asokohe, kryetari i Kuvendit të Serbisë, Marković, në aulën e Kuvendit, në një ambient të jashtëzakonshëm për mysafirë të jashtëzakonshëm që kishin ardhur nga gjithë bota të merrnin pjesë në festivalin ndërkombehtar të filmit që, asokohe, pra, mbahej në Beograd. Autorit i rastisi të ishte raportues, në rolin e gazetarit, nga ai eveniment i cili çmohej si ngjarje numër një në atë Jugosllavi. Ishte ftesa për artistë, producentë, regjisorë e gazetarë, prandaj nuk mund t'i kthehej shpina një spektakli të tillë, se ishte rast i veçantë për t'i parë në një vend emrat që, aso kohe, i jepnin sharmë artit të filmit në botë. Ishte Drazha Marković, domethënë kryetari i Kuvendit të Serbisë, i cili qëndronte në hyrje dhe, çdo mysafir, e priste me shtrengim dore. Ishin kamerat e shumta nga agjencitë e ndryshme

Koha kur ishte yll kinemaje

Me Bekim Fehmiun

Nga Ibrahim Kadriu

Bekimi përballlet me aq shumë dritë, prej aq shumë reflektorëve e kamerave të drejtuara kah ai. Bekimi vazhdon qeshjen dhe shikon...

të botës, por edhe të qendrave televizive, që bënin kujdestari derisa nëpër atë derë ku priste kryetari i Kuvendit, shtrengonin duart dhe hynin brenda për t'u shërbyer me uiski...Ishte e natyrshme që, gazetari i ri, që vinte nga Kosova, të ndjehej nga pak i huaj, mbase edhe i vetmuar në atë shumësi autoritetesh, por megjithëkëtë atmosfera mbyti kompleksin e të voglit, dhe jep shanse për të provuar uiskin, njësoj si gazetari i Njujork Tajmsit, si ai i Mondit, apo domethënë edhe gazetari i "Rilindjes", unë pra: ngrit gotën dhe, më pastaj zë vend në një kënd, për të parë sa më mirë se si sillet bota e spektakleve.

Në derë duket Bekim Fehmiu.

Pamja e tij me kokën lart, me shikim të kthjellët e buzëqeshje karakteristike, prej njeriut që di se në cilën shkallë të autoriteti gjendet, le përshtypje të jashtëzakonshme tek të gjithë që, me atë rast, sikur ndërprejnë bisedat, sepse ajo pak zhurmë që dëgjohej, përnjëherë heshtet. Bekimi përballlet me aq shumë dritë, prej aq shumë reflektorëve e kamerave të drejtuara kah ai. Bekimi vazhdon qeshjen dhe shikon. Për habinë time, shikimi i tij ndalet tek unë dhe, pa



hamendje, duke mos përfill askënd afër - shpejton hapat drejt meje, dhe flet shqip: - Ku je more ti, qy- qy, këtu qenke? - Bekim, - i them me ngadalë, - hajt se ti ke rrethin tënd... - Pasha bacën, askënd më afër se ty nuk kam këtu dhe as që më interesojnë... Kamerat vazhdojnë të xhirojnë, ndërkaq unë përpiqem të qëndroj larg xhirimeve, kurse Bekim vazhdon bisedën. Pyet për Prishtinën, për punët tona. Nuk do të largohet...Përball nesh, nja tre- katër hapa, vërej regjisorin Purisha Gjoprgjeviq dhe artistin Bata Zhivojinović të cilët, me

shikim, janë të përqendruar kah ne. Me siguri ishin kureshtarë të dinin kush isha unë ...

- Bekim, - i them, - po na shikojnë çuditshëm. Ndoshta mendojnë se unë (derisa nuk po na e kuptojnë as gjuhën) jam farë producenti i huaj, a farë regjisorit. - Hajt, pasha bacën mos u mërzi. Ti mbaje qëndrimin tënd, ata le të ëndërrojnë... - më tha dhe qeshi.

Ajo mbrëmje ishte më atraktivja në jetën time, jo pse unë i kisha kontribuar asaj, por pse Bekimi sillej ashtu siç sillej tërë jetën e tij: i afërt, aspak mendjemadh.

Më ndodhi mandej në sallën e Shtëpisë së Sindikatave, mbrëmjen tjetër kur ishin në program filmat e festivalit: derisa kaloja përkaj lozhave, e pashë Bata Zhivojinovićin që dilte nga një lozhë, dhe fill sa më shikoi (dhe sigurisht iu kujtova nga mbrëmja e kaluar) u përul me përshëndetje, kurse ajo përshëndetje u tha disi në gjuhë që s'e kuptova. Ia ktheva veç me kokë.

Bekimit i tregova për këtë dhe ai qeshi me zë: - Kështu ndodh përballja e artistëve servilë me producentët e regjisorët, - tha.

Pas njëzetë e shtatë vjetësh

Bekimi shpesh vjen në Prishtinë. "Kam ardhur ta vizitoj nënën", thotë, kurse ata që janë në kontakt të shpeshtë, e dine se këto vizita i realizon para fillimit të çdo projekti të tij. Ai tash gjendet në Çekosllovakia, atje diku afër kufirit çekosllovak- austriak, në brendinë e një kështjelle mesjetare, është veshur me petkat e ndonjë të njohuri në histori dhe me ato petka do të kalojë nëpër ngjarje tronditëse dhe, përmes filmit, do të dale para publikut. "Projekti është shumë interesant" - thotë. Me siguri duhet të jetë interesant, përndryshe, Bekim Fehmiu nuk do të shkonte në Çekosllovakia. Kjo mund të thuhet duke pasur për bazë përvojën e deritashme të angazhimit të tij në projekte të huaja. Sidoqoftë, ai tash është atje me angazhim, kurse para se të shkonte t'i bashkohej ekipit - erdhi në Prishtinë që ta vizitojë nënën, e cila është plakë, por ende mbahet e forte.

- Po ulemi ndokund, - i them., - po pimë, po flasim.

- Pse jo? Ma kthen.

Në shtëpitë e sipër vazhdon:

- Ai djalosh është artist i mrekullueshëm (fliste për Enver Petrovcin). Është krenar, i zoti në profesion. Rolin e fundit që e luajti në Atelienë 212, rolin e Istrefit të "Miqte" e Seleniqit, e ka shkëlqyer, si është më së miri... Ai djalosh ka talent edhe për humor, ai këtë nuk e di. E kam parë te filmi "Druvarët"... Pasha bacën, ai e ka kuptuar rëndësinë e punës...

Në kateterin e "Grand-it" i them:

- Njerëzit janë të prirë të flasin, a po? Gjithçka thonë, gjithçka them, mandej pasojnë përgjigje jo oficiale se ka të vërteta ose nuk ka të vërteta nga ato që i flasin njerëzit. Për Bekimin të gjitha duartrokitjet. Ka shumë raste që njerëzit të shtyrë nga ndjenja e shkak të adhurimit, fëmijët e tyre i thërrasin me emrin Bekim, me dëshirë që biri i tyre të përngjajë... Kurse Bekimi gjithkund arrin (me punë) vetëm në Kosovë - jo. Ja përse më intereson të bisedojmë dhe pikërisht për këtë, atë ditë kur të thirra në telefon, respektivisht në numrin 011 417 548 në Beograd, të njoftova.

- Në rregull.

- Pak më parë bisedoje për Enver Petrovcin, për rolin e tij të fundit në Teatrin e Beogradit.

- Për të nuk duhet të flitet, duhet të shikohet, patjetër duhet të shikohet.

- Mirë, pra, po e lëmë Enver Petrovcin, po të drejtohem ty: të kujtohet, sigurisht, para dhjetë vjetësh pate thënë se ishe i gatshëm të interpretoje rolin kryesor në





projektin e madh "Vëllezërit" në të cilin projekt fjala ishte për palestinezët. Ai projekt nuk u realizua kurrë.

- Nuk është i vetmi projekt që nuk është realizuar. Ka edhe shumë projekte që patën të njëjtin fat. Kështu është natyra e botës së filmit.

- E, cila është natyra jote?

- Natyra ime është të ec përpara. Nuk është realizuar projekti "Vëllezërit", por është realizuar "Bora e fundit e pranverës", mandej "Loja e së vërtetës", e të tjera projekte.

- Të gjitha jashtë kufijve, a po?

- Jashtë e brenda: "Depsi", "Pavle Pavloviqi" e tj.

- Pavle, me sa di unë, është rast i çuditshëm...

- Në çfarë kuptimi?

- Në kuptimin e paraqitjes së bashkëkohësisë. Më duket se në adresë të këtij filmi ka pasur kritika.

- Kritika ka pasur dhe në bazë të atyre kritikave është larguar nga konkurrenca oficiale e festivalit të Pulës. Tema e cila është trajtuar në atë film, që i dedikohet viteve të '72-73, është shumë aktuale, sidomos tash para Kongresit XII.

- Hymë në personalitetet e protagonistëve të filmit. Ja tash po më kujtohet filmi "Të arrish para agimit" të Aleksandar Gjorgjeviqit. Më intereson roli i Esat Lumit që e interpretove ti, a ka farë baze dokumentare?

- Kjo pyetje nuk më përket mua. Kjo pyetje u përket shokëve të cilët e kanë përjetuar atë kohë, që kanë qenë dëshmitarë të asaj kohe dhe këshilltarë të realizimit të projektit, si i ndjeri Jovan Veselinov Zharko, pastaj e shoqja Veselinov, shoku Pashko Romec, e të tjerë.

- Mandej?

- Mandej, çka?

- E lamë te 13 prilli i vitit 1978, kur e pate incidentin në komunikacion... (Para se të hynim në "Grand", rastësisht në bisedë e sipër, tregoi se si në incidentin e komunikacionit, në Bosnje, gjatë kohës kur ishte në terren për xhirim, i ishte shkatërruar krejtësisht makina "Vollvo") ... interesant se si ka qëlluar data 13, datë e pa fat, për pak fatale...

- Fatale do të ishte sikur të mbetesh aty, por po e quaj gjysmë- fatale, pasi që te unë ka lënë pasoja...

- Mirë është që ka qenë ky vetëm një rast, dhe ja tash po vazhdojmë bisedën rreth krijimtarisë...

- Prit, nuk ka qenë i vetmi rast. Janë të

çuditshme oscilimet që i pasojnë njeriut. Mua, për shembull, më ndodhi që më 1970 të sulmohem nga hepatiti viral (sarillëku) që më ndau nga aktiviteti profesional më se dy vjet. Më 1978 ishte hera e dytë. Më nuk guxoj t'i lejoj vetit "të fluturoj shumë lart". Me fjalë të tjera, duhet të mbaj mesin...

- E, pra, ka mendime këtu në Kosovë se vështirë arrihet te Bekimi. Unë nuk po them se "fluturon lart".

- Kur thashë "fluturoj lart" mendjen e kisha te grumbullimi i projekteve konkrete për realizimin e filmave. Ndërkaq, sa i përket asaj bindjes "vështirë arrihet te Bekimi" unë atë nuk e kuptova. Nëse ke menduar në sukseset e artit dramatik, demanton vetë fakti se e kemi Farukun, e në vitet e fundit edhe Enver Petrovcin...

- Ama unë mendova në diçka tjetër.

- Çka konkretisht?

- Jo rrallë këtu në Kosovë thuhet: me Bekimin nuk mund të bashkëpunohet.

- Përvoja demanton edhe këtë, sepse ndihma dhe bashkëpunimi im i deritashëm ka qenë mjaft i frytshëm në rrethanat artistike, por fatkeqësisht Bekimi ende nuk e ka pasur fatin të paraqitet edhe vetë personalisht para publikut.

- Këtë ndihmë po e kuptoj në aspektin kur të rinjtë e profesionit tënd marrin si mostër frymëzimin dhe zellin e Bekim Fehmiut.

- Jo, nuk mendova ashtu, sepse kjo është gjë personale dhe në fund të fundit relative. Mendova në kontributin tim në realizimin e "Kosova filmit", si për shembull në "Si të vdiset", në përpunimin e skenarit, formimit të tij ideartistik dhe dramaturgjik. Puna ime e fundit (gjashtëmujore) ka qenë rreth filmit "Kur pranvera vonohet".

- Kurse unë e kisha ndërmend të them se, gjatë këtyre njëzeteshtatë vjetëve të punës sdate kreative në fushën e interpretimit, asnjëherë nuk je afruar në Kosovë.

- Nuk është bash ashtu si thua, sepse, pasha bacën, pas 27 vjetësh Teatri i Prishtinës ma ka ofruar një rol.

- Dhe edhe ai rol- askund...

- Çfarë të bëj kur nuk jam i zoti që Hamletin ta përgatis për pesë javë.

- Nejse, por Bekim, është televizioni, është shtëpia e filmit dhe, beso, çdo kush dëshiron që ta shohë Bekimin qoftë në dërrasa të teatrit tonë në Prishtinë, qoftë në TV, apo në film i cili do të mbante shpicën "Kosova film".

- Ndoshta një ditë, TV apo "Kosova film" do të kenë nevojë për bashkëpunim.

- Por thonë se është vështirë të

bashkëpunohet me ty se, jo rrallë, kanë pasur kontakte...

- Edhe mua më kanë thënë: mos bre Bekim, mos puno aq shumë se na mbyte. Dhe me të vërtetë, e metë e madhe është kur njeriu+, që kuptimin e jetës e ka gjetur në punë, kërkon edhe nga të tjerët punë. Kjo me të vërtetë është e metë e madhe, a po... Dhe jo vetëm puna, sepse puna mund të tërhiqet zvarrë, por intensiteti i punës. E unë kuptimin e jetës orvatem ta gjej në punë.

- Domethënë është çështje - çështja e punës, e jo diçka tjetër?

- Nuk di, nuk di të flas për vetveten, duhesh t'i pyesësh njerëzit tjerë, të cilët kanë punuar me mua... Sigurisht se edhe unë mund të kem ndonjë të metë, si njeri, apo si aktor, për çfarë mund të mos jem koshient. Mirëpo deri më sot nuk ma ka tërhequr vërejtjen dhe nuk ma ka bërë me dije askush. Kurse unë do t'i falënderohesha çdokujt i cili do të ma tërhiqte vërejtjen.

- Unë po ta tërheq vërejtjen.

Urdhëro!

- Pse nuk ke pranuar të japësh intervistë me rastin e Hamletit si projekt teatri?

- Të kuptohemi, nuk njihemi prej sot. E di fort mirë se çdo intervistë imja ka pasur si bazë punën në ndonjë projekt, kështu që intervistat kanë ardhur pas punës së kryer. Nuk mbaj mend se ndonjëherë kam dhënë intervistë pa motiv. Prandaj edhe kjo nuk është e çuditshme, ngase nuk kam pasur çfarë të flas. Çdo gjë që kam për të thënë, e them përmes punës.

- Pse kërkon kushte të jashtëzakonshme për punë?

- Për shembull?

- Në një rast nuk e ke pranuar kërkesën e RTV Prishtinës për ta bërë portretin tënd.

- Natyrisht, për të bërë një film dokumentar për ndokënd, duhet të gjenden materiale të volitshme dhe për të njëjtën gjë duhet të ekzistojë farë skenari. Kurse unë, para dymbëdhjetë viteve, në terrenet sportive të Brezovicës, kam refuzuar një ide të tillë, duke menduar se nuk jam person për një projekt të tillë, e sidomos pasi në atë rast nuk ekzistonte kurrfarë skice dhe kurrfarë materiali tjetër parapërgatitor.

- Domethënë, me këtë rast s'ka pasur lidhje ana materiale, honorari?

- Ana materiale nuk ka paraqitur kurrfarë rëndësie. Për mua ana materiale gjithmonë ka qenë, është dhe do të jetë në vendin e tretë.

- Po e zëmë se unë jam producent.

- Unë jam aktor.

Po kërkoj që, gjithsesi, duhesh ta pranosh projektin që unë ta ofroj.

- Çka?

- Ja teksti.

- Kush e ka shkruar?

- Nuk ka rëndësi, tash për tash. Me rëndësi është se teksti ka brendi, por është anonim.

- Kush e bën regjinë?

- Unë.

Sa do të kushtojë?

- Nuk e kam bërë paralogaritë, por me siguri afro 1.200 milionë dinarë të vjetër.

- Këto para, a janë tuajat a të shoqërisë?

- Të shoqërisë.

- Apriori nuk pranoj. Pik së pari nuk ke kualifiko që të bëhesh shpenzues i 1.200 milionë dinarëve të shoqërisë, që t'i materializosh në shirit filmi, dhe nga ana tjetër, nuk e di teknologjinë e filmit. Se pa e ditur përpikërisht sa kushton një film - nuk guxon t'i hysh realizimit. Prandaj të propozoj të gjesht ndonjë regjisor me përvojë, kurse ti të marrësh ndonjë libër për të parë se ç'është filmi. Sikur të kishe thënë se do të bëje film me para tuaja private, me kusht se tema e filmit dhe roli do të ishin interesant, për mua si aktor, t'i kisha fshi paratë dhe të kisha thënë - tungjatjeta.

- Po mirë, unë u bëra modest, por ja se e kam të kryer njëfarë fakulteti të regjisë dhe me atë përgatitje po të drejtohem.

- Shumë bukur, sa lloje të objektivave të kamerave kemi sot?

- Është kusht për regji?

- E çfarë akademie të regjisë paske kryer?

- Në Beograd, në Zagreb...

- Nuk besoj!

- Kur të besosh me siguri do të vish të dalësh edhe para publikut të Kosovës, që aq shumë të pret.

- Jo "kur të besosh" por kur të mësosh.

- Eja e mësona.

- Nuk jam as Akademi, as shkollë. Jam vetëm. Jam NJË njeri.

Mandej, që domethënë në fund të bisedës, e luta Bekimin që të drekonim së bashku. - Me gjithë dëshirë, - tha, por më duhet të shkoj në shtëpi. Nëna më pret në dreqë, sepse sonte udhëtoj.

(*Kjo intervistë (bisedë e drejtpërdrejtë) është botuar në gazetën "Rilindja", më 5 prill 1982, në rubrikën Me bashkëkohësit, ku prezantoheshin figura të njohur të artit, shkencës dhe kulturës.)

Bekimi dhe trashëgimia jonë

Ditë më parë u hodh në faqen elektronike të internetit *Fjalori i madh i gjuhës shqipe*. Prej atyre që me leksikografinë merren për arsye specializimi deri tek ata që gjuhën, përkatësisht fjalët, termat, nocionet, leksikon historik a profesional të saj i kanë pasion të përditshëm të tyre, ky fjalor sigurisht do të jetë objekt leximi, vlerësimi e diskutimi, ndërsa ne mjeshtrit e tij presim më shumë ndihmesa për plotësimin, rivlerësimin e risemantizimin të secilës fjalë, secilit variant dhe madje secilit kuptim të ri në mjediset e ndryshme kulturore apo politike, arsimore e akademike, shoqërore apo profesionale, rurale apo urbane, sado sot jetohet në një botë globale të komunikimit.

Kjo është vepra më e madhe shkencore me të cilën Shqipëria dhe shqiptarët brenda e jashtë saj presin të hyjnë në Evropën e Bashkuar. Hapësira identitare shqiptare në përgjithësi dhe gjuha shqipe në veçanti hyjnë në fondin më të hershëm të gjuhëve indoevropiane, ka trashëguar leksikon e fondit të kësaj familjeje në ato përmasa që këtë e kanë bërë tri gjuhët më të vjetra të saj: armenishtja e greqishtja; ka trashëguar leksik të tri prej gjuhëve më të vjetra të Evropës: latinishtes dhe greqishtes antike; ka përcaktuar fondin bazë të leksikut të ilirishtes, pa përfshirë në këtë rast edhe leksikon anësor të trakishtes; ka trashëguar e ka huazuar leksik nga të gjitha gjuhët e mesjetës së hershme dhe të vonë (latinishtes, greqishtes e sllavishtes kishtarë); ka trashëguar dyanshëm leksik në raport me rumanishten, para se ndërmyt ilirëve dhe dakëve të hynin si një pykë historike sllavët në Ballkan. Këtë e dëshmojnë arritjet më të rëndësishme të gjuhësisë historike bashkëkohore, ndërsa ne po i referohemi vetëm botimit të fundit *Fjalori Etimologjik Proto-Indo-Evropian*, një botim i rishikuar i Julius Pokorny't, *Indogermanisches Etymologisches Wörterbuch* (2007), në të cilin, në 3441 faqe, autorët e tij nga Shoqata e Ringjalljes së Gjuhëve Indo-Evropiane, shqipes i janë referuar në kontekstin krahasimtar 2443 herë.

Fjalori i madh i gjuhës shqipe, thonë autorët e *Parathënies* së tij dhe drejtuesit e projektit njëkohësisht, Akademikët Jani Thomai e Valter Memisha, është mbështetur në rreth 600 njësi bibliografike leksikore, duke filluar nga *Fjalori i Frang Bardhit* (1635) por në themelet e tij bashkëkohore është vendosur *Fjalori i gjuhës shqipe* (1954). Pasionantët e historisë së gjuhës dhe leksikut të saj mbase do të thoshin që ky fjalor qëndron në kolanat e *Fjalorit* të Konstantin Kristoforidhit dhe për rëndësinë që ka në qytetërimin tonë, ky fjalor do të ishte mirë të hapet me një faqe përkushtesë në të cilën do të vendosej *Formula e pagëzimit* (1462) e të cilën nuk po e shohim as si shembull. Emrat e hartuesve të *Fjalorit të gjuhës shqipe* (1980), të cilët në shtypin ditor, internetik e madje shkencor shpesh zihen në gojë si shembuj të së keqes, janë aq të meritueshëm edhe për këtë vëllim, sa mund të vendoseshin në krye të tij, para redaksisë dhe hartuesve të sotëm.

Emrat e hartuesve të rinj, ndërkaq, duke qenë pjesa më e madhe e studiuesve që periudhën komuniste në Shqipëri e në ish-Jugosllavi e njohin vetëm përmes teksteve të historisë, jo vetëm nuk kanë asnjë mëkat për atë periudhë dhe përkufizimet e ndonjë fjale, termi a nocioni, por gati-gati nuk kanë mëkat as për periudhën e tranzicionit, kur komunistët, demokratët dhe sidomos neokomunistët, i ndante një vello shumë e hollë. Më në fund, fakti se sot ne gjuhën e përkufizojmë thjesht, një sistem shenjash për komunikim, kjo nuk e bën të mbyllur qarkun e perceptimit të saj në rrethana të tjera historike, politike, kulturore dhe shkencore. Se kush e vendos një fjalë, nocion a term në raport me rrethanat kur është krijuar, ndërsa *Fjalori* duke qenë normativ dhe standard, të gjitha fjalët i vendos në raport me kohën në të cilën po botohet. Kroatët shpesh e theksojnë faktin se ortografia dhe leksikografia janë tipare më radikale të gjuhësisë kroate (Vesna Požgaj Hadži), por as gjuha shqipe e cila besonim se i ka kaluar disa faza të diskutimit të ortografisë, etnografisë e politikës, duket se nuk është në gjendje më të mirë.

Struktura e Fjalorit

Fjalori i madh i gjuhës shqipe, thuhet në *Parathënien* e tij ka 125.000 njësi

Fjalori i gjuhës shqipe - një monument i kombit

Prof. Dr. Begzad Balii

Unte paghesont premenit Atit et birit et spertit senit!
Formula e Pagëzimit (1462)

leksikografike (rreth 105.000 fjalë në zëra të veçantë), rreth 12.500 njësi frazeologjike etj. Ajo që kuptojmë në fund për korpusin e pasurisë së tij është se kemi të bëjmë me rreth 250.000 kuptime leksikore, ndërsa ajo që pothuajse në krye të herës shfaqet sfidë afatgjate, për të mos thënë Thembër e Akilit është lista e 250 termave të rinj e të paasimiluar fonetikisht dhe rreth 1650 shprehje të huaja të paasimiluara, për të cilat jo vetëm presim diskutime profesionale, po edhe plotësime të tyre në të gjitha dijet, me theks të veçantë shkencat e informatikës, teknologjisë, mjekësisë, ekonomisë, politikës dhe drejtësisë.

Përfshirja e tyre nënkupton demonizimin e një leksiku që bën jetën në shoqërinë tonë, por mosdiskutimi i tyre dhe përshtatja e tyre brenda strukturave të sistemit leksikor të shqipes, dëshmon edhe për neglizhencën tonë institucionale, për mungesën e sektorëve të specializuar dhe specialistëve, të cilët me këto fjalë, nocione, terma, koncepte të përditësuar edhe në shoqërinë shqiptare, do të merreshin çdo ditë leksikografët tanë, ashtu sikur merren specialistët e gjermanishtes, frëngjishtes dhe sidomos kroatishtes me leksikon e huaj që ka hyrë në përdorimin ditor. Le të sjellim vetëm një fakt nga Zagrebi. Me të zgjedhur të kardinalit Roberta Francisa Prevosta në krye të Vatikanit, Instituti i Gjuhësisë në Zagreb reagoi për mënyrën se si duhet shkruar emri i tij i ri Leo, që sipas traditës latine të kroatishtes (nga shekulli XVI) duhej shkruar jo si Lev apo Leo, po si Leon.

Gjuha është relikta më e mirë, përmbajtja më e plotë, referenca më e saktë e identifikimit ekonomik, kulturor, historik, social e identitar për vlerësimin e një populli në një kohë a periudhë të caktuar. Profesori e ilirologu Aleksandër Stipčević, gjatë një ligjërate në Prishtinë na thoshte: nëse doni të kuptoni qytetërimin ilir, hapeni së paku një tumë dhe shikoni brenda saj. Nëse gjeni një byzylik a qafore të argjendte, ta dini se ata jetonin në kushte të mira dhe me një standard të lartë të qytetërimit grek apo romak të kohës, por nëse gjeni thjesht një shtizë dhe një guri të mprehtë, ta dini se jeta e tyre ishte tepër modeste, ndërsa qytetërimi i tyre larg prapa atij grek e romak. Historiani i gjuhës dhe njëri prej indoevropianistëve më të mëdhenj të Evropës, Ranko Matashević, në veprën e tij *Historia e gjuhëve të Evropës*, duke shkruar për pozitën qendrore të Evropës në raport me zbulimin e Amerikës dhe të Indisë e vinte theksin në "zhvillimin paralel të gjuhëve kombëtare, ndërgjegjësimin për kombësinë (etninë) e vetë folësve, si dhe në disa rrafsh të zhvillimit të brendshëm të procesit të standardizimit të gjuhës (sidomos pas Gutenbergut). Në këtë rrjedhë autori e përvijonte zhvillimin e vetëdijes etnike, gjuhësore dhe kombëtare midis folësve të gjuhëve të caktuara, zhvillimit dhe qasjeve më shkencore ndaj antikitetit dhe gjuhëve të asaj kohe, shfaqjen e shkrimleximit në gjuhët më të vogla evropiane sikur është shqipja dhe ndikimet që rezultuan nga zhvillimi i kombeve të mëdha evropiane sikur është frëngjishtja dhe rusishtja. (Neven Vulić). Të qenit të gjuhës shqipe, sado e një popullit të vogël, në qendër të Europës, për mija vjet, besoj është e mjaftueshme që të përcaktohet rëndësia dhe forca e saj për të përballuar shpërbërjen fonetike, gramatikore, semantike e sintaksore të saj.

Si i tillë, fjalori, fjalët, nocionet, termat, konceptet, sinonimet e homonimet dhe sidomos frazeologjia e fjalët e urta, të ngurtësuar për rrafshin semantik të përdorimit të objekteve të asaj kohe,

dëshmojnë për përmasën e kulturës dhe jetës së një kombi e një shoqërie në një kohë të caktuar. A nuk është pikërisht "lista e 250 termave të rinj e të paasimiluar fonetikisht dhe rreth 1650 shprehje të huaja të paasimiluara", ato që dëshmojnë kohën tonë, gjendjen tonë ekonomike, politike, kulturore e sociale e komunikimit tonë me botën.

Një vërejtje tjetër na vjen nga pasionantët e terminologjisë që vijnë nga fushat tjera të dijeve. Të qenit e autorëve, pra vetëm nga radhët e gjuhëtarëve, përkatësisht leksikografëve e leksikologëve, në një numër kaq të madh dhe sidomos mungesa e terminologjive të fushave të ngushta (ekonomisë, mjekësisë, teknologjisë, informatikës etj.), nuk do të thotë që edhe këta nuk do të përfshihen në rrugë e sipër për korpuset e fjalorëve më të mëdhenj se ky. Përkundrazi, problemi qëndron më shumë te retorika patriotike e mitizuesve metafizikë të gjuhës (pellazgologët), konceptualizimi i përmbajtjes së një njësie (mbështetur në përvojën e specialistëve) dhe etiketat e vjetra ideologjike (për bartësit e projektit). Vërejtjet tjera më duken më shumë dytësore dhe të rastit, të cilat mund të tejkalohen pa e përmblyllur kohën, nëse doni edhe "barrën nëntëmujor të lindjes" së *Fjalorit*!

Shqetësimet për mungesën e leksikut nga trashëgimia historike

Prej vitësh, një numër studiuesish, intelektualësh, profesionistësh e pasionantësh të shqipes, kanë akuzuar me të drejtë institucionet akademike dhe kanë shqetësuar pa të drejtë individë të caktuar për mungesën e një *Fjalori të madh të shqipes*, i cili do të plotësonte kërkesat profesionale, intelektuale dhe për më tej egon e tyre për një fjalor të gjithë "pasurisë kombëtare" "e planetare" të shqipes. Dhe ja, hapi i parë u realizua. Shqiptarët tani kanë gjysmën e *Fjalorit* të pasurisë kombëtare, i cili "do të krehet" edhe nëntë muaj nga shumë duar e shumë krehër të llojeve të ndryshme para se të botohet, ndërkohë që ca të tjerë kanë punuar e po punojnë për vjeljen, sistemimin dhe organizimin e një materiali po kaq të vëllimshëm për përgatitjen e *Korpusit të plotë të shqipes* në gjysmën e dekadës tjetër që po vjen. Ky korpus do të ketë të dhëna jo vetëm për tërësinë e leksikut të shqipes po edhe për moshën e identifikimit të moshës së fjalëve dhe krijuesve të tyre, kryesisht nga radhët e neologjistëve të të gjitha fushave. Atyre u prijnë shkrimtarët e vjetër (të njohur për krijimin e një korpusi filozofik të leksikut të shqipes); shkrimtarët e Rilindjes Kombëtare (të cilët jo vetëm kanë krijuar neologjizmat për të gjitha dijet e shkencave filozofike, të shkencave të natyrës dhe atyre shoqërore, po kanë krijuar edhe sistemin gramatikor e filozofik të krijimit të neologjizmave në periudhat e mëvonshme); neologjistët, teriminologët dhe puristët e gjysmës së parë të shekullit XX njëkohësisht, të cilët leksikografisë dhe shkencave shqiptare i dhanë fytyrën evropiane, duke filluar me alfabetin deri te shkolla laike kombëtare e shtetërore; institucionalizuesve dhe themeluesve të albanologjisë si dije kombëtare në Tiranë e në Prishtinë dhe krijuesve të veprave nacionale nga *Fjalori i gjuhës shqipe* (1954) deri te *Fjalori i gjuhës letrare shqipe* (1980), përkatësisht *Fjalori i madh i gjuhës shqipe* (2026).

Trashëgimia mijëvjeçare

Pjesa më e madhe e atyre që viteve të fundit e kanë trazuar jetën tonë shkencore dhe kulturore, nga radhët e atyre që akuzojnë



institucionet akademike dhe shqetësojnë studiuesit, janë ata që "ishin të shqetësuar për mungesën e fjalësit historik, mijëvjeçar të shqipes" (!) në *Fjalorin* tonë, duke mos e parë fare evolucionin e brendshëm të saj në raport edhe me gjuhët historike me të cilat ka komunikuar dhe ato fqinje me të cilat komunikon. Prandaj, le të sjellim disa prej atyre fjalëve mijëvjeçare të fondit indoevropiane e paraindoevropiane, të pranishme edhe në *Fjalorin e madh të gjuhës shqipe*, të cilat gjuhën shqipe e bëjnë mijëvjeçare dhe të përbotshme brenda dijes së sotme akademike planetare, pa pasur nevojë që secilën fjalë që e ndeshim sot në gjuhët e botës ta quajmë "tonën". Fjala është për atë trashëgimi leksikore që jo vetëm nga aspekti fonetik e gramatikor, po edhe nga aspekti sociologjik dëshmojnë për amësinë e emërtimit të përbërësve jetësorë e sendentare të popullit shqiptar, të krahasueshme madje edhe me gjuhët e familjes indoevropiane. Në fillim po e theksojmë një trashëgimi specifike të emërtimit të numrave të ashtuquajtur vegesimal *një-zet, dy-zet, tre-zet, katër-zet*, një trashëgimi kjo paraindoevropiane, të cilën e kanë trashëguar edhe francezët, si dhe emërtimin e numrave: *dhjetë, tridhjetë, pesëdhjetë* etj., topike për gjuhët indoevropiane. Në listën e fjalëve të trashëguara nga fondi indoevropian kemi edhe emrat: *motër, bijë, dhëndër, ari, ujë, dimër, natë* etj., me po ato veçori të fonetikës historike, me po atë evolucion fonetik e morfologjik, të cilat i kanë trashëguar edhe gjuhët tjera, por me specifikat e strukturës fonetike e morfologjike historike të shqipes.

Me rrënjën indoevropiane thonë etimologët Franc Bopp, Gustav Majer, Holger Pedersen, Norbert Jokli, Eqrem Çabej, Idriz Ajeti, Shaban Demiraj, Koleç Topalli, David Luka, Vladimir Orel, Bardhyl Demiraj etj., është emri *akull*, "krahas emrit të një bime të gjembtë, të cilat vendosen te rrënja indoevr. *kel- "ther, shpoj, thumboj". (E. Çabej, II, 1982: 16, 17) etj.

Denduria autoktone e leksikut historik

Megjithëse njësi leksikore të trashëguara nga fondi indoevropian dhe të krahasueshme me gjuhët e kësaj familjeje, jo të gjitha i takojnë fondit gjithëkombëtar. Ndonjëra prej tyre strukturalisht, semantikisht e gjeografikisht shfaqet vetëm tek arbëreshët e Italisë, vetëm në gegërishte apo vetëm në dialektin e toskërishtes.

Kështu mund të thuhet se fjalët *akull* m., *arë, arë*, janë të "mbarë gjuhës", ndërsa fjala *ban* m., *banë* f. "banesë", vetëm e gegërishtes". (E. Çabej, II, 1982: 91, 92); fjala *bir* m. e mbarë gjuhës; fjala *bletë-a* është fjalë e lashtë vendëse, ndërsa fjalët *buj, buz* m. "kërcu; kërcu i trashë që vihet në zjarr të vatrës natën e kërsëndellave" (E. Çabej, II, 1982: 246); fjala *ulk* *ujk*-jo vetëm është ruajtur në mbarë gjuhës (E. Çabej, VII, 2006:196) por është ruajtur edhe në toponimi, Ulk: Ulqin, përballë latinishtes kontinentale Ulpianë (afër Prishtinës), dhe greqishtes mesjetare Likos/Likoc në krahinën etnografike të Drenicës ose Kosovës Qendrore etj.

Fondi ilir i leksikut të shqipes

Në *Fjalorin e madh të gjuhës shqipe* është përfshirë edhe një listë e madhe e fjalësit të vjetër të shqipes i cili konsiderohet të jetë ruajtur nga koha e ilirishtes, apo që e kanë trashëguar shqiptarët dhe gjuha shqipe nga periudha ilire. Le të identifikojmë këtu

një listë fjalësh, si: fjala *amë* f. I. “shtrat i një lumi”. Afrohet me lat. *amnis* “lumë”, dhe këtij barazimi i shton edhe emrin e fisit ilir *Amantes*, si “bregalumas”. (E. Çabej, II, 1982: 22); fjala *bërsi* f. “fundërria e rrushit, e ullinjve dhe e kumbullave, që mbetet si të shtypen a të shkelen këto”. Brūchu ka menduar të dëftojë që lat. *brisa* rrjedh nga trak. βρότσα βρότσα “bërsi” nëpërmes të ilirishtes, dhe që shqipja e ka trashëguar fjalën nga ilirishtja e s’e ka prej latinishtes. Fjalë e mbarë gjuhës. (E. Çabej, II, 1982: 129); fjala *bli-ni*: “Peshk i madh deti me sharrë mbi korriz”. Në shqipë *bli* mund të jetë formuar nga një *bel + in* me shpërngulje të theksit **bél + in - : *bēlín : bli*. Pra fjala *bli* “peshku” është fjalë vendëse, me gurrë indoevropiane, e trashëguar që nga koha ilire. (Luka, SGJ, I, 2003: 154); fjala *bollë* f. “një gjarpër i madh”. Fjalë me burim të diskutuar. Fjalë e mbarë gjuhës. Trajta bazë *bollë*. Më fort një element parashqiptar (ilir) i latinishtes, ashtu si *baro -onis, grosa, sica* e ndonjë tjetër. (E. Çabej, II, 1982: 172, 173). Le ta shohim fjalën *dardhë* f., në një format më të gjerë të një periudhe pesëshkulllore, jo vetëm të lidhura nga aspekti leksikor po edhe toponimik. Këtë fjalë e lidhin, që prej Hahnit e këtej, me emrin e popullit – në shumicë ilir – Dardani e të vendit të tyre Dardania si “vend dardhash”; këtë emër të lashtësisë e afrojnë më anë tjetër me disa emra personash si Dardas “praetor Epirotarum” etj.

Fondi i trashëguar nga gjuha greke

Në listën e pasur të leksikut të greqishtes së trashëguar drejtpërdrejt përmes shqipes janë fjalët *kllogjër* (e ka edhe Buzuku), *manastir* (e ka edhe Budi, ndërsa Bardhi *munështirë*, si edhe emri i një lumi në Jug të Shqipërisë; *qefali, skile, trëndafil, kanakar, dhaskal* (e cila dikur përdorej në tekstet e vjetra, ndërkohë që në gjysmën e parë të shekullit XX, ky emër i mësuesit përdorej kryesisht si fjalë eufemike). Kështu del edhe në *Fjalorin e madh të gjuhës shqipe*, por kujtoj që tri dekadat e fundit emri i mësuesit *dhaskal*, ka marrë po ato përmasa që i kishte dikur në të folmet shqipe në Greqinë e sotme. Të kësaj natyre janë fjalët: *aguridhe*, “fjalë dialektore kryesisht e toskërishtes dhe e ligjërimeve të Greqisë e të Italisë”. (E. Çabej, II, 1982: 9); fjala *ajazmë* f. “ujët e bekuar”, për të cilën besohet se në shqipen mund të ketë hyrë nga një periudhë më e moçme e greqishtes, nga greq. e mesme e kohës bizantine. (E. Çabej, II, 1982: 13) etj.

Fondi i leksikut antik të huazuar nga latinishtja

Një fjalë posaçërisht e motshme, por e pranishme dendur në jetën kombëtare është fjala *borë*, që në format dialektore dhe të shkruara na del edhe si: *dëborë, zborë, xborë, vlorë* etj. Është fjalë e mbarë gjuhës. E pranishme edhe në toponimi, p. sh. *Drume e Borës*, Emri i malit *Bora* të Maqedonisë antike etj. (E. Çabej, II, 1982: 175, 176)

Praninë tonë e të gjuhës sonë gjatë antikitetit e dëshmon edhe një listë fjalësh të pranishme në *Fjalorin e madh të gjuhës shqipe*, në ato përmasën fonetike, fjalëformuese e semantike të shqipes antike në raport edhe me marrëdhëniet e saj me gjuhën latine. Le t’i shohim vetëm disa prej tyre: *apostull* m. “mendohet të jetë një nga ato huazime që kanë hyrë në shqipen që në kohën antike, prej latinishtes, e që vazhduan të rimerren në mesjetë nëpërmes italishtes. (E. Çabej, II, 1982: 33); fjala *plan/ë/a/*, “është një ndër të paktat fjalë të shqipes me burim nga latinishtja që ruhen kryesisht në toponomastikë. (Luka, SGJ, III, 2003: 326-327-328); fjala *pllangë-a*: fjalë e mbarë gjuhës, fjalë e shqipes që ngjan me latinishten *palanga* “shtagë”. (Luka, SGJ, III, 2003: 338); fjala *produkt-i* “send me vlerë...”. Fjalë e përdorur sipas gjedhes së latinishtes *productus*. (Luka, SGJ, III, 2003: 361) etj.

Sikur mund të shihet mbi bazën e emrit *fjalë* kemi jo vetëm disa trajta të identifikuar ndër shekuj e botime shekullore, po prej saj janë krijuar edhe një listë e madhe trajtash e strukturash të reja me rrjedhoja fonetike, morfologjike e semantike të shqipes. Sikur shprehej Profesor Çabej, pavarësisht që një fjalë mund të ketë etimologji të ndryshme, formim vetjak, e trashëguar ndër mote, me origjinë nga antikiteti apo nga gjuhë të tjera fqinje, të gjitha format dhe fjalëformat tjera

janë formime të brendshme përkatësisht vetjake.

Leksiku i huazuar nga sllavishtja

Në *Fjalorin* tonë të madh të shqipes gjenden fjalë po kaq të vjetra dhe prodhime të tjera të reja brenda gjuhës shqipe. Megjithëse të huazuara nga sllavishtja e vjetër (pas shek. IX) dhe e re (serbe e bullgare), kryesisht nga shekulli IX, prodhimet e reja janë të shqipes dhe me përdorim të dendur. Shtrirja e tyre është mjaft e gjerë, nga jeta shtëpiake, në jetën sedentare (bujqësi) deri te jeta shoqërore e administrata e dy shekujve të fundit, si: *grusht, kyç, kosë, kosh, kovë, lopatë, nevojë, prag, strehë, zakon* etj. (Shih, Demiraj, Shaban, 1987: 172). Karakteristikë e tyre kohore është prania e tyre në Veri (sllav. e vj.) dhe Jug (bullg.) dhe madje ndër arbëreshët, format e tyre të shkrimit në tekstet më të hershme (nga Buzuku e deri në *Fjalorët* e fundit të shek. XX). Le të identifikojmë vetëm disa prej tyre, si: *grusht, -i. m.* në veprën e parë të shqipes në Veri që nga Buzuku, 1555 (shih Qendro, 2014: 128), dhe në Jug në botimin e Dhanil Haxhiu, 1802 (shih, Ashta, VII: 297); te tekstet e arbëreshëve të Italisë, si Variboba, 1762 (Shih, Ashta, VI: 204); deri te *Fjalori* i parë i gjuhës shqipe, *grusht-i*, em. shm. (FGJSH, 1954: 148).

Huazimet nga leksiku oriental

Listën me leksikon më të vjetër të shqipes e përbëjnë edhe fjalët e orientit: osmanishtes, persishtes, arabishtes dhe së fundi turqishtes. Sikur ka vënë re Profesor Shaban Demiraj (2013), fjala është për ato njësi leksikore të cilat dalin që te Buzuku, (1555, 177): *dollamë, cohë, kallaus, teps, turk*; te Budi, (1618, 178). Ato tashmë janë edhe më të shumta: *pazar, temel, raki, terezi*; te *Fjalori* i Bardhit (1653): *berber, hambar, hesap, ibrig, kadi, kazan, kurban* etj. Përgjithësisht studiuesit pajtohen që fjalët e trashëguara nga orienti kanë filluar të hyjnë që nga gjysma e dytë e shekullit XIV, po kjo nuk do lidhur vetëm me pushtimin e trojeve shqiptare nga Perandoria Osmane. Megjithëse shumë fjalë kanë etimologji nga persishtja e arabishtja, pjesa më e madhe e tyre janë huazuar përmes apo me ndërmjetësimin e turqishtes.

Fjalorët bashkëkohorë dhe perspektiva e tyre

Një rrafsh më vete përfaqëson leksiku i huazuar i shekullit XX–XXI, i cili është posaçërisht i gjerë dhe shumëplanësh, për shkak se përfshin jo vetëm leksikon shpirtëror e material po edhe atë libror e administrativ. A është e rastit pse në këtë kohë nga fillimi i shekullit XX deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, kemi pasur një lëvizje të fortë puristë (duke përfshirë këtu edhe onomastikën), e megjithatë kjo lëvizje nuk pati mundësi të pengojë hyrjen e huazimeve të italishtes si gjuhë e administratës dhe modës dhe nuk pati mundësi të shtrihet edhe pas vitit 1945.

Për shkak të ndikimeve politike, administrative e kulturore të kohës në Shqipëri, pas vitit 1945 iu hapën dyert ndikimit të leksikut të rusishtes si gjuhë e politikës, diplomacisë, shkencës, si dhe leksikut e termave të gjuhës italiane e sidomos frënge, si gjuhë e letërsisë dhe modës. Po kështu mund të thuhet edhe për gjendjen në Kosovë, nën Jugosllavi, ku leksiku i serbokroatishtes hyri me të madhe në fushë të komunikimit politik, administratës, kulturës dhe madje letërsisë, si dhe leksiku nga gjuha frënge, angleze e madje gjermane, si gjuhë të e letërsisë, kulturës, mjeteve të punës dhe modës. Ndryshe qëndron gjendja me leksikon që bëhet bazë e onomastikës (antroponiminë). Në Kosovë zgjerohet baza e antroponimisë me motive kombëtare, ndërsa në Shqipëri edhe amza e antroponimisë letrare e kulturore ruse e evropiane.

Fjalori i madh i gjuhës shqipe tashmë është në tryezën e studiuesve dhe lexuesve, i papërmbyllur, por në formatin elektronik. Për të qenë më i realizuar institucionet akademike, universitare, shkencore, kulturore e administrative do të duhej të kishin botuar të paku në dekadën e fundit nga një fjalor të profesional të fushave të tyre: mjekësisë, astronomisë, ekonomisë, makinerisë, teknologjisë, sportit, bujqësisë,

ambientit, gjuhësisë, letërsisë, trashëgimisë, matematikës, fizikës, politikës, diplomacisë, muzikës, kulinarisë, administratës, kimisë, energjetikës etj., në të cilët do të ishin të përfshira edhe fjalët, nocionet, konceptet dhe termat e hyra në dekadat e fundit, sidomos pas vitit 1990 e këndej, prej të cilëve do të zgjidheshin zërat përfaqësues. Duke i pasur të botuar fjalorët e disa pre fushave më të rëndësishme të dijeve, që kanë pasur ndikim të madh në jetën kombëtare, sikur janë ata të teknologjisë informative, mjekësisë, diplomacisë, kulturës së përditshme dhe ndonjë fushe tjetër me zhvillim të jashtëzakonshëm. Pa dashur të zmerremi me fusha të veçanta që kanë pasur zhvillime të reja, po më pak se ato që u theksuan më lart, po e sjellim këtu vetëm rastin e muzikës apo një drejtim të saj. Dikur në fjalorët normativë kishim disa lloje të zhanreve muzikore, si: *muzika klasike, muzika klasike bashkëkohore, muzika jazz, muzika elektronike, muzika popullore*, etj., për të cilat kishim edhe shpjegime të përgjithshme. Por gjendja ka ndryshuar shumë. Vetëm muzika hip-hop me nënzharet e saj: *hip-hop alternativ, hip-hop fetar, hip-hop hebraik*, sot përfaqëson një listë tepër të gjerë e të hapur për të cilat nuk kemi as shpjegime përgjithësuere, as emërtime të stabilizuara, pasi në mediat elektronike dhe të shkruara, ato përshkruhen dhe shqiptohen në gjuhën angleze, ashtu sikur e bëra edhe unë jo rastësisht në këtë tekst diskutimi e shqyrtimi.

Në këtë rrjedhë ky lloji zhanri muzikor i ka kaluar të gjitha përmasat kombëtare, rajonale e globale duke marrë edhe ngjyresat nacionale, si: *hip-hopi shqiptar, belg, britanik, bullgar, kroat, çek, gjerman, francez, maqedonas, malazez, suedez, ukrainas* etj. Ata që kanë përcjellë zhanrin e muzikës hip-hop, ndërkaq, e thonë se hip-hopi shqiptar, në të vërtetë është hip-hopi kosovar i viteve ‘90, i cili ka pasur ndikim të jashtëzakonshëm në gjithë zhanrin e këtij lloji, me hapje edhe në atë të diasporës.

Të mos harrojmë se jetojmë në kohën e *fjalorëve online*. Qendrat më me përvojë shkencore e enciklopedike, *Enciklopedia britanike*, apo Qendra Enciklopedike “Miroslav Kërlezha” në Zagreb tash e sa vite nuk botojnë vepra në formatin e shtypur. Në Zagreb madje ka filluar përgatitjen e *fjalorëve* të fushave të ndryshme sikur është *Fjalorin e egzonimeve*, të cilët madje përgatiten, redaktohen dhe jepen në përdorim drejtpërdrejt.

Fjalorët dhe ChatGPT

Studiuesit Katica Balenović dhe Jakov Sproković nga Universiteti i Zarës në studimin e tyre *Potenciali leksikografik i inteligjencës artificiale në shembullin e fjalëve të huazuara nga anglisht në gjuhën kroate*, kanë sjellë një matje interesante të vitit 2024 dhe 2025. “Ky studim shqyrton potencialin leksikografik të inteligjencës artificiale duke përdorur modelin ChatGPT si shembull, për analizën e huazimeve angleze në gjuhën kroate. Hulumtimi vlerëson aftësinë e AI për të dalluar kuptimet specifike të fjalëve të huazuara dhe për të ofruar shembuj përdorimi në kontekstin gjuhësor kroat. Rezultatet tregojnë që modeli ka saktësi të lartë për fjalët më të zakonshme, por has vështirësi me kuptimet më të rralla dhe mund të japë shembuj jo të saktë ose të tejgjeneralizuar nga anglishtja, gjë që mund të thuhet edhe për gjuhën shqipe. Analiza krahasuese midis përgjigjeve të viteve 2024–2025 evidenton përmirësime në dallimin e kuptimeve dygjuhëshe, por mbeten inkonsistenca në korrelacionin midis frekuencës së përdorimit dhe numrit të kuptimeve. Studimi thekson nevojën për përdorim kritik dhe verifikim të AI në kontekste gjuhësore specifike gjë që mund të thuhet edhe për leksikon e korpusit të shqipes.

Nuk e di nëse matje të tilla janë bërë edhe për leksikon e shqipes, por e di që gjuha shqipe nuk e ka përmasën e neologjizmeve bashkëkohore, të cilën e ka gjuha kroate sot. *Fjalori i madh i gjuhës shqipes*, si edhe ChatGPT me programet e pafundme të tij do vënë në funksion të të dhënave bazë, për lexime të teksteve klasike, për përshkrimin e njëjës leksikore dhe teksteve bazë, por askush të mos pres që ajo do t’i zgjedh të gjitha punët tona shkencore duke ju referuar teksteve, rezultateve më të mira të gjertanishme, aq

më pak t’i zgjedh tekstet e duhura, ta bëjë analizën kritike dhe jep rezultatin e duhur pa pasur nevojë t’i lexojmë edhe ne ato.

Shqiptari modern duhet t’ia kthejë shpinën konceptit për dialektin si gjuhë më vete, dhe Gegërisë e Toskërisë si krahina etnografike, ashtu sikur ua ka kthyer shpinën krahinave etnografike e feudeve, si kufij, si koncepte dhe si përmbytje moderne e shoqërore. *Fjalori i madh i gjuhës shqipe*, me fjalët / leksikon, me përbërësit gramatikorë e me shtrirjen semantike, me trashëgiminë etnogeografike e frazeologjike, duhet të mbulojë, jo kufijtë e atdheut politik, po kufijtë e atdheut gjuhësor e etnik, si dhe diasporën historike dhe moderne, në ato përmasa që e kemi sot. Më në fund, çfarë është *Fjalori* i një populli, i cili nuk përfshin fjalët skaj më skaj atdheut dhe madje cep më cep botës ku flet populli i tij. *Fjalori i madh i gjuhës shqipe*, ndërkaq, duke qenë fjalor modern dhe standard njëkohësisht përfshinë të gjitha fjalët që kanë përdorim të sotëm, të gjitha fjalët dhe kuptimet e tyre që identifikojnë mjetet e punës e të prodhimit nga kuzhina deri te fabrikat e dronëve e të aeroplanëve, veshjen bashkëkohore, emërtimin e ushqimeve që i hamë sot, të menduarit kulturor, politik e sidomos intelektual etj. *Fjalori i madh i gjuhës shqipe* e sigurisht as autorët e tij nuk janë fajtorë që populli shqiptar nuk ha më disa prej ushqimeve që ka ngrënë në kohën e Mbretëreshës Teutë, nuk vishet me disa nga rrobat me të cilat është veshur në kohën e Skënderbeut, nuk punon me veglat dhe mjetet tjera të punës me të cilat ka punuar në kohën e Ali Pashë Tepelenës dhe madje nuk këndon me dorë pas veshi, prandaj nuk i përdor ose i përdor vetëm në ndonjë cep të Ilirisë, nuk i përdor emrat e tyre dhe nuk këndon as nuk mendon me konceptet e asaj kohë.

Kultura e gjertanishme dhe sidomos letërsia bashkëkohore, ka krijuar shumë fjalë të reja, shumë neologjizma, shumë fjalë me trajta të reja, shumë fjalë të vjetra që bartin kuptime të reja, por jo të gjitha janë ruajtur dhe sidomos jo të gjitha janë funksionalizuar në jetën e përditshme. Lexuesit e letërsisë artistike dhe publicistikës kujtojnë shumë fjalë të shkrimtarëve e publicistëve, të cilët janë shquar për përdorimin e leksikut të vjetër e dialektorë, por jo të gjitha fjalët e tyre janë funksionalizuar dhe jo të gjitha e kanë vendin në *Fjalorin e madh të gjuhës shqipe*, pavarësisht funksionit artistik që kanë pasur në veprat letrare e publicistike.

Fjalori i madh i gjuhës shqipe, është pasuri kombëtare që do t’i shërbej brezit të sotëm dhe sa të jetë e mundur edhe brezave që vijnë. *Fjalori i madh i gjuhës shqipe*, nuk është thesari gjithpërfshirës i gjuhës shqipe, po thesari leksikor në përdorim të sotëm.

Në vend të përfundimit

Thonë se gjuha përcakton territorin, ndërsa gjuha shqipe e tejkalon atë territor, përkatësisht ato territore që nuk i kanë përcaktuar Shqipëria shtetërore dhe Kosova shtetërore; thonë, nëse një popull nuk e mbulon territorin me gjuhën e vet, ai nuk e zotëron plotësisht atdheun e tij, ndërsa gjuha shqipe e mbulon atdheun kombëtar e identitar përtej kufijve politikë, prandaj gjuha shqipe ishte dhe mbeti në themelet e identitetit kombëtar. Në të vërtetë fjalorët normativ të një kombi janë sinonim i lashtësisë së një popullit, sinonim i pasurisë mendore dhe pasurisë materiale, me të cilat ai i ka jetuar dikur dhe jeton edhe sot. Për më tej Shqipëria pritet së shpejti të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian, prandaj presim që sa më parë të shpallet ligji për gjuhën dhe të përgatiten dokumentet për shpalljen e gjuhës shqipe gjuhë zyrtare e Evropës me kod të veçantë ndërkombëtar.

Le të bëhet prandaj *Fjalori i madh i gjuhës shqipe* amza dhe ombrella e kombit shqiptar në ato përmasa të cilat nuk kemi mundur t’i arrijmë me kufijtë e shtetit kombëtar (Shqipërinë) dhe shtetit shumëgjuhësor (Kosovës). Dhe le të bëhen drejtuesit e tij, autorët e tij, redaktorët e tij, bashkautorët e tij, bashkëpunëtorët e tij, ata që në këtë monument e vendosin qoftë edhe vetëm një fjalë në strukturën leksikore e semantike të tij. (*Version i shkurtuar, i liru nga literatura dhe shumë shembuj*)

1.

Në botën e librave, nuk ka tekste më të diskutuara dhe më të diskutueshme se sa Antologjitë poetike, mbasi në to ka shumë elementë pjesmarrës, kaq shumë trafik dëshirash dhe paragjykimesh, sa i bëjnë këto diskutime shpesh më të flakta seç duhet.

Në Antologjitë e poezive të kombeve të ndryshme debati kufizohet disi, dhe shkon deri në natyrën e përkthyesve, në diskutimin e cilësisë nëse janë poetët përkthyes më të vërtetë dhe më korrektë me përkthimin, (se sa përkthyesit klasik që s'janë krijues), apo edhe gjykohet edhe se si përkthyesit poetë përzgjedhin të sjellin në shqip nëpërmjet antologjive krijimet e sivëllezërve të tyre, (të ngjashëmve të tyre, homologëve që kanë), ndër kombe të tjera.

Tjetërsoj ndodh në Antologjitë kombëtare, apo dhe të kasteve të pjesëshme që përzgjidhen të jenë nëpër këto përmbledhje, herë tematike, herë zonale, herë me një argument festiv apo të dala nga aktivitetet poetike, apo dhe të mbledhur nën një argument letrar.

Pikërisht tek këto të fundit merr zjarr diskutimi, gjykimet dhe paragjykimet, lihen menjëanë studiuesit si dhe më sqimatarët, dhe situatën e marrin në dorë të gjithë njëherësh, futen në lojë të talentuarit dhe entuziastët, mediokrit dhe të heshturit, qejfprishurit dhe hatërmbetësit, tifozët dhe fansat, inatçorët që fshihen pas emrave të munguar për të nxjerrë dufin dhe mllëfin e tyre, se përse nuk janë vetë të përfshirë. Të gjithë i kap ekzaltimi i të qenit më i miri.

Por ka dhe një fashë të heshturish dhe të përmbajturish, që, (edhe nëse nuk janë përfshirë në ndonjë Antologji), e përcjellin me qetësi këtë mungesë, duke besuar shumë te poezitë e bukura që kanë, që nesër a pasnesër do ta gjejnë shtegun e botimit.

Përzgjedhësit dhe hartuesit e Antologjive patjetër që bëjnë një punë të madhe selektive, mundohen të jenë sa më të saktë, (dhe të drejtë), të përpiktë dhe korrektë, dhe aspirojnë të përmbajnë emocionet dhe të frenojnë raportet miqësore. Por si në çdo iniciativë relative, jo rrallë dhe në Antologjitë më të mira, bie në sy, herë sendimenti për ndonjë poet mesatar, herë herë regjistri i leximit të përzgjedhësit nuk është kolauduar saktë, (gjë që sjellë poezitë mesatare edhe të krijuesve të njohur), dhe nganjëherë dallohen që larg hateret dhe inatet, prirjet emocionale.

2.

Në shqip janë përkthyer Antologji të poezisë, nga kombe të ndryshme, (poezia turke, japoneze, gjermane, ruse, greke, franceze, spanjolle, italiane etj.), me shumë regjistra përkthimi. Ndër to ka përkthyes shumë të mirë, poetë përkthyes, përkthyes që s'janë poetë, përkthime të poezive nga gjuhë të ndërmjetme dhe jo origjinale, njohës të mirë të gjuhës së huaj teknike, (por jo njohës të elegancës dhe brishtësisë së poezi), studiues jo të gjërë të historisë së letërsive të kombeve, (që kështu e ngushtojnë përzgjedhjen brenda dijes dhe njohjes së tyre). Gjithë këto mjeshtra gjuhësh, aq sa i kanë bërë nder lexuesit dhe bibliotekës shqiptare me tërë këtë volum poezishë, patjetër që dhe i kanë bërë dëmet dhe zullumet e tyre.

Kujtoj që Antologjia poetike e rusëve është përkthyer nga njohësit më të mirë të rusishtes, lingvistë dhe poetë të shkolluar atje, (Vedat Kokona, Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Jorgo Bllaci). Madje mbaj mend që në këtë Antologji është ndjekur dhe një praktikë, që disa herë poezi të njëjta përktheshin nga poetë të ndryshëm, secili në variantin e vet. "Shalli i zi" i Pushkinin ka plot gjashtë alternativa përkthimi. Ndryshe ndodh te Antologjia me poezi turke. Atje pjesa më e madhe e poezive është marrë nga gjuhë të tjera, të ndërmjetme. Ataol Berhamogllu, Bedretin Xhomert, Fazëll Hysny Dagllargja, Nazim Hikmet, etj. janë kthyer në shqip nga poetë që nuk e njihnin gjuhën turke, por zotronin ose rusishten ose italishte. Dhe kjo lloj praktike nuk ka ndodhur rrallë.

Në antologjitë botrore shpesh njohim jo vetëm profile shkrimtarësh. Por kemi mundësi

Përtej Antologjisë poetike "Katërdhetë e nandë shpirtën në një" të Ernest Markut

Përse jo pesëdhjetë?

Nga Mark Simoni

të bëjmë dallueshmërinë e përkthyesve dhe cilësisë së tyre të përkthimit.

Biblioteka e shqipes ka në fondin e saj shumë antologji dinjitoze të përkthyesve seriozë, pra e ka atë pyllin e dendur të poezisë së huaj. Ka Antologjitë e poezive ruso-sovjetike me përkthyes Agolli, Qiriazi, Bllaci, Ziko, Siliqi; franceze me Kokonën, Shvarcin, Zhejin, Andean; anglo amerikane që nga Noli, Kokona, Luarasi, Shllaku, Rudolf Marku, italiane Koliqi, Shllaku, Gjeçi; greke Kolevica, Ziko, Varfi; gjermane Kokona, Klossi, Kolevica; spanjolle Shvarc, spanjolle moderne Bashkim Shehu, latino amerikane Moikom Zeqo; bullgare Xhaxhiu; polake Mazllum Sanea; arabe Shaban Sinani; kuvajtiane Kujtim Morina etj.

3.

Kritika tradicionale dhe teoricienët klasikë të poezisë, kur ka ardhur puna për të gjykuar artin e vargut dhe për ta marrë në analizë poezinë, kanë thirrur në ndihmë patjetër katërshen e famshme të antikitetit. Pra atëherë kur bëhet fjala për gjykimin e poezisë, për vlerësimin dhe seleksionimin përzgjedhës të saj, për teorikën e letërsisë, akademikët dhe studiuesit tradicionalistë të saj kanë rënë dakort që, mjetet me të cilat duhet vlerësuar arti poetik gjenden në katër libra të shenjtëruar sipas tyre: "Poetika" e Aristotelit (përkthyer nga Sotir Papristo), "E madhërishtja" e Longinit (përkthyer nga Vinçens Marku), "Arti poetik" i Horacit (përkthyer nga Engjëll Sedaj), si dhe "Arti poetik" (përkthyer nga Vinçens Marku). Madje në Amerikë kam gjetur shumë botime, ku këto katër tituj përmbledheshin në një vepër të vetme, të lidhur të katërt bashkë.

Por jashtë kësaj metodike, (duke i lënë këto kolosë në shenjtërinë e tyre), shumëkush ka dalë prej rregullit klasik, duke prodhuar secili mjetet e veta, duke u mbështetur në shijet personale, në regjistrin e tij të leximit, në vlerësimin hierarkik të korpusit të librave të cilët çdonjëri ka lexuar, në prirjet personale për të ndjekur rryma, shkolla, teori e kahje letrare. Dhe pikërisht atje, tek ajo lloj letërsie që ne pëlqejmë, patjetër që ne kemi deklaruar patentën e shijeve tona, aftësinë gjyqesore, sqimën estetike personale.

Antologjitë janë patjetër kolanat më konkrete dhe të përqëndruara, ku lexuesi dallon menjëherë profilin e përzgjedhësit dhe përpiluesit të tyre. Gjykimi ndaj poezisë përherë ka ndryshuar marzh, dhe ne kemi parë teori, qasje, mjete letrare dhe estetike nga më të ndryshmet. Jo vetëm në analizat, në studimet, në opinionet, por edhe në klasifikimet, në skedimin e autorëve dhe në grupimet antologjike, dallohen menjëherë shijet e përzgjedhësve, profili i tyre i të lexuarit letërsi, përdorimi personal i mjeteve të gjykitimit, aftësitë selektive dhe krahasuese që këto përpilues Antologjishë kanë.

4.

Unë i kam shumë për zemër Antologjitë. Madje Shtëpia Botuese MUZGU ka botuar 20 Antologji, ku dy të fundit janë "Për një puthje u shemb Troja" (me poezi dashurie

nga disa prej poetëve më të mirë tanët), si dhe Antologjinë "Në raft të librave kërkome", me poezitë më të bukura të 91 poetëve tanë të periudhës së re, të cilët nuk janë më në mes nesh.

I pëlqej Antologjitë sepse në to gjendet letërsi e përqëndruar, dhe ke aty autorë cilësorë të mbledhur së bashku, që në një farë mënyre aty ata edhe ballafaqohen me njëri tjetrin brenda po të njëjtit libër. Te Antologjitë lexuesi dallon jo vetëm një kast të gjërë autorësh, por ky lexues shquan menjëherë edhe profilin e përzgjedhësit apo përpiluesit të tyre, ku dallohen patjetër dhe shijet e përzgjedhësit, statura e tij e të lexuarit letërsi, përdorimi personal i mjeteve të gjykitimit, aftësitë selektive dhe krahasuese që përzgjedhësi ka.

5.

Dhe ja ku jemi tek Antologjia më e re, dhe ndër më të bukurat e letërsisë poetike aktive të sotme shqipe, "Katërdhetë e nandë shpirtën në një", mbledhur e përzgjedhur nga shkrimtari dhe studiuesi Ernest Marku, i cili qysh në krye të herës, tek parathënia, ai vendos monoklin personale të mënyrës se si i ka shikuar dhe i ka mbledhur poezitë, cili ka qenë kriteri i tij vetjak, shija selektive, trajta e përqasjes se teksteve poetike tek ndërgjegjja letrare e këtij përpiluesi dhe përzgjedhësi teksti. Dhe vërtetë me këtë përmbledhje i ka bërë një shërbim shumë të mirë letërsisë sonë të vargut.

Ernest Marku na thotë se, kjo Antologji është bërë si "ia kënda atij". Pra, ai pozicionohet që në fillim në komoditetin autoreferencial, duke e mbyllur me elegancë dhe finesë dhe pa kurrëfarë arrogancë portën e diskutimit dhe gjykitimit të Antologjisë si dhe përzgjedhjes së poezive sipas tij. Ernest Marku pra është garanti i këtyre 49 poezive, ndërmjetësi serioz mes autorëve dhe lexuesve. Dhe patjetër, që, qysh në fillim unë i kam besuar kësaj Antologjie, duke njohur Nestin si krijues, duke lexuar seriozitetin e studimeve të tij, duke qenë i prezanuar me shijet e tij të leximit, me gamën e njohjes së poezisë së sotme aktive që ky përzgjedhës ka.

6.

Emrat e autorëve të përfshirë në këtë tekst letrar janë garanti më i mirë që kjo Antologji të jetë shumë serioze dhe po kaq e admirueshme.

Poeti Alban Bala sjell në këtë Antologji një tekst të shkëlqyer, fin dhe elegant të distancës, kujtesës, nostalgjisë dhe mallit, dhe të gjitha këto të rrezikuara nga misteri i harrimit. E veçanta **Albina Gjergji** ka në poezinë e saj një "triko metafizike", një triko të dimensionit filozofik, që rrin në trup "Si dimni ynë i ngushtë, / Në natën e huej". Është në Antologji dhe një poezi e **Elida Rrustës** që luan mrekullisht me ekstravagancën, me skutat e fshehta të ndërgjegjes së njeriut, atje ku është e vërteta dhe poezia bashkë, "E s'mujshë me dalë prej shpije, / Se tash ishe burrë i puthun.". **Elona Culiq** vjen me poezinë më të bukur për trupin, këtë shenjtëri të gruas ("që trupi mundet me u ba turp"). E ky trup i hijshëm që



trand botën "asht kufini jonë, / që ndanë skllavërinë nga liria," është amaneti që ndanë vdekjen nga jeta, është stuhia, poezia dhe gjuha, shtëpia, trupi asht shkaku dhe fundi, asht amaneti. Kjo poezi është një himn monumental, pjedestali ku trupi i gruas është vetë dinjiteti, ndërgjegjja dhe koshienca e saj. **Entela Tabaku** luan me kohën filozofike, luan me stadin zanafillor duke e kthyer kohën mbrapsh, (nga ashklat e barkave të hedhura në ranë që i ndez flakë, në të vërtetë lexuesi kronologjikisht ndjen zjarrin si puna e parë e botës dhe mbas tij vijnë varkat e çdo gjë tjetër). **Adem Xheladini** përfaqësohet me poezinë "Shpresa e vujtun", me të cilën ka sjellë atë zërin e kujtesës së herëshme që vjen si ndërgjegje, herë e thellë, herë si kujtim dhe mall, me tone zanafillore. I mirënjohuri **Alfons Zeneli** ka në poezinë e tij dëshirën e fortë për të zgjuar mungesën, për të shpallur gjithë atë mall dhe ndjenjë, një klithje e heshtur dhe e përkorë e brendshme. Ka aty dhe metafizikë, aty është dilema dhe pikëpyetja e madhe mbi jetën, vdekjen dhe përjetësinë, ku Fonsi me mjeshtri ka bashkuar logjikën me intuitën mistike. **Arbana Arba** nënvizon lojën filozofike dhe të dimensionit "Unë ngatem për te ti", dhe pastaj përdor si mjete ekstremet sugjestive "Lum i shkalluem", "T'shterruna prej djegsinës", "Trandje të pa ndigjueme", dhe si përroi psiçik, autorja tashmë e thotë se "Ajo po ngatet si një rrapllimë përmbytjeje, të një lumi që s'njeh më as shtrat as brigje". Impresionante mjetet dhe imazhet që përdor, Mendimi dhe ndërgjegjja futen në filozofi, dhe kjo poezi bëhet mjet për të kërkuar kuptimin e egzistencës. Është gjithë vezullim në Antologji dhe poezia e **Bruna Përvathit**. Së pari dua të them se Brunë tashmë nuk e ka gëgnishtet vetëm si një mjet letrar, por e ka thelbësisht si ndërgjegje të thellë krijuese, matricë dhe nukël të letërsisë që bën. Vjeshta e saj në këtë antologji është ndër më të bukurat tekste. Në gjithë atë atmosferë delikate e magjepsëse të vjeshtës, me ato shira të tejdukshëm, me kokrrat e shëgës dhe ftonjtë, dhe zogjtë e shtegtimt, Brunë ka një varg që e hedh në mes të peisazhit "Ti e din se unë nuk di me vallzu", varg që duket se nuk ka lidhje fare me atë organikë të pozisë. Brunë bën një gjest ekstravagant, të guximshëm, që rrallë herë e kemi parë të ndodhë në poezinë shqipe. Është sfiduese kjo mënyrë. Poetë të mëdhenj e provojnë një trup të till, si piktorët që në një telajo krejt konkret, fusin një penelatë apo një spatul me një ngjyrë përndezëse për ta tonifikuar të gjithë tabllonë. Brunë Përvathi përdor natyrën e brendshme personale, duke e kthyer dhe zhvendosur peisazhin dhe duke e transformuar shpirtin në terren simbolik. Nuk kishte si të mos që i talentuari **Dan Ibrahim** në këtë libër. Poezia e tij më ka pëlqyer shumë. Ajo është poezi e thellë por edhe e pa komplikuar, ka raportet harmonike mes koshienës dhe inkoshienës, ka gjendje paranormale, ka instiktin dhe aksin qiell tokë, ka destinin e njeriut dhe kromozomin bazik të tij. Të gjitha të sajdisura me art. Është nga ato lloj poezishë ku përdoren simbole të fshehta për të krijuar një realitet tjetër të dyfishtë, të dukshëm dhe të nënkuptuar. Ndërsa **Dori Camaj** ka në këtë Antologji një poezi egzistenciale. Ka një creschendo, (rritje nga të

tre introduktet e poezisë, që fillojnë me “Nuk kam një pullë” për shpirtin, për zemrën. Tonet rriten nga vargu në varg si në një uverturë. Kjo është poezi ekzistenciale ku përballet me ankthin, vetminë, boshin dhe absurdin e jetës, duke e vendosur individin, në këtë rast “unin” poetik përballë botës. **Gabriela Mujaj**, kjo poete e talentuar dhe ecentrike, me poezinë e saj ballafaqon, përqaq, valencat personale të vetes, me dënimet (që janë bekime nga Zoti), për të na dhënë një dimension real të vetes së saj. Mendimi dhe ndjeshmëria, dashnia dhe djenja që bekohet me poezi. Duket si një poezi hermetike, që ndërton kuptime të mbyllura dhe të ngjeshura dhe dendura, ku lexuesi duhet të depërtojë përmes shtresave simbolike. Por kjo gjithësesi është një poezi shumë komunikative me ndërjegjen e lexuesit, me substancat e tij karakteriale. **Hekuran Koka** ka shumë shenjtëri në poezinë Nevruz. Qyshë në vargun e parë, atje ku vendoset teatri i narrativës poetike, ky djalë i talentuar shkruan “A e mbanë mend dashni”. Këtu nuk kemi të bëjmë me dashurinë e kufizuar, por këtu ndjehet se poeti i drejtohet asaj si çmund t’i drejtohesh një tempulli. Ka shenjtëri dhe paqe në vargje, me ëndrra, me kodra që bien në temena, me zogj dhe lisa. Për të mbërritur tek ndërjegja e thellë e kësaj poezie “Nëse tokën që kemi dhuratë s’e duam / Atëherë ne nuk besojmë dot asgjë”. Këtu kemi mardhëniën mitike tokë e qiell, dhe me këtë modul, të këtij aksi vertikal vazhdon: “lisat do të përkulen deri në tokë, e kodrat do t’i bajnë temena qiellit”. Dhe e përmbyll. Si prelud, “Do fle herët / se kam shumë nevojë të besoj, (këtu e kemi besimin shumë toksor), kam nevojë të ëndërroj, (dhe ëndrrën shumë qiellore). Poeti me këtë kujtesë dhe nostalgji rikthen të shkuarën, si një hapsirë emocionale, ku koha bëhet mall, rikrijim dhe kërkim identiteti. **Liza Brozi** ka krijuar emocionin estetik duke thurur mbi një gjendje, në atë emocion të kyqur në dëshirën dhe mbërritjen në destinin e dashurisë, duke perdorur ato situata dhe sendimente përndeze dhe përndritëse që të shtynë dhe thërrasin në atë rrugë. Poezia e saj është poezi meditative. Krijon një heshtje të thellë, ku kryqzohen mendimi dhe ndjenja, dhe ashtu së bashku treten në një gjendje përsiatje. Poetja e mbyll tekstin e saj me një varg “Zemrën tënde ta kemë shtëpi”. Sa bukur kur thotë “Shtëpi” dhe nuk thotë një gjë tjetër, sepse në paketën zanafillore të dëshirave, njeriu hovin e parë, tundimin e parë, tërheqjen e parë, kur është në rrugë, kur është në hall, kur është në mungesë, e ka që të mbërrijë tek shtëpia, ngrohtësia, forumi i zjarrit. Këtu Liza Brozi e nxjerr nga memorja gjenetike e të parëve të njerëzimit dhe i jep trajtë tjetër (“si zemër”, por që ama është shtëpi). **Lulzim Haziri** ka një paralele të mrekullueshme mes natyrës dhe letërsisë, mes çarçafëve të bardha të reve dhe letrës së bardhë të shkrimit. Të mbivendosura mbi njëra tjetrën këto dy realitete taman si në një palimpsest ekzakt. Një poezi eksperimentale, që luan me trajtat, formën, ritmin, figurinat, grafikën, apo dhe me strukturën sintaksore, për t’i dhënë kështu trajta shprehjeve poetike. Ka një fjalor të harlisur që i shkon përshtat subjektit poetik. **Marash Mirashi** ka kapur magjinë e zezes së poezisë, dhe e din shumë mirë se poezia është arti më i pafajshëm dhe e ka suksesin mes të qenit fëmijë dhe të qenit burrë. Pikërisht pjesmarrja në poezi e vëzhguesit fëmijë e bën zezjen e vargut jo të ngurtë, jo inerta dhe cerebrale. “çikriku që nuk lulëzon më”, “etjen e grerzave”, “gurin plot myshk”, vijnë prej vegimeve fëmijore, vëzhgime të pafajshme. Gjithashtu Marashi (që e ka këtë poezi ndër më të bukurat e Antologjisë), trajton në mbyllje të tekstit kureshtjen e ferrave (që zgjaten), duke na thënë magjepsjen e dëshirës së të pamundshmes. Peisazhet, imazhet e Autorit e ndërtojnë botën sipas figurave pamore në gjuhë simbolike, dhe këto Marash Mirashi i di mirë dhe i përdor me shumë sukses. Bravo! E veçanta **Mimoza Ahmeti** e nis poezinë me “Vaje të kaltra, për ty më lëshojnë flokët”. Impresioniste në ngjyra, surreale në formë, ekstravagante në lëvizje dhe energji. Pastatj merret me burrin e poezisë, kraharorin me dendësi bari të gjelbër (gjendje statike), këmbët si drurë të egjër, dhe krahët e harlisur,



sepse ato lëshojnë pa rreshtur krahë të tjerë, dhe krahë të tjerë, (këtu kemi imazhet e krahëve në lëvizje, në përkdhelje, në përqafime, që duke lëvizur dhe duke mos qenë statik duken shumë, që e bën energjike poezinë, e fut në tundim) dhe e mbyll me joshjen për dashurinë e vet që është dhe toka emocionale e dëshirës së poetes, “Një tokë një herë e gjetur / kurrë më s’është harruar”. Mimoza në poezinë e saj moderniste lëviz dhe shprish strukturat tradicionale dhe klishetë, dhe kërkon forma të reja shprehje, që e bëjnë poezinë e saj të admirueshme. **Mirela Papuçiu** vjen me poezinë më sensuale në këtë Antologji, me një eros të paketuar dhe maskuar me delikatesë dhe bukur, që megjithëse nuk ka asnjë fjalë të këtij korpusi, erosi ndjehet në të gjitha detajet. Ka shumë zjarmi dhe temperaturë tunduese nëpër vargjet e kësaj poezie vertetë shumë të bukur. Që në fillim tek ndezësi i agimeve, perëndimi i kuq, prushi si simbolikë, gjaku (gjaku i ndezur), gufon, m’shkrumbon, hi, di si me më zdashë, rreze nën lëkurë, dhe hukama e frymës së ngrohtë. Të gjitha këto e potencojnë poezinë dhe aktin njëkohësisht, i japin dashurisë energjinë

tunduese. Kjo është ndër poezitë që e bën këtë Antologji të duket bukur. **Preng Maca** është pa dyshim ndër mjeshttrat më të mirë të poezisë së brezit. Në poezinë e tij “Ngjarje e parashikuar” rrëfen një histori të improvizuar, ku poezia afrohet me tregimin, pa humbur ngarkesën emocionale. Dhe në të ka lojë maskash, ka preludin e njeriut dhe mortin e tij, ka botën hipokrite përrreth, ka gjyqin e fjalës së mbrame bashkë me gjyqin e së vërtetës, të mbyllur me një rreng shumë filozofik dhe të kuruar bukur, ku nga përtej shikon hipokrizinë e turmave. Vërtetë mjeshtri poetike.

Salvador Gjeçi ka një poezi krejt të veçantë, ku është metamorfoza egzistenciale, jeta e njeriut si një kronikë vuajtjesh dhe zhgënjimesh, shkruar me shumë klas, tjerrur me kujdes, nostalgji dhe dhimbje. Spikasin disa kalke gjuhësore të mrekullueshme si “gamilja prej reje të bardhë”, “gjallesë shkretinash”, “gunga mundimesh”, “hejbe shprese” dhe bota që lëviz e shtegton herë si një deve e butë, herë si kalë i hazdisur, herë si poeti i pa fre. Ka shumë imazh dhe gjendje filmike në poezinë e Gjeçit. Është dhe poezia e **Thomaidha Tanuçit** këtu, e

cila e vendos skenën e teatrit poetik në muzg, ku “do fjolla tymi frymojnë me vjeshtë”, peisazh dhe gjendje imazhiniste të përhapura me shumë estetikë nëpër poezi. Kur thotë Thota se “Murgjit mbyllen në lutje”, e bën skenën shumë të fuqishme dhe teatrale. Gëgnishtja e kësaj poeteje të talentuar ka shijen e gëgnishtes së viteve 30, atëherë kur gëgnistja që me përfaqësimin më dinjitoz, dhe që është shkollë gjuhe. Tanuçi njeh shumë mirë metrikën, njeh strukturat, dhe e mbyll tërë poezinë me një fjali me 5 fjalë njërokshe, si prerje, si kopsitje, efekt kyqje, krejt bukur “Kaq pa turp me ty”. **Viktor Gjikota** pavarësisht se përfaqësohet me një poezi me një strofë, shkruan saktë gjendjen e mungesës, të kohës filozofike, dhe (si në të gjitha poezitë e shkurtra e të bukura, që kanonet e letërsisë i quajnë letërsi minimaliste), kjo lloj letërsie poetike përdor pak fjalë dhe ka figura të përmbajtura, “ku ne lexojmë heshtjen që flet po aq sa vargu”.

Poezia “T’paanët” e Vlora Ademit mrekullon atmosferën e Antologjisë. Lexojeni pa koment, që ta ndjeni sugjestionin e saj. E keni në libër, në faqen 58.

Pas shumë vitesh jashtë skenës vjeneze, Fate Velaj u rikthye me një ekspozitë gjithëpërfshirëse si piktor, fotograf dhe romancier.

Në këtë ekspozitë, Velaj paraqiti një vepër shumëdimensionale që kapërcen kufijtë mes imazhit, fjalës dhe perceptimit.

Ekspozita bashkoi pikturën, fotografinë dhe reflektimin letrar në një koncept të vetëm artistik – një mendim në ngjyra, në histori njerëzore të kapura në format RAW, dhe në fjalë.

Ekspozita u hap më 5 mars në Vienna Grand Gallery.

„Kur them art, kam parasysh tërësinë e tij“
— Leo Zogmayer

“E KUQJA MES TEJE DHE MEJE”

Kështu e titulloi Fate Velaj këtë ekspozitë, në të cilën u paraqiten 43 piktura, disa prej tyre në formate deri në 150 × 230 cm.

Po ashtu, ai paraqiti fotografi nga cikli “ANTHOLOGJIA E FYTYRAVE – një homazh për njerëzimin”, si dhe romanet e tij.

Për pikturat e paraqitura, Velaj shprehet:

I detë e para për serinë e pikturave “E kuqja mes teje dhe meje” më erdhën pasi lexova romanin e André Breton – *L'Amour fou* (Dashuria e çmendur).

Gjatë punës mbi këto vepra nuk kam dashur kurrë të përqendrohem në detaje. Në fakt, kjo nuk më ka interesuar ndonjëherë vërtet.

Ajo që më ka magjepsur gjithmonë ka qenë analiza e atmosferës, dhe në këtë rast – ajo brenda dhomës së gjumit.

Aty ndjen aromën e gjithçkaje:
të mallëngjimit,
të bukurisë,
të xhelozisë dhe frikës,
të seksit,
të dëshirës dhe pasionit,
dhe mbi të gjitha –
të dashurisë.

Fate Velaj çel në Vjenë ekspozitën “E KUQJA MES TEJE DHE MEJE”



Fragment nga fjala në hapjen e ekspozitës

“E kuqja mes teje dhe meje”

...Në historinë e artit, rastësia është njohur prej kohësh si pjesë e procesit krijues – nga Dadaizmi, te Surrealizmi, e deri te Action Painting, rrymë kjo që është e pranishme edhe në pikturat e mia në këtë ekspozitë.

Por rastësia në hapjen e një ekspozite nuk është një rrymë artistike.

Ajo është thjesht një ngjarje e jetës.

Ishte një artikull mbi “ambasadorin e çuditshëm të Shqipërisë në Vjenë dhe ambasadën që ngjan me një Tate Modern”, botuar në një gazetë, që më solli përsëri pranë Wolfgang Bandion – një miku të vjetër me të cilin prej kohësh kishim humbur kontaktet.

Kur ai pa pikturat në muret e

ambasadës, nisi menjëherë përgatitjen e kësaj ekspozite, në të cilën sot paraqitem para jush si piktor, fotograf dhe shkrimtar.

Rastësia deshi që kjo ekspozitë të përkojë me 35-vjetorin e ekspozitës sime të parë në Austri, diku në një qytezë të vogël larg Vjenës. Një ekspozitë modeste. Me pak punime. Por që ndezi një zjarr të vogël brenda meje.

Po ashtu, kjo ekspozitë vjen edhe në 25-vjetorin e ekspozitës sime të parë në Vjenë, e cila rindezi një flakë të madhe në këtë qytet dhe më futi në agjendat e artit dhe kulturës që më çuan fillimisht në Bruksel, e më pas nëpër metropolet europiane – dhe akoma më tej.

Shpesh më pyesin:
si erdha te piktura, fotografia dhe letërsia?

Përgjigjja ime është gjithmonë e njëjtë:
“Në fillim ishte ngjyra.
Dhe ngjyra ishte piktura.”

Por kur piktura ime kaloi nga konkretja te abstraktja, brenda meje u rindez një kërkesë tjetër: kërkesa për konkretin.

Dhe kështu erdhi fotografia.

Fotografitë e mia u bënë njerëzit – ata që kanë diçka për të treguar. Ata që dikur kishin pasur një jetë ndryshe nga e sotmja dhe ndjenin nevojën ta rrëfenin.

Dhe pikërisht këtu lindi një dëshirë tjetër: t’u jepja fjalën atyre.

Pra, lindi letërsia.

Dy vite më parë hapja një ekspozitë me fotografitë e mia në Museo d’Arte Contemporanea di Cosenza. Titulli ishte: “Fate non si fermò a Eboli”.

Ishte një provokim ndaj romanit të Carlo Levi – *Cristo si è fermato a Eboli*, që do të thotë se “civilizimi u ndal në Eboli”.

Por nëse antifashisti Carlo Levi e pa këtë “mungesë civilizimi” gjatë internimit të tij nga Musolini në vitin 1935 në Aliano të Basilikatës, unë e kam parë atë në shumë vende të botës – edhe sot.

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

shumë nga këto punime i kam krijuar në një kohë kur ju keni qenë në gjumë. Në tre... ose katër të mëngjesit.

Jo vetëm ju.

E gjithë Vjena flinte.

Mozarti flinte.

Beethoveni flinte.

Schubert dhe Strauss flinin.

Ndoshta Gustav Klimt ishte ende duke “Puthur”... por këtë nuk mund ta vërtetojmë dot më.

I vetmi që ishte zgjuar isha unë.



Duke pikturuar.

Jo puthjen e Klimtit –

por “të kuqen mes teje dhe meje”, një pjesë e së cilës ndodhet sot këtu.

Dhe për këtë dua t’ju falënderoj juve që gjetët kohën dhe rrugën për të ardhur e për t’i parë këto punime; kolegët e mi ambasadore nga vende të ndryshme që më nderuan sot me praninë e tyre; dhe mbi të gjitha Klarën, gruan time, e cila nuk u ankua kurrë kur unë ngrihesha në mes të natës për të pikturuar këto vepra – madje, në shumicën e rasteve, bëja edhe pak zhurmë...


Ekspozita do të qëndrojë e hapur deri më 30 prill 2026.



DUET PASIONESH NË SOLO

Një performancë e trishtë

Nga dr. Eduard A. Skufi



Në vend të një homazhi

Serenata nostalgjike e kujtimeve, me Sintensitetin e vibratos së saj emocional, më riktheu në dialog me kohë të largëta, duke u ankoruar në të tashmen. Kur në ato kujtime ndriçojnë figura modelesh që kanë lënë gjurmë në jetën tënde, nuk mund t'i lësh në hijen e harresës.

Një pasdite dimri të vitit 1966, gjatë shëtitjes së zakonshme me miqtë, im atë dëgjoi për një pedagog të ri nga Shkodra, i cili nuk po gjente një dhomë për të jetuar dhe ishte detyruar të qëndronte prej javësh në hotel "Sazani". Prejardhja aristokrate dhe "njollat" në biografi ia mohonin atë të drejtë elementare. Heshtja e kolegëve ndaj këtij fakti fliste më shumë se çdo fjalë.

Im atë, pasi thithi cigaren deri në fund, kujtoi vështirësitë e veta kur u transferua nga Gjirokastra në Vlorë pas përfundimit të Normales së Elbasanit. E theu heshtjen dhe shprehu dëshirën ta hapte derën e shtëpisë për djaloshin e ri.

Kështu pedagogu Gjergj Kacarosi – Gjushi për shkodranët – një djalosh i gjatë, elegant, bjond me sy gri të thellë, u bë pjesëtar dinjitoz i familjes sonë.

Ai ishte tip i veçantë: flegmatik, i rezervuar, me edukatë e kulturë të admirueshme, i hijeshuar nga një mirësjellje fisnike. Por qysh në fillim të karrierës u përball me sfida tinzare të fatit.

Nëna ime nuk linte ditë pa i çuar në dhomë një pjatë gjellë apo fruta. Në mbrëmjet e ftohta të dimrit, pasi kthehej nga gjimnazi i natës ku jepte matematikë dhe fizikë, ajo e priste në kuzhinë me një pjatë supë të ngrohtë, që ai e pëlqente shumë.

Kur kisha ndonjë problem të vështirë në matematikë, ai luante me lapsin në dorë, mendonte pak dhe më jepte menjëherë rezultatin. Kishte një intuitë të rrallë.

Radioja e tij e vogël rrinte gjithmonë në frekuencat e muzikës klasike. Në shpirtin e tij bashkëjetonin talenti matematikor dhe pasioni për muzikën. Për të shuar kureshtjen time, më tregonte një foto të Ajnshtajnit mbi komodinë:

"Imagjinata dhe intuita janë më të rëndësishme se dija," - citonte ai. - "Dhe mos harro: Ajnshtajni ishte violinist."

Ai e shihte shkencën dhe artin si dy anë të së njëjtës thellësi shpirtërore.

Një figurë në mes të dy botëve

Mbrëmjen e Krishtlindjeve të vitit 1967 e festuam pa zhurmë. Gjergji do të nisej për në Shkodër për Vitin e Ri dhe e ftuam për darkë. Atmosfera ishte e qetë. Biseda kaloi nga kujtimet e babait për Normalen e Elbasanit te formimi pedagogjik dhe te ndikimi i Johann Friedrich Herbart-it, mbi doktrinën moderne të edukimit.

Gjergji dëgjonte me vëmendje. Pastaj, me një zë të matur, foli për të atin, Spiridhon Kacarosin, intelektual me poste të rëndësishme, i persekutuar dhe i internuar. Fjalët i artikuloi pa dramatizim, por me një dridhje të lehtë që tradhtonte barrën e kujtesës.

Më pas mori violinën e motrës sime dhe interpretoi një fragment nga "Moonlight Sonata" e Beethoven-it, pa partiturë. Ishte një interpretim i përmbajtur, teknikisht i pastër, pa teatralitet. Muzika tek ai nuk ishte demonstrim, por mënyrë të menduari.

Atë mbrëmje shprehu një dëshirë konkrete: të futej në orkestrën e estradës, pa hequr dorë nga mësimdhënia. Jo për ambicie artistike, por për arsye praktike. Nëna e tij nuk kishte pension; motra studionte. Barra financiare i takonte atij.

Babai i premtoi se do të fliste me drejtuesit përkatës. Çështja e qirasë u mbyll pa shumë fjalë: ai ishte pjesë e familjes sonë.

Pak kohë më pas, ëndrra e tij u realizua. Në premierën e estradës "Maska dhe Fytyra", Gjergji u prezantua si saksofonist tenor. Ishte i veshur me xhakëtë të bardhë dhe papijon ngjyrë vishnje. Soloja e tij ishte e disiplinuar, me frazim të qartë dhe një ton që nuk kërkonte duartrokitje, por dëgjim.

Matematika dhe muzika

Shtëpia jonë u kthye në një hapësirë dialogu kulturor. Motra me violinën, Gjergji me saksofonin; unë me pyetjet e mia të pafundme. Ai fliste për lidhjen midis matematikës dhe muzikës si për një strukturë të përbashkët: tempoja, proporcioni, ritmi, simetria.

"Muzika është një sekuencë tonesh; matematika një sekuencë formulash", thoshte. Nuk ishte metaforë romantike, por bindje strukturore.

Idhulli i tij ishte John Coltrane. E admironte për kërkimin formal, për atë që e quante "gjeometri muzikore". Krahas tij qëndronte Fausto Papetti, më melodik, më sentimental. Gjergji lëvizte mes këtyre dy poleve: rigorozitetit dhe lirizmit.

Në repertorin e tij përfshiheshin "Bolero" e Ravel-it, "Rapsodie" e Debussy-së, pjesë nga Bizet. I interpretoje pa partiturë. Kujtesa muzikore tek ai ishte formë përqendrimi, jo spektakël.

Nën hijen e biografisë

Por koha nuk ishte neutrale. Letra anonime u dërguan në drejtori. Fjala "deklasu" u përdor sërish. Ai u kthye një ditë në shtëpi i zbehtë, i heshtur. Nuk dramatizoi. Thjesht u tërhoq pak më shumë në vetvete.

"Sa duhet të hesht kur zemra flet", tha një herë, duke cituar Dostojevskin.

Lexonte Benussi-n, shfletonte libra rusë mbi mjeshtrat e muzikës. Shkruante fragmente idesh në copa letrash, si një ritual privat për të mos humbur mendimin.

Gradualisht, në të u krijua një përcarje e brendshme: mes energjisë krijuese dhe presionit të jashtëm. Muzika mbeti e vetmja hapësirë ku ai ishte plotësisht i lirë.

Një natë interpretoi një solo të gjatë: nga "Il mondo" te "Besame Mucho", nga ritmet latine te improvizimi jazz. Saksofoni nuk demonstronte virtuositet; artikulonte një gjendje. Ishte një performancë e trishtë, por e kontrolluar.

Të nesërmen dorëzoi saksofonin në teatër. Pa deklarata.

Largimi

Transferimi për në Shkodër erdhi më vonë. Arsyeya zyrtare ishte gjendja shëndetësore e nënës. Arsyeya reale ishte lodhja e një beteje të pabarabartë.

Kur u ktheva nga Tirana për pushimet e Vitit të Ri, dhoma e tij ishte bosh. Mbi komodinë kishin mbetur fotot e saksofonistëve dhe një vazo me jaseminë të vyshkur. Një gazetë "Drita" mbante adresën e tij në Shkodër.

Prania e tij mungonte jo si zë, por si frekuencë.

Epilog

Vite më pas, pas vdekjes së babait tim, erdhi një telegram nga Shkodra. Ishte më shumë se telegram; ishte një letër e shkurtër, me mirënjohje dhe përmallim. Ai shkruante se do të na kujtonte gjithmonë si familjen e tij.

Figura e tij më mbetet si tipologji e intelektualit të heshtur: njeri i disiplinës mendore dhe i pasionit artistik, i vendosur në një kohë që nuk i përkiste plotësisht. Tek ai etika dhe estetika nuk ishin dy fusha të ndara; ishin e njëjta rezistencë.

Dueti i pasioneve, matematika dhe muzika, në fund mbeti solo.



Rajo sikur u godit prej rrufesë. Shkak ishte një pëllumb i gabuar. Ishte një dritë e lehtë e bardhë, puplore që e kishte bërë dhomën e madhe të pritjes pjesë të qiellit. A jam në vete, a s'jam? Tundi e shkundi kokën fort, po pamjet në internet, po e çmendnin krejt. Ishte ai, pikërisht ai, RRR me atë grua të hatashme në skena të ndyra seksi. Një dritë e murrëtyer mbuloi gjithçka, jo, jo, ajo hënë s'kish qenë pëllumb, po demon i shfytyruar për ta gënjyer. Në çdo kuadër ishte vënë diçitura; Mbylle gojën, përndryshe këto pamje do të nisin një udhëtim skandali nëpër botë. Fjala skandal e katandisi në një peshë aq të lehtë, sa ra nga karrigia. Dhe kush, RRR, ky burrë...

Kthehej nga një udhëtim i mërzhitshëm, nga një dështim. S'po i ecte fare kohët e fundit. S'kishin më nevojë për të, për doktor profesorin e dëgjuar, veterinerin e rrethit. Pothuajse nuk e thërrisnin më. Humbën ato poste e tituj që mbante dikur, gjer dhe Kryetar Komiteti, privilegjet dhe dinjiteti kishin marrë rrokullimën. Vitet kishin bërë të tyren, ai po plakej, ndërsa jeta përçark kishte marrë tjetër drejtim. Ore, po s'kishin nevojë dhe pikë. Vetëm më të rrallë i bënin zë, po s'i jepnin shumë. Këto ankesa kishte dhe i kunati, orëndreqës, i cili me sot e me nesër mund ta mbyllte dyqanin.

E donin, e çmonin si një njeri të zotin, të ndershëm, të lidhur me regjimin që shkoi e që s'kish ndërruar bindje, megjithë ndryshimet që kishin ngjarë rrokopujshëm. Familje e nderuar, fshehur e humbur, larg mëkateve e ndyrësive të kohës. S'i kish dalë as një majë thua ndyrësi në drejtim të moralit. Madje, thonë se, edhe kur fuste dorën e mbështjellë me qese plot me spermë demi në organin gjenital të lopës mbyllte sytë e kthente kokën nga ana tjetër me turp. E po dihej, që RRR ishte fanatik. Kishte dy fëmijë që i morën rrugën e mërgimit dhe ai rronte vetëm me gruan, një partizane e flaktë kundër abortit.

Ai kish bërë bujë e pat sqaruar përfundimisht pozitën e tij politike e shoqërore (kjo kish rëndësi më fort tani në kohën e kapitalizmit) kur kish hapur me dy miq restorantin Drapër e Çekan. Kish mbledhur andej- këndeje nëpër familjet e përmbysura gjithë atë rekuizitë të partisë së punës; vepra të Enver Hoxhës, pothuaj të 100-tat, me lidhje speciale me atë letrën ekstra të blerë me ar në Austri, shallë aksioni, xhaketa, këmbë, këpucë të ish byroistëve, kravata, pantallona, fotografi të ndryshme të asaj kohe, fletë nderi, diploma për kryerje të detyrave me temp revolucionar, veshje partizane, kapele me yll, çizme ushtarake, kallëza gruri, makinë shkrimi, me një fjalë gjithë ato sende e parulla propagandistike që evokonin kohën komuniste. Nga një altoparlant i madh në mes të restorantit, si ato altoparlantët e dikurshëm vesh elefantit që nguleshin në sheshet e qyteteve të vegjël, buçitnin këngë partizane, këngë masash, këngë të zgjedhura nga festivalet në Radio-Televizion, të para 90-tës.

Përballë restorant Drapër e Çekan ishin sërë -sërë; një pab, që quhej Amerika, një internet kafe (dikur qendër e edukimit politik), bilardoja (ish dyqni i metrazheve) butik Venecia (ish furra e bukës) që shkëlqenin me bujë nga reklamat e zhurmonin nga të rinjtë.

S'kishin dhe aq fitim. Vinin pleq në mëngjes, merrnin një kafe me ujë depozite dhe çoheshin kur binte errësira. Servirej si dikur pilaf, makarona, byrek me gjizë, kos dhe bukë e zezë. Kishte dhe plot raste që i provokonin; vinin djem të rinj të droguar, të yshtur nga ata të partisë tjetër, me ndonjë femër me minifund që zbulonte tangat e gjoksit hata, me njerën thithkë të fryrë ngjyrë manushaqe të nxjerrë jashtë, e cila s'e kishte për gjë të tregonte me epsh të fshehurat e sojme edhe më tepër se aq, teksa kërcenin hit pop në mes të

ROLAND GJOZA

Pornografia

tregim



parrullave dhe pleqve të hardallosur që hiqnin koburet dhe shtinin në tavan. Të gjithë përfundonin në polici për mbajtje armësh pa leje e prishje të qetësisë publike, po pas një nate të kaluar në parburgim nxirreshin herët në mëngjes për të mos nxitur ndonjë revoltë qytetare me pasojë të paparashikueshme. Restoranti që ish mbyllur vetëm për një ditë hapej sërish të nesërmen dhe niste si zakonisht rituali; piqej kafeja me qebap të zi sterrë dhe, nepër hiriin e prushnajës gjysmë të fjetur të tre mangallëve të mëdhenj mbi banak, viheshin mbi njëzetë xhezeve me bisht te gjatë. Mullinjtë e vjetër prej bakri e xingoje kalonin dorë më dorë dhe, kur kish shume myshterinj, viheshin ne pune dhe ca plitka të vogla me korent apo dy tre gazuqe e ajo e uruar kafe taze "moskovoliste" tërë lagjen, siç shpreheshin të kënaqur pleqtë, që mblidheshin kokë më kokë dhe këndonin përmallshëm ato të sojmet e të paharruarat e maleve me dëborë kur kërcënte dyfeku. Ndonjë sojli sillte havanin e lashte prej guri, një havan stambolli 250 vjecar dhe aty bluante kafene. Loni i havanit mbahej kampion i kafese, se ç'pihej prej asaj rrahje ne gur te kokrres qe behej bersi e që tjetërloj e leshonte ate lengun e bekuar ne filxhanet e asaj kohe, te vinte mendja verdalle prej nepsit qe kish gjetur më në fund karar. Shpesh disa prej tyre mbanin mbi krye kapele të vjetra partizane me yll të ciflosur, ndonjë merakli i krisur vishte e mbathte rrobat partizane e çizmet e stërmballosura e të qepura me fendyell me kambale gjer lart e me spango me dyllë. Po kishte dhe nga ata që lexonin qarkoret e ruajtura në sëndukë dhe shfletonin gazetatat e luftës bërë fërtele dhe letrat e ronitura që këmbenin me njëri-tjetrin gjatë asaj kohe, të ruajtura këto relike të çmuara në vende

që s'i dinte njeri. E, ç'vante aty brenda! Po kur bënin këmbë turistë dhe fotografonin me kaq zell dhe linin mendtë e kokës me ata pleq të roitur që rronin plotësisht në një kohë tjetër?! Po kur bënin ballë udhëtarë të huaj e të lodhur, që në fillim s'vinin re asgjë, pa po të ishte aty e të shikoje pastaj si ngriheshin papritur me uturimë duke vënë buzën në gaz dhe ia mbathnin sikur të kishin hyrë në një çmendinë. Sa herë ia kishin thyer xhamat atij restorantit, sa herë kishin shkruar në portë; restorant prostati, ose restorant pordha.

Tani u ndanë punët; gjysma e qytetit e donte, gjysma tjetër e përçeshte dhe e tallte RRR-në. Po ama për i ndershëm mbahej i ndersheëm, karat i pastër.

Ja, kthehej asaj nate nga një lindje e vështirë e një lope dhe papritur ndjeu uri të madhe, i hahej e i pihej diçka me domosdo. Ku të shkonte? Mbyllur të gjitha. Parkoi makinën diku dhe eci në këmbë të gjente ndonjë vend ku të merrte diçka për të ngrënë. Ky ishte një qytet i vogëlth, një orë larg qytetit të tij, ku s'kishte fort të njohur.

S'ka fare rini, pëshpëriti, ka humbur dhe ajo xhiroja e madhe që bëhej dikur, xhan xhin, sikur janë futur njerëzia në kotecë bashkë me pulat. Ç'kohëra erdhën!

Zotni, mos kërkoni diçka për të kaluar kohën? e pyeti dikush me një zë fort të dashur. Ishte një djalë rreth të tridhjetave.

Dua të ha, po të gjitha qenkan mbyllur.

O, fare kollaj, e mbaj unë hapur.. Jam kthyer nga Greqia me gruan e dy fëmijët dhe kemi hapur një lokal si atje. Ç'bënte afendikoi grek, një pronar i nderuar e i njohur në Kretë, e bëjmë ne tani këtu.

RRR u interesua menjëherë të merrte vesh pse ishte kthyer djali dhe ç'lloj restorantit kishte hapur. Po më fort i pëlqente të rremonte për mendimet e tij. Ishte e kotë

t'i thoshte se edhe ai kishte një restorant, pa marrë njëherë vesh ç'pikpamje kishte.

Dolën nga qyteti pasi bënë disa hapa dhe pas një çerek ore u gjendën para një shtëpie përdhese në mes të një lirishte me kavakë. Përreth kishte kodra dhe një fushë tërë, larg tutje diku u dëgjua fishkëllima e trenit. Shtëpia ishte krejt e mënjanuar dhe s'para binte në sy.

Kemi pak muaj që e kemi hapur, tha djali, po e kemi ende vështirë për kliente. Veç ata që bujtin këtu, se kemi dhe nja dy dhoma, që i japim me orë, mbeten të kënaqur me gatimin tonë mesdhetar.

Pse u kthyet?

Nuk durohet kapitalizmi. E dini si është puna, zotëri, besoj do të më kuptoni, ngaqë më dukeni intelektual, kur ke skllëvër dhe i quan të tillë është diçka, po kur skllëvërit i quan qytetarë është e padurueshme. Ja, kështu thotë një filozof. Na shfrytëzuan kafshërisht. Kur e kujtoj atë periudhë që kam punuar në Greqi më dridhet mishtë.

U kënaq RRR me këto fjalë plot me mllefe të djaloshtit për kapitalizmin.

Dëgjoni, o i panjohur, shtoi djali me keqardhje për veten, kam dy fëmijë, po dyshoj.. më kuptoni? Jo se ka ndodhur vërtet diçka, po ata, grekët e kamur, janë aq të qelbur sa nuk pyesin.. Po tani që jemi kthyer në shtëpinë tonë jam fare i qetë.

Qënke i sinqertë, djalosh, tha RRR i kënaqur vërtet me këtë emigrant të penduar. Edhe unë kam dy fëmijë. E shitën atdheun. Ikën. Ah, sikur të më ktheheshin një ditë..

Do të kthehen, patjetër do të kthehen!

Në këto fjalë e sipër u hap dera dhe RRR pa një grua të qeshur që e ftoi brenda. Përshkoi një korridor të vogël dhe u fut në një dhomë me një tryezë dhe katër karrige. Nga dritarja me perde të kapura anash me fjonjo dukej një mullar nën dritën e hënës. Dhe aty në majë diçka e kuqe si.. I bënin sytë, apo ishin vërtetë... një palë breçka me dantellë?

Djali e shoqëroi; hëngrën brinjë qengji, qoftë, suxhukë me erëza, djathë, ullinj, sallatë me rrepa të kuqe dhe pinë verë. Gruaja nuk u shfaq asnjëherë, si duket ajo gatuante. Pas pak djali solli një tepsi me gjeldeti me përshesh me arra, bajame dhe stafidhe. Në kohën që RRR do të vinte thikën për të prerë kofshën e gjeldetit, djaloshi nxorri çakmakun dhe ai mori menjëherë flakë. Ishte një pamje vërtet magjepsëse.

Piu gati një shishe me verë, që e dogëndisi ëmbël dhe sakaq mori vesh se djali e prodhonte atë vetë, nxirrte vajin prej ullishtave të tij dhe djathin prej bagëtisë së vet.

Edhe kjo i pëlqeu RRR-së, ndonëse s'kishte ç'të mësonte prej kësaj përvoje që gjithsesi ishte e importuar. Muzikë s'po dëgjonte, veç bulkthat jashtë t'i merrnin mendtë.

Po ç'donin vallë ato si breçka të kuqe mbi mullar? E, dreq o punë, kishin dhe dantellë, pale, ç'të ishte kjo nxitje kaq tmerruese prej dehjes që po i vinte si një përkëdhelje nga vera e kuqe e vreshtës së kësaj mençe të harruar? O, ç'verë! Seç i vinin ca ndjesi që prej fundesh e ai s'donte t'i qaste. Po shkante vonë, ja hëna s'ishte më, e kishin zënë kavakët, gruaja do të qe bërë merak patjetër dhe ndoshta e kish marrë në celular, po ai s'kish qejf t'i hidhte një sy, se një përçetje në vende ku s'rrëfehej po ia ndiznin mishrat sikur t'i ishin përshkuar në hell. Po thekërrizet në një zjarr të avashtë si të ishte një cchap e po kullonte lëng, një lëng veshullor i bëhej se i rridhte vetiu nëpër kofshë.

Sa bën? pyeti.

S'keni mbaruar, i tha djaloshi, keni dhe diçka tjetër që t'i japim fund kësaj darke e të mos e harroni kurrë. Më ndiqni.

I shkoi pas, siç i tha, se iu zgjua dhe kureshtja e ustait të restorantit, ç'kish për t'i servirur tjetër ky djalosh, që edhe pa këtë thellë mbi bisht, ia kishte kaluar me të

vetmen gjë, që s'mund t'ia arrinte kurrsesi, verën e vreshtës së tij, që dinte ta seliste e ta ujdite si qëmoti. Ç'kundërmim trulllosës dhe ç'forcë që e kish kapluar prej saj.

E la para një dere dhe iku.

Doreza u ul vetë, siç duket prej një dore nga brenda dhe dera u hap me gërvimë. Ai zgjati kokën dhe pa një shtrat të hapur përplot dantella, dritaren e hapur përballe ku dukej mullari bashkë me atë cohe të kuqe drithëruese që po e ndjente me kaq ëmbëlsi çuditërisht, ndërsa me mendje e mallkonte, po pa fuqi.

Eja, afrohu, kjo është gjella e fundit greke. Provoje dhe ke për të mbetur i kënaqur.

Ku ishte gjella? Ç'ishte ai zë gruaje aq i ëmbël e dalldisës, që t'i merrte mendtë?

Këndeje, ec, nuk i paske sytë në ballë?

O, sa po i pëlqente ky zë ndjellës. Ndoshta në këtë dhomë do t'i servirin ëmbëlsireën, desertin, siç i thonin në gjuhën e frengut, ndonjë thagmë që vërtet do ta mbante mend. E pse të mos e provonte? Po na doli që ishte një femër, e cila bëri ballë nga një kthinë që shërbente si banjo, ashtu e sapolarë, lëshoi një kundërmim kopshtesh kur ndjehen bujshëm teksa çahen bumbeskat që të ngjisin në dorë e të këndellin ditën e parë të pranverës, e mbështjellë me një peshqir të madh të kuq flakë.

Ishte ajo, e zonja e shtëpise, që e priti kur bëri këmbë së pari, la t'i binte peshqiri poshtë në dysheme mbi qilim dhe i zgjati dorën. Nuk kishte parë kurrë tjetër kurm veç atij fishkaraqit, kokallemadhit pa mish e të hidhurit fort si tym oxhaku të gruas së tij.

Krejt lakuriq, e brydhtë, e rrumbullt, aq fort tundues, sa të shkulte trurin nga vendi, dy kofshë të gjata pa një rruadhë, vezulluese, të puqura, me njërin gju të përthyer pakëz e të lëshuar përpara si një ftesë për. Oh, ato breçka të kuqe me atë dantellë delikate, po, po njëlloj si ajo e mullarit, që ajo i preku me gishtërinj, i uli pakëz me dhele duke zbuluar majën e pubisit dhe i la t'iu kërciste iltastiku. Dora u zgjat, e kapi të tijen që sikur s'donte në fillim dhe e tërhoqi drejt shtratit.

Ai nuk mbante mend shumë gjëra, se ndjehej si i bymyer e në hava e pa shumë kujtesë, veç me një dëshirë e një zjarr buçitës që i rrihte si çekan përposhtë e i dhimbte ëmbëlsisht, po ama i kujtohej se me atë grua bëri ato që s'i kishte bërë kurrë me gruan e tij dhe ndjeu më në fund ngopje trulllosëse e thuaje aspak pendim e pastaj i tha vetes, jo, s'do t'ia falte kurrsesi vetes, se tani le të vdiste! Ai i tha këto fjalë, a mund të besohej?


Pastaj kur zbriti poshtë nxorri gjithë ç'kishte në kuletë, dhe ndërsa ia numuronte paratë, plot 70.000 mijë në dorë djaloshtit, që i dha në këmbim të tyre një letër, doli hëna përsëri dhe ai pa mbi mullar me një ndjenjë triumfi, që e quajti të ulët, dhe një palë breçka të tjera, të kuqe flakë, që sikur i qeshnin paturpësisht, pra ishin bërë dy të tilla, që hëna iu lëshonte prej lart argjend e dukej sikur i bekonte. Ç'thua, o i çartallosur, ti s'flet kështu, kush të ysht të biesh në mëkat, i pëshpëriti vetes, po buzagaz prej endjes që po e turbullonte sërish e po e tundonte me një dhimbje të ëmbël e me një fuqi të huaj. O zot, pse më vë në provë kaq të vështirë?

Kur po largohej dëgjoi pas krahëve zërin e djaloshtit;

Mos e humb atë letër që të dhashë, ke adresën dhe numrin e telefonit të restorantit si dhe një sekret që duhet ta dish vetëm ti dhe jeni i mirëpritur në çdo kohë.

Tani ja ç'po i shihnin sytë në e-mailin e tij, një xhirim diskret, ndoshta i bërë me celular, ai dhe ajo në një akt seksual të paparë, që ishte gati të bënte xhiron e botës. Dhe në fund fare, kur kuadri ngriu, dolën fjalët mynxyrë; Nesër, restoranti yt, nga Drapër e Çekan, duhet të quhet Pornografia, përndryshe...

Ah, kjo ishte e padurueshme. Vdiq. Autopsia nxorri se kishte konsumuar një sasi jo të vogël droge.



Bota si një galeri: Si arti na mëson të shohim, të kuptojmë dhe të jetojmë më bukur

Përse njerëzit e suksesshëm e njohin artin

Dr. Bledar Kurti

Njerëzit më të suksesshëm e të plotësuar që kam njohur në jetë janë njohës të thelluar të artit. Kjo, pasi forca e artit është më e madhe nga sa mendohet rrodomë.

Arti nuk është vetëm një formë zbulimi apo një kënaqësi estetike që njeriu e konsumon në muze apo galeri. Ai është një mënyrë e veçantë për të parë botën. Njeriu që ka njohuri për artin dhe ka ushtruar syrin e tij përmes pikturave, skulpturave apo veprave të tjera artistike, fillon ta shohë realitetin me një dimension, ndjeshmëri dhe vëmendje të ndryshme. Peizazhet e përditshme, fytyrat e njerëzve, skenat e zakonshme të jetës marrin një dimension tjetër. Ato i kujtojnë atij kompozime, drita dhe ngjyra që i ka parë më parë në tablo të ndryshme. Në këtë mënyrë arti bëhet një filtër përmes të cilit përjetohet realiteti.

Shpesh ndodh që një person i apasionuar pas artit, duke ecur në rrugë apo duke parë një pamje të thjeshtë të natyrës, të ndjejë menjëherë një lidhje me një pikturë që ka parë dikur. Një përdim dielli mund të rikujtojë atmosferën e një tabloje impresioniste; një rrugicë e vjetër me ndërtesa të zverdhura nga koha mund të ngjallë ndjesinë e një pikturë realiste; ndërsa një fytyrë e menduar mund të duket si një portret i dalë nga një galeri klasike. Kjo nuk ndodh rastësisht. Arti e ushtron syrin e njeriut për të vërejtur detaje, kontraste dhe ritme që shumica e njerëzve nuk i shohin menjëherë, madje as kurrë.

Në këtë kuptim, arti nuk është vetëm një objekt për t'u parë, por edhe një mënyrë për të mësuar të shohësh. Kur njeriu qëndron përpara një pikturë dhe përpjetet të kuptojë strukturën e saj, ai mëson të dallojë raportet mes figurave, tensionin e kompozimit dhe harmoninë e ngjyrave. Këto aftësi vëzhgimi kalojnë më pas në jetën e përditshme. Një person i stërvitur me artin fillon të dallojë më qartë gjendjet emocionale të njerëzve përreth, mënyrën si qëndrojnë, si reagojnë dhe si ndërveprojnë me njëri-tjetrin.

Vëzhgimi i veprave artistike, veçanërisht i portreteve dhe skenave të jetës, e ndihmon njeriun të kuptojë më mirë karakteret njerëzore. Në pikturë, një shikim i përhumur, një pozicion i duarve apo një dritë e vendosur me kujdes mund të zbulojë një histori të tërë psikologjike. Kur njeriu mëson të lexojë këto shenja në art, ai bëhet më i aftë t'i lexojë edhe në jetën reale. Një buzëqeshje e detyruar, një heshtje e gjatë apo një lëvizje e pavetëdijshme mund të

tregojnë shumë për gjendjen e brendshme të një personi.

Një njeri i kultivuar mirë me artin arrin të njohë personalitetin e tjetrit brenda pak sekondave, pasi tiparet e fytyrës apo porpocionet trupore janë deklarata të qarta mbi natyrën e brendshme, manifestime të gjendjes psikologjike, traumës, e madje edhe shëndetësore. Në këtë mënyrë arti bëhet një shkollë e thellë e psikologjisë njerëzore.

Artistët, përmes veprave të tyre, kanë studiuar për shekuj me radhë emocionet, konfliktet dhe dëshirat e njeriut. Kur shikuesi i kushton vëmendje këtyre veprave, ai në një farë mënyre hyn në këtë laborator të ndjenjave njerëzore. Ai fillon të kuptojë më mirë dramën e heshtur që shpesh fshihet pas fytyrave të zakonshme të përditshmërisë.

Përveç kësaj, arti e zhvillon tek njeriu një mënyrë të veçantë të menduarit. Një pikturë nuk është vetëm një imazh; ajo është një kompozim i ndërtuar me kujdes. Çdo element ka një vend dhe një rol. Linjat drejtojnë shikimin, ngjyrat krijojnë atmosferë dhe kontrastet prodhojnë tension apo qetësi.

Kur njeriu mëson të kuptojë këto struktura, ai fillon të mendojë në mënyrë më kreative edhe në fusha të tjera të jetës. Kompozimi artistik është, në një farë mënyre, një model i të menduarit strategjik. Ashtu si një piktor vendos se ku duhet të jetë figura kryesore dhe si duhet të shpërndahen elementet e tjerë përreth saj, edhe një profesionist në fusha të ndryshme duhet të organizojë ide, njerëz dhe burime për të arritur një rezultat të caktuar. Në punë, në biznes apo në organizimin e projekteve, kjo aftësi për të parë strukturën e përgjithshme të një situatë është jashtëzakonisht e vlefshme.

Në politikë, për shembull, të menduarit në mënyrë "kompozicionale" mund të ndihmojë në kuptimin e marrëdhënieve mes grupeve të ndryshme shoqërore. Një lider që di të shohë panoramën e përgjithshme dhe të kuptojë balancat mes forcave të ndryshme mund të marrë vendime më të mençura. Në këtë kuptim, arti nuk është thjesht një aktivitet estetik, por edhe një ushtrim për të menduar jashtë kufijve të zakonshëm.

Shprehja "të mendosh jashtë kornizave" shpesh lidhet me kreativitetin dhe inovacionin. Arti është ndoshta një nga mënyrat më të fuqishme për ta zhvilluar

këtë aftësi. Artistët gjithmonë kanë sfiduar rregullat e kohës së tyre dhe kanë kërkuar forma të reja shprehjeje. Duke u përballur me këto eksperimente artistike, edhe shikuesi mëson të mos e pranojë realitetin vetëm në formën e tij më të zakonshme, por të kërkojë gjithmonë perspektiva të reja.

Një tjetër ndikim i rëndësishëm i artit është rafinimi estetik që ai sjell në sjelljen e njeriut. Kur dikush është i rrethuar nga bukuria, harmonia dhe eleganca e veprave artistike, ai fillon të zhvillojë një ndjeshmëri më të hollë ndaj mënyrës se si sillet dhe komunikon me të tjerët. Estetika nuk mbetet vetëm në nivelin e shikimit; ajo kalon në mënyrën e të folurit, të lëvizurit dhe të ndërveprimit me botën.

Një person që është edukuar me artin shpesh shfaq më shumë durim, vëmendje dhe respekt ndaj detajeve. Ai është më i prirur të dëgjojë, të reflektojë dhe të kuptojë kompleksitetin e situatave njerëzore. Në këtë kuptim, arti ndikon edhe në formimin moral dhe kulturor të individit. Ai e bën njeriun më të ndjeshëm ndaj bukurisë, por edhe ndaj vuajtjes dhe përvojave të të tjerëve.

Ndikimi i artit nuk është vetëm kulturor apo intelektual; ai është edhe psikologjik dhe shëndetësor. Studime të shumta kanë treguar se kontakti me artin mund të ketë një efekt qetësues dhe terapeutik tek njeriu. Kur dikush përqendrohet në një pikturë, dëgjon muzikë apo krijon diçka me duart e tij, mendja hyn në një gjendje përqendrimi dhe qetësie që redukton stresin dhe ankthin. Shkollat e mjekësisë po integrojnë lëndën e historisë së artit në kurrikulat e tyre pasi kompozimet artistike ndihmojnë mjekët të aftësohen më shumë në diagnostifikimin e sëmundjeve, ndërkohë që pacientët me probleme kardiovaskulare apo neurodegenerative inkurajohen të shkojnë në galeri arti pasi ndihmon gjendjen e tyre shëndetësore.

Arti i jep njeriut gjithashtu një hapësirë për të reflektuar mbi vetveten. Në një botë të mbushur me ritëm të shpejtë dhe presione të vazhdueshme, ky moment ndalese është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Përmes artit, njeriu mund të përballet me emocionet e tij, t'i kuptojë ato dhe t'i shprehë në mënyrë kreative. Ky proces shpesh ka një efekt çlirues dhe shërues.

Në shumë vende të botës, arti përdoret edhe në terapi psikologjike. Piktura, vizatimi apo aktivitetet krijuese ndihmojnë njerëzit të shprehin ndjenja që ndonjëherë janë të vështira për t'u artikuluar me fjalë. Përmes ngjyrave, formave dhe figurave, individit mund të tregojë historinë e tij të brendshme dhe të gjejë një mënyrë për ta përpunuar atë.

Në fund të fundit, arti është një pasuri që e pasuron jetën njerëzore në shumë nivele. Ai e stërvit syrin për të parë më thellë, mendjen për të menduar më kreativisht dhe shpirtin për të ndjerë më fort. Njeriu që njeh artin nuk e sheh botën vetëm si një seri ngjarjesh të zakonshme; ai e sheh atë si një galeri të gjallë imazhesh, emocionesh dhe historish.

Kësisoj, mund të thuhet se arti nuk është një luks i rezervuar për një elitë kulturore, por një nevojë e vërtetë njerëzore. Ai na ndihmon të kuptojmë më mirë veten dhe të tjerët, të organizojmë më mirë mendimet tona dhe të jetojmë me më shumë ndjeshmëri dhe harmoni. Në një botë që shpesh bëhet mekanike dhe e shpejtë, arti mbetet një nga mënyrat më të fuqishme për ta rikthyer njeriun tek thelbi i tij njerëzor.

Njeriu pa art mbetet skllav i rëndomësisë, ndërsa ai apo ajo që njihet me artin jeton në liri dhe e kupton tërësisht plotësinë e botës, jetës, njeriut dhe e pret të ardhmen me një vetësiguri familjariteti, sepse asnjë kompozim, sado surreal, të sjellë e ardhmja, nuk do jetë i pakrijuar apo i paimagjinuar në epokat e kaluara të manifestuara përmes artit.

1. Historia e botimit të këtyre veprave

1.1. Parahistoria dhe publikimi i *Nderit të humbur të Katerina Blumit*

Një objekt studimi në çfarëdo rrethane kërkon njohjen e shumanshme të subjektit që merret me të. Njohja, përveç aspekteve formale e përmbajtjesore, parakupton edhe parahistorinë e ardhjes, të origjinës, të asaj që i parapriu, sikundër edhe kontekstit të shfaqjes publike dhe, së fundmi, edhe horizontin e reflektimit nga recipientët që, në njëfarë dore mund të quhet *efekti* ose edhe *ndikimi*, pa u lodhur për të konstatuar në ishte *dëm* apo *dobi*, nëse merrte konotacion *negativ* apo *pozitiv* në hierarkinë e vlerave.

Studiuesi, pra, që merret me një objekt studimi, nuk mund ta njohë atë ndaras nga autori, ose pa e njohur njëkohshëm edhe autorin dhe krijimtarinë e tij, së paku deri në stadin e shfaqjes së objektit.

Hajnrih Bëli, diku në vitet e para të pasluftës (1947/48) shfaqet me tregimet e para. Një vit më vonë boton veprën me përjetime nga lufta, *Treni ishte i përpiktë* dhe dy vjet më vonë shfaqet me romanin antiluftë *Ku ishte ti Adam?* Këtu e këtej vazhdon seria e botimit të romaneve të tij që e bëjnë të njohur, madje edhe në përmasa ndërkombëtare, deri në kurorëzimin me çmimin "Nobel".

Duke qenë një krijues që në filltet e punëve letrare mund të trajtohej si vazhdues i *brezit të humbur* me Gertruda Stejnin, Ernest Heminguejin e të tjerë, në fazën e dytë ai duket sikur bëhet prijatar i një brezi po kaq të rëndësishëm, që do të quhet *brezi i luftës* ose *i gërmadhëve të luftës*.

Ma thotë mendja se të Bëli, jo për arsye formale e skematike, po para së gjithash për shkak substanciale të krijimtarisë, mund të vërehet edhe faza e tretë, ajo e angazhimit intelektual në plan të vlerave universale të njerëzimit.

Një vit pas publikimit të romanit *Portret grupi me Damë*¹, Bëli nderohet me çmimin "Nobel" (1972). Fjalimi i tij me rastin e ceremonisë së pranimit të këtij çmimi, formuluar në trajtë diskursive, *Një ese mbi arsyen e poezisë*, është padyshim dëshmia e pjekurisë kulmore intelektuale e krijuesit të tij. Mu në këtë frymë na vjen romani *Nderi i humbur i Katerina Blumit* (1974) që në shkrimet kritike shpesh përvijohet edhe mundësia e një nëntitulli në trajtë pyetëse e dileme: *Si krijohet dhuna dhe ku mund të shprijë ajo?*² Në esenë që shumë ngjohet me herët, ai trajton, pos të tjerash, edhe observimin e tij mbi aktin krijues, mbi procedurën e krijimit letrar, mbi filozofinë e jetës që, në instancë të fundit, mund ta quajmë *krede* të tij. Në këtë frymë i gjej të kompozuar edhe pesë a gjashtë kaptinat e para të *Nderit të humbur të Katerina Blumit*. Këtu narratori, po e quaj kushtimisht *i zhvendosur* ose *i shpërvetuar* (i depersonalizuar) flet krejtësisht me gjuhë diskursive për veprimin e romanit, si të ishte ndonjë kritik me qëndrim distancues ndaj veprës: "Po qe se ky tregim, meqë po flasim kaq shumë për burime, të krijoj herë pas here përshtypjen e "rrjedhës", na duhet të kërkojmë ndjesë për këtë: kjo gjë ishte e pashmangshme. Kur ke të bësh me "burime" e me "rrjedhë", nuk mund të flasësh për kompozicion; në vend të tij mund të përdorim ndoshta nocionin e kanalizimit, dhe ky nocion është i qartë për këdo, i cili, kur ka qenë fëmijë (po ndoshta edhe i rritur), ka luajtur me pellgje uji, duke i lidhur ato me njëra-tjetrën me anë hullish e brazdash të vogla, duke i zbrazur e duke i devijuar, gjersa arrinte të mblidhte gjithë sasinë e ujit të pellgjeve në një kanal të përbashkët ... na duhet t'i lutemi lexuesit që të bëjë pakëz durim, mbasi në këtë mes

1 Titullin e këtij romani Kadare e jep si: *Portret grupi me një Damë*.

2 Shih te *Kronologji e jetës dhe e veprës së H. Bëlit...* Wikipedia... etj.

Studim krahasues: "Nata me hënë" i I. Kadaresë dhe "Nderi i humbur i Katerina Blumit" të H. Bëlit

Nga Vjollca Dibra
(Fragment nga libri)

luajnë njëfarë roli edhe ndryshimet ose barazimet e nivelit, sepse, fundja, ekzistojnë edhe ndalesa, prita, grumbullime rëre, kanalizime gjysmake dhe burime që "nuk vijnë dot të gjitha njëherësh", si dhe rryma të nëndheshme etj. etj."³

Është pra e njëjta gjuhë, tashti e mendimitar të shqetësuar për fatin e njeriut në përmasë universale, nën trysinë e pushteteve të forcës, po jo rrallë edhe të anarkisë, të forcës së pakufizuar të shtypit bulevardesk që, të prirë nga makutëria e babëzia pas parasë nuk e kanë për gjë që me logjikën e sensacionit të shkelin mbi moralin dhe të drejtën e individit të pambrojtur, të cilin doemos do ta shtyjnë drejt një akti vetëgjyqësie, derisa nuk gjen përfilljen e arsyes nga pjesa që quhet strukturë institucionale e shoqërisë.

Këtu nuk kemi se si të mos e vëmë re se jemi mu në sfondin dhe atmosferën e asaj pjekurie intelektuale të autorit që karakterizonte paraqitjen e tij në ceremoninë e "Nobelit". S'ka veçse një vit distancë. E para ndodh në mars të 1973-shit, ndërkaq e dyta (koha e shkrimit të romanit) në shkurt të 1974-ës, sikundër edhe koha e të ndodhurës, e ngjarjes së romanit, që Bëli e nxjerr që në nismë të kapitullit të tretë: "Faktet, të cilat

3 Bëli, H. *Nderi i humbur i Katerina Blumit*, vepër e cituar, f. 8/9.



ndoshta do të ishte mirë t'i parashtronim qysh në fillim, janë brutale: të mërkurën, më 20.2.1974, në vigjilje të festave të karnavaleve, një grua e re njëzeteshtatëvjeçare del në një qytet rreth orës 18.45 nga shtëpia e saj dhe nis për të marrë pjesë në një mbrëmje dëfrimi private"⁴.

Fakti që pas publikimit të këtij romani autori nuk rroi veçse edhe njëmbëdhjetë vjet të tjera dhe publikimet ndërkohë

4 Po aty, f. 9.

s'ishin veçse përzgjedhje e përmbledhje veprash, dëshmon se ai e kishte derdhur gjithë potencën krijuese, *pa pardon* - si thuhet. Ç'është e vërteta, bibliografisë së tij i shtohen edhe dy vepra pas vdekjes: *Gratë në lumë* dhe *Engjëlli heshti*, sikundër edhe një seri aktiviteteve që mund të konsiderohen pjesë e dekorit të skenografisë së paraqitjes së performancës komplete të këtij shkrimtari të madh: Pritja e disidentit rus Aleksandër Solzhenicin në shtëpinë e tij në Langenbroich - Köln; Marrja e çmimit "Carl-von-Ossietyky-Medaille" nga Lidhja Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut; Angazhimi në Lëvizjen për paqe, ku ai mban fjalim në demonstratën e parë në Bon kundër vendimit të NATO-s për armatim shtesë.

Më duket shumë i rëndësishëm sidomos viti i fundit i jetës së tij, sepse na përafrohet me një pikë kulmore që i korrespondon objektit tonë të studimit krahasimtar: Takimi dhe njohja me Kadarenë, me autorin që e bënte gati për shtyp romanin *Nata me hënë*, po me këtë njëje do të merremi më vonë në kapitullin për biografinë dhe kronologjinë e jetës dhe veprës së të dyve.

1.2. Parahistoria dhe publikimi i *Natës me hënë*

Diku më sipër kemi zënë ngoje prirjen e Kadaresë që shkrimin, krijimin letrar ta konsiderojë si një aventurë që, jo rrallë, rezulton si përballje dhe provokim i vetë fatit të tij, duke ngacmuar e gërricur pjesën e paprekshme mistike e misterioze të superqenies shtet, mbështjellë me membranën pushtet ose, edhe më tej, diktaturë. Një lojë e përvdekshme si me zjarrin prometean të perëndive, si me stuhitë, tërmetet, vullkanet. Ai nganjëherë futet në këto zona, gjithsesi me ndërgjegje e vetëdije, po duke e afishuar gjoja padjallëzinë si një kuqesh-ti për të provuar të ndaluarën, të palejueshëm, haramin të sanksionuar nga perënditë tokësore, ngjashëm me Danten që na e shfaqte Ferrin ditën për diell.

Në romanin *Muzgu i Perëndive të Stepës* ka një sekuençë që merr për pikë referimi periudhën e studimeve në institutin "Gorki" në Moskë. Merr pikërisht ditët e fundjavës, kur studentët (të ardhur nga anë e anë të botës) bënin aheng. Një çast vinte pika kulmore e delirit të dehjes, të cilën autori ynë e quan: çasti i vjelljes së syzheve. Në këtë përçartje, profesoresha e historisë së artit i kujton këtij pikërisht syzheun e romanit *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, madje duke e tërhequr një paralele me *Shpirtrat e vdekur* të Gogolit, një syzhe për të cilin i kishte folur vetë ai, sigurisht në çaste të tilla përhumbëse.

Taktizimet e Kadaresë (le të më lejohet t'i quaj kështu nga shkaku se ngjasojnë me taktikat e zbutësve të kafshëve dhe të egërsirave për cirk) shfaqen që herët, qoftë kur adreson tema mitologjike, historie e politike, qoftë kur trajton aspekte të jetës bashkëkohore. Kështu kishte bërë me *Dimrin e vetmisë së madhe* ose edhe më herët me *Dasmën* (Lëkura e daulles), me *Kështjellën* (Daulla e shiut) e me të tjera.

Syzheun e *Natës me hënë* fillimisht e kishte shpërndarë si rrëfenjë që në stad ideale. Pastaj, si variant në dorëshkrim⁵, pastaj si tregim në revistën "Nëntori", në fillim-

5 Rustemi, Fatbardh: *Them se e njoh Kadarenë*, "Naim Frashëri", Tiranë, 2001.

E çmuara dhe shumë e shtrenjta,
Zonja Helena,

Nga një mikja ime mora adresën tuaj elektronike dhe po ngutem t'ju nis në variantin elektronik (në attachment) studimin tim komparativ, që ka objekt trajtimi "Natën me hënë" të I. Kadaresë dhe "Nderi i humbur i Katerina Blumit" të H. Bëlit. Mbase më i saktë është nëntitulli: "Kontekstualiteti shoqëror dhe artistik i dy kryepersonazheve" (Mariana dhe Katerina).

Me këtë studim para disa muajve kam marrë gradën Dr., për shkencat filologjike në Universitetin e Shkupit.

Para pak ditësh doli nga shtypi në shtëpinë botuese "Toena" me titullin "Heroinat e deheroizuara".

Nuk kam pse ta fsheh: jam shumë kurioze për opinionin tuaj dhe, në mos qoftë tepër pretencioze, edhe të Z. Ismail.

Derisa po formuloja këta rreshta ndjeva nostalgji për letrën e shkruar me dorë, me kallamar a me bojë kine si njëherë e një mot kur na trokiste në derë postieri me çantën e madhe.

Po patët mirësinë të ma bëni të ditur adresën e shtëpisë, unë do t'jua dërgoj me kënaqësi edhe kopjen fizike - librin.

E quaj dhuratë për mua nëse ma bëni të ditur, qoftë edhe me vetëm një fjalë, pranimin e këtij e-maili.

Përsëritetje të zjarrta nga Prishtina e ftohtë!

Juaja, Vjollca Dibra

E dashur Vjollca,

Letra juaj e bukur dhe e ngrohte me dha shijen e diçkaje shumë të mire, që shkaktonte, me sa duket, kulturimi dhe mirekuptimi njerezor. Aq më tepër i shoqëruar nga teksti i doktorates suaj.

E lexova menjehere, madje me kënaqësi të madhe, por ajo që me gezozi me tepër ishte se kur ia dhashe Ismailit per « t'i hedhur një sy », me dëshirën e fshehtë që ta pelqente po aq fort sa une, ndodhi pikërisht ajo që prisja, por që edhe i druheja. Ismaili, i cili është i veshtire ne raste te tilla, e pelqeu ne menyre te pazakonte. Kishte kapercyer me shume se gjysmen e tekstit kur me tha se kishte kohe qe priste te lexonte një gjë të tilla ne mendimin shqiptar. Sipas tij, teksti ishte jo vetem i thelle e i lire, por ishte ne radhe te pare i bukur ne vetvete. Libri sa ç'ishte plot dije dhe informacion, po aq zgjonte kënaqësi estetike, me freskine e tij, me harmonine e brendshme, me tezat qe ngrinte, me gjuhen e gjalle, së fundi me idene e bukur të pershkrimit te raporteve te dy autoreve : gjermanit dhe shqiptarit. Shkurt, libri te zgjonte dashuri per letersinë, gje qe nuk ndodh shpesh me kritiken shqiptare.

E dashur Vjollca, duke ju falenderuar edhe nje here per dergesen tuaj, ju çoj te falat me te perzemerta nga ana e Ismailit gjithashtu.

Ju perqafoj me dashuri,

Helena K.

Sat, Feb 11, 2012, 2:34 PM

Feb 12, 2012, 10:27 PM

vitin 1985 "...si i shtyrë ndoshta nga djalli, apo si ndonjë që me llambë në dorë kërkon në errësirën e kopshtit të vet të verifikojë nëse rreziku ka kaluar, unë botova novelën *Nata me hënë*, shkruan Kadare"⁶. Dhe, nuk vonon kundërpërgjigja. Shkas, natyrisht, bëhet reagimi i një lexueseje në faqet e revistës "Zëri i Rinisë". "Tre muaj pas daljes së novelës ... më 10 prill 1985 autori u thirr në një mbledhje të Lidhjes së Shkrimtarëve, në prani të disa anëtarëve të Komitetit Qendror. E gjykuar si një vepër armiqësore ndaj regjimit, novela u kritikua dhe u ndalua. Kritikuesit e saj mendonin se atmosfera në të paraqiste një realitet socialist të zymtë. Ismail Kadare dëgjon, duron. Ai nuk e di ende që disa orë më parë Enver Hoxha ka vdekur"⁷.

Këtu e deri në të hyrë të viteve nëntëdhjetë nis jeta "ilegjitime" e kësaj veprë.

2. Struktura (forma dhe përmbajtja) e tyre

Koncepti *strukturë e veprës letrare*, përveç formës dhe përmbajtjes së saj, përfshin edhe gjithë përbërësit e nënpërbërësit e tjerë të tyre. Janë një seri elementesh që në raportet krahasimore, goftë si barasvlerë e ngjashmëri, goftë si kundërshti, duhet të kihet parasysh. Në rastin konkret me shprehjen *strukturë* kam parasysh strukturën kompozicionale të këtyre veprave.

Nderi i humbur i Katerina Blumit end rrëfimin në pesëdhjetë e tetë kapituj të shënuar me numra, të paraprirë me një shënim autorial që mund të lexohet si moto e veprës. Përmasa e vëllimit të saj kap një hapësirë prej 150 faqesh (këtu kam parasysh variantin e botimit shqip, ABC - Nobelstët, Tiranë, 2007).

Kapitujt, në pajtim me natyrën e zhanrit letrar, me tipin e shkrimit të raporteve policore, janë të shkurtër, pothuajse nuk kalojnë hapësirën prej një faqeje libri, sidomos nga fillimi. Kësisoj duket sikur ata mbajnë edhe ritmin e shpejtë narrativ, si një teleks policie që prezanton orë e çast të reja që ndërlihen me ngjarjen dhe të tëra së bashku paraqesin mozaikun e fabulës, që bart brenda vetës intrighën, misterin ose më saktë atë shtjellë kureshtjendjellëse që mund të quhet *suspens*⁸. Në aspektin e tërësisë kuptimore që përmban një kapitull, këtu nuk mund të flitet për diçka të këtillë. Ndoshta këta kapituj më lehtë perceptohen si sekuenca, fragmente a ndërfaqe tekstore, diçka si pjesë margjinash që e përplotësojnë dhe sqarojnë rrjedhën kryesore të ngjarjes.

Përmbajtja e kësaj veprë mund të formulohet me pak fjali: Një grua e re rreth njëzeteshtatëvjeçare, e divorcuar, tundohet nga dashuria e beftë me një kriminel të kërkuar. Nisma e kësaj rrjedhe ka topikën kohore: "të mërkurën, më 20.2.1974, në vigjilje të festave të karnavaleve... del në qytet rreth orës 18.45 nga shtëpia e saj dhe nis për të marrë pjesë në një mbrëmje defrimi private" (*Nderi i humbur i Katerina Blumit*, kap. 3). Pothuajse "aksidentalisht", ajo bëhet shënjestër e shtypit bulevardesk. Më saktë, objekt përcjelljeje e mbikëqyrjeje nga gazetari a reporteri Verner Tëtges, i cili, bashkë me padronët e gazetës, kanë një etje të shfrenuar për sensacione. Trysnia dhe shantazhi që i bëhet asaj nga shtypi, duke e denigruar në mënyrë sistematike dinjitetin e saj, privatësinë, jetën familjare (kujto vdekjen e nënës, raportet me ish-bashkëshortin, me miqtë e punëdhënësit) e shpie atë në një



Ismail Kadare dhe Heinrich Böll, në Frankfurt, 1981

gjendje mosdurimi të skajshëm. Nderi i saj i nëpërkëmbur, në mënyrë të veçantë, bëhet shkak që Katerina, duke mos gjetur mënyrë mbrojtjeje nga tirania mediale, ta vrasë atë. Në tërë këtë rrëfim, me pak fjalë, ky është subjekti që bëhet i ditur që në faqet e para të romanit. Madje, do të thosha pjesa kulmore ose kulminacioni - si quhej dikur në mënyrë shkollore pjesa kompozicionale e një veprë. Vënia e kësaj pjesë në fillim është tipike për romanin policor. Gjithë ngjarja zhvillohet brenda intervalit prej shtatë ditësh. Më tej, sipas teknikës së narracionit retardues a të vonuar vijnë e shpalosen detajet, shkaqet, motivet dhe procedurat e hetimit.

Nëse brenda këtij subjekti do të na duhet ta formulojmë në mënyrë më të përafërt boshtin tematik, do të thoshim se është pikërisht nderi, përkatësisht e drejta dhe liria e individit në raport me shoqërinë, rrethin, po edhe me mekanizmat e tjera, si dhuna ose shpërdorimi i lirisë së medias dhe reflektimet institucionale, pushtetore, gjithnjë në konotacion me politikën.

Fakti që Bëli e mbyll përshkrimin e ngjarjes qysh në fillim të tregimit, kur tashmë ndodh paraqitja e vrasëses në polici, dëshmon se tutje në shtjellimin e kapitujve vijues gjurmon për motivet e aktit të tillë. Madje, që në kapitullin 3, autori narrator, që rrëfen nga pozicioni i vetës së parë të shumësit, sikur ngutet të konfirmojë: "Këtu nuk do të flasim shumë për gjak; atij që i pëlqen gjaku i tepërt, mund t'i rekomandojmë t'i ndjek disa programe televizive e filma kinemaje, ku të tilla tmerre ka me bollëk, madje edhe me muzikë! Ne e kemi hallin që të rrjedhë diçka tjetër e jo gjak" (*Nderi i humbur i Katerina Blumit*, f. 10).

Kjo rrjedha tjetër është pa dyshim preokupimi i shkrimtarit me raportet ndërmjet individit e shoqërisë, përkatësisht të individit me strukturat shoqërore, të cilat doemos janë emanacione politike e pushteti, kjo rrjedha tjetër është terreni ku shfaqet vetiu zëri oponent i intelektualit krijues dhe jokonformist. Po ta tjerrim më tej, pse të mos themi edhe zëri kritik?

Le ta shohim tani *Natën me hënë* të Kadaresë.

Vepra në fjalë ka një titull që më shumë asocionon në një serenatë dashurie sesa në përmbajtjen e rëndë që transmeton përbrenda, për ndryshim nga *Nderi i humbur i Katerina Blumit* të Bëlit, e cila bashkë me nëntitullin *Si shkaktohet dhuna dhe ku mund të shpjerë ajo*, thajse që në fillim e shpërfaq adresën e qartë të subjektit.

Po, sikundër e kemi thënë diku më herët, edhe ky sakrament letrar bën pjesë në arsenalin e qëllimshëm e të kamufluar të Kadaresë. Ai sikur do të krijojë mashtrimin optik ose maskën mashtruese para nomenklaturës së pushtetit diktatorial dhe këtë e arrin me kombinatorikën e rrëfimit të dyfishtë: realist dhe simbolizues. "Pasuria dhe larmia e simboleve, shtresëzimi i tyre hierarkik nga më i madhi te më i vogli dhe e kundërta, e, përmbi të gjitha, kupola e tyre e hapësirshme, që, në përfytyrimin pamor ngjan me katedralet e famshme në urbanistikën e qyteteve të mëdha, lejon të thuhet se është një prozë jo vetëm e shkruar me gjuhën e simboleve, por edhe e ndërtuar me lëndën dhe shestimet e veprave simbolizuese"⁹ - do të vlerësojë studiuesi Bashkim Kuçuku. Në këtë plan, ai nxjerr titujt e tridhjetë e katër veprave të Kadaresë dhe zbrërthen simbolet në to. Në titullin e romanit *Natë me hënë* gjen simbolin *hënë* në variantin e parë dhe *natë (me hënë)*, në variantin e dytë, duke iu referuar mendimit të Erih Fromit: "Gjuha e simboleve është, ndoshta, e vetmja gjuhë universale e krijuar prej njeriut, që ka mbetur e njëjtë për çdo qytetërim dhe gjatë gjithë historisë"¹⁰.

Rrëfimi ndahet në trembëdhjetë kapituj, të cilët shënohen me numra, dhe kap një vëllim prej 109 faqesh (kam parasysh botimin e "Onufrit", Tiranë, 2004).

Bërthama e ngjarjes ka një shfaqje prej rreth dy muaj më parë, por shpërthimi i *suspensit* ndodh në një kontekst rrethor thuhet krejtësisht të ngjashëm me atë të *Nderit të humbur të Katerina Blumit* dhe pjesa intensive e veprimit edhe këtu pak a shumë kap intervalin prej disa ditësh.

Subjekti me pak fjalë është ky: Mariana, një punonjëse e re në një ndërmarrje socialiste, është e pashme, e bukur dhe e mençur. Pikërisht dinjiteti dhe krenaria e saj bëhen objekt tundimi për rrethin meskin e mediokër. Një mbrëmje me hënë, të qetë e të bukur, duke u kthyer nga një mbledhje kolektivi, shoqëruar nga njëri prej kolegëve, ajo merr guximin *fatal* të shqiptojë frazën pyetëse: "A është e vërtetë që burrat e kanë dashurinë më të fortë se gratë?". (Le ta lexojmë edhe këtë si një tundim dashurie të Katerinës!). Ky *mëkati* i parë i saj bëhet shkas dhe motiv që të shpërthejnë pastaj furtunat e vërsuljeve, të shpifjeve e të intrigave. Dhe shpërthimi ndodh pikërisht në mbrëmjen me rastin e fitimit të flamurit të garave socialiste prej ndërmarrjes ku ajo punonte.

9 Kuçuku, Bashkim: *Kadare në gjuhët e botës*, botimet "Onufri", Tiranë, 2000, f. 31/32.

10 Po aty, f. 33.

(Kujtoni *Mbrëmjen e Karnavaleve te Nderi i humbur i Katerina Blumit*). Qëllon që pikërisht bashkëshoqëruesi i saj pas Mbledhjes, është i sapofejuari i njërës prej kolegeve të saj. Këtu nis shkëndija e xhelozisë që i jep flakën smirës dhe intrigës, bashkë me pëshpërimat vrasëse. Jemi ende në kapitullin e parë dhe pozicioni i autorit-narrator është njësoj si te vepra e Bëlit, shumësi i vetës së parë: "Natyrisht që ne, në gjendjen që ishim, nuk i kapëm dot këto rryma të nëndheshme, të cilat, për hir të së vërtetës, duhet thënë se ishin vështirë të rrokshme në një mjedis të tillë si mbrëmja e vallëzimit, ku dihet se gjithçka është rrëmujë, të qeshura dhe vështirë plot nënkuptim" (kap. 1, f. 19/20).

Që këtu, pëshpërima shndërrohet në butafori dhe ysht reagimet në të gjitha nivelet e shoqërisë deri edhe te gazeta "Zëri i Popullit" (kujto *GAZETËN E SË DIELËS te Nderi i humbur i Katerina Blumit!*) dhe bëhet objekt hetimi për ndershmërinë, më saktë virgjërinë e Marianës, edhe për organizatën bazë të partisë (krahaso "krimin" hipotetik të Katerinës për shoqërim me Ludvig Gëtenin dhe të Marianës për shoqërimin me Gazmendin!).

Nderi i nëpërkëmbur i Marianës s'ka se si të shpëlahet veçse me dëshminë mjekësore të virgjërisë. Ajo e merr atë, por në çastin e fundit bën aktin final (lexo: krimin e madh) në vetëmbrojtje të nderit: gris raportin mjekësor copë e grimë. (Krahaso: Katerina vret Tëtgesin).

Nëntë muaj pas ngjarjes, pas dramaticitetit të "amoralitetit", Mariana lind djalin pa baba legjitim, pa fejesë, pa martesë: "Që nga shtrojet e bardha, ajo na vështronte të gjithëve e qetë, buzëqeshëse, kjo Shën Mëri e re që ishte shfaqur në kohën kur pritej më pak" (kap. 13, f. 109).

Boshti tematik është pothuajse po ai regjistër moral i Katerinës, nderi në përballje me nëpërkëmbësit e tij, përfaqësues të strukturave shoqërore, administrative e politike. Te Bëli: policë, hetues, avokatë, reporterë gazetash, prokurorë; te Kadare: sekretar partie, brigadierë, aktivistë politikë, kooperativistë, mjekë.

Të përfundojmë këtu me *rrjedhën tjetër*, me zërin oponent të intelektualit krijues: Gjesti i Kadaresë rezulton i barabartë me kokëkrisje. Mu në qerthullin e diktaturës komuniste që e kishte shpallur shtetin e vetëm, të parin e të fundit në botë: shtet ateist, të shqiptosh Lindjen e një Shën Mërie të re, që vetëkupton lindjen e një Krishti të ri, është herezia më e paimagjineshme politike në vitin 1985.

6 Faye, Erik: Parathënie te *Nata me hënë*, vepër e cttuar, f. 6.

7 Po aty, f. 6.

8 Shih: Çausi, Tefik: *Fjalori i estetikës*, Ombra GVG, Tiranë, 2005, f. 420 ("Fjalë e frëngjishtes që, sipas fjalorit të V. Kokonës, do të thotë prite me ankth e një ngjarjeje... Suspens quhet gjendja e asaj që rri pezull, zhvillimi i së cilës është ndërprerë përkohësisht, por në një mënyrë të atillë që gjendja e kërkon një rimarrje të procesit, për t'i gjetur fundin. Suspens është një veprim estetik në letërsinë rrëfimtare...").

PËRMBYS

Matanë dashurisë
Të gjitha gjërat janë përmbys
Si dikur
Pa diell pa hënë pa yje
Përmbys është qielli
Kur i mbyllim sytë
Kur dridhen puthjet
Dhe bota merr pamje tjetër
Përmbys është shpirti
Loja e shikimeve të ngrira
Shtegtimi i fundit i hijeve
Elegjitë për jetën
Rrokjet e fjalëve të ndaluara
Nata e parë pa ëndrra
Është po ashtu përmbys
Në jastëkun me pendla
Të verdha si vetmia
Të gjitha gjërat janë përmbys
Edhe rruzullimi i zjarrit
Akrepat e orës
Dy lumenjtë e një shtrati
Edhe shushurima e ujit
Është përmbys
Matanë dashurisë
Edhe dhimbjet plot metafora
Janë po ashtu përmbys
Dorëshkrimi i ngjallur
Molla e kafshuar
Tri ditë të lumtura
Janë përmbys
Si dikur
Pa diell pa hënë pa yje
Përmbys jam
Edhe unë
Përmbys jemi të gjithë

ROJTARI I DASHURISË

Unë jam si rojtari i dashurisë
I dua zogjtë kur nuk fluturojnë
(Të dua vetëm ty kur hesht e dashur)
I dua lulet kur nuk çelin
I dua fjalët kur nuk thuhet
I dua erërat kur nuk fryjnë
(Të dua vetëm ty kur buzëqesh e dashur)
E dua zjarrin tjetër të shpirtit
E dua shiun pa rënë mbi flokun tënd
(Të dua vetëm ty kur fle e dashur)
Unë jam si rojtari i dashurisë
Nuk urej natë pa hënë
Nuk urej gjumë pa ëndrra
Nuk urej dashuri pa vuajtje
(Të dua vetëm ty kur hesht e dashur)
Unë jam si rojtari i dashurisë

GJYSMËHIJA

Erdhi një natë veshur bardh
Shpirtndezur si zemërimi
Sytë mbushur me lot
Lëshoi një ofshamë pa fund
Dhe iku

Erdhi natën tjetër me shi
Me hapa të ngadalshëm
E lagur deri në fund të këmbëve
Nuk tha asnjë fjalë
Dhe iku

Të nesërmen u thurën legjenda
Për pagjumësinë e saj
Secili i besonte frikës së vet
Deri në ëndrën tjetër

KËTA JANË SI ATA

Këta janë si ata
Pastaj këta dhe ata
Rrokullisen deri në fundin e tyre
Pa kuptuar kurrë
Si vdiset
Duke i ruajtur ëndrrat nga liria
Ata janë si këta
Kur luajnë syhapur
Me vetveten

SALI
BASHOTA

edhe kur
nuk jam aty

poezi



TRI GJËRA VDESIN NGADALË

Thanë tri gjëra vdesin ngadalë
E para: dhimbja e bekuar
Kur mbaron rituali i shiut
Një natë me hënë

Thanë tri gjëra vdesin ngadalë
E dyta: vetmia e fjetur
Kur mijëra e mijëra kujtime
Mbahen ndër mend përgjithmonë

Thanë tri gjëra vdesin ngadalë
E treta: trishtimi i fjalëve
Kur bijnë gjetet e drunjve
Mbi shpirtrat tanë

Thanë tri gjëra vdesin ngadalë
Nëse nuk të them
Të dua

NJË DITË POSHTË JEMI TË GJITHË

Një ditë poshtë jemi të gjithë
Siç është toka
Siç janë lumenjtë
Siç janë detrat
Lart është qielli
Po ashtu edhe rrufeja
Është lart
Një ditë poshtë jemi të gjithë
Në fund të fundit
Si shkumbi ynë
I bukur

VETMIA E FREDERIK RRESHPIJES

Atë natë në Shkodër më pate thënë
Dashnia asht si zjarri
Kaluan vite e vite
I njëjti zjarr nderi dhimbjen tonë
Deri në pafundësi

Atë natë në Shkodër më pate thënë
Dashnia asht si andrra
Fjalët i mori dallga e detit
Pastaj erdhi prova e zjarrit

Atë natë në Shkodër më pate thënë
Dashnia asht si qielli i paanë
Të gjithë planetet u zgjuan nga gjumi
Kur doli Ylli i Mëngjesit

Atë natë në Shkodër më pate thënë
Dashnia asht si rrezja e diellit
Që bie mbi lumë
Pastaj me barkën e shpëtimit
Diqysh dolëm në breg

LEHTËSIA E DURUESHME E
PËRSHKRIMIT

Jo vetëm sytë e tu
Por edhe flokun
Ndoshta edhe gjumin pa ëndrra

Jo vetëm afshin tënd
Por edhe thellësinë e shpirtit
Ndoshta edhe heshtjen e trembur
Jo vetëm buzëqeshjen tënde
Por edhe dridhjen e qepallave
Ndoshta edhe pritjen
Jo vetëm fjalën e ëmbël
Por edhe shikimin e përflakur
Ndoshta edhe ngjyrat e dashurisë

KUJTESË

Çdo të hënë në mesnatë
Mbi sipërfaqen e tokës
Vijnë të buzëqeshur
Yjet që lindin e perëndojnë
Mësohemi me të njëjtin çast të heshtjes
Me të njëjtën dashuri mësohemi
Si Lasgush Poradeci
Mësohem me të njëjtat ëndrra
Si fluturat e natës
Dalëngadalë kur mbaron ofshama
Mësohemi me lojën e syve

GJYSMA E FJALËVE TË THËNA

E dashur
Merri gjysmën e fjalëve të thëna
Vendosi në sirtarët e shpirtit
Merre edhe pak buzëqeshje
Edhe pak mërzi
Mos i lë në heshtje
Në fund të javës vijnë poetët
Të lexojnë vargje për profilin tënd
Kështu vjen edhe lumturia
Në rrugët e Prishtinës
E dashur
Merre edhe pak zili
Dhe kujtoje çastin e ndritur
Kështu një ditë
Vjen edhe fundi
E dashur

DRITA E HËNËS

Lexues të dashur
Të dielen do të vijnë Vajtojcat e Rekës
Për besë në ëndërr
Më tha Ali Podrimja
Me vete do t'i marrin të gjitha baladat
Dhe një legjendë për Drinin e Zi
Dhe tingujt e lashtë të shqipës
Siç duket nuk kanë kohë të tepërt
Të rrinë nën dritën e hënës
Për besë në ëndërr
Më tha Ali Podrimja
Të dielen do flenë në Ulpianë

PËRMALLIMI I FUNDIT I BABAIT

(Për atë ditë kur ma dogjën shtëpinë dhe
bibliotekën, më 2 gusht 1998)

Përnjëmend e kam
Ti ke vuajtur shumë
Unë kam vuajtur pak
Vuajtja ishte art i bukur

Në secilën ditë

Përnjëmend e kam
Ti ke dashuruar shumë
Unë nuk kam dashuruar kurrë
Dashuria ishte dhimbje
Në secilin çast

Përnjëmend e kam
Ti ke zën hiena me dorë
Unë kam jetuar midis hienave
Jeta ishte iluzion i lumtur
Në secilën ëndërr

ENTUZIAZMI I SYVE TË KALTËR

Është e vërtetë
Sytë e kaltër janë si deti
Kur mbushen lot
I zë gjumi i vetmisë
Pa dremitur bashkë me qepallat
Është e vërtetë
Sytë e kaltër janë si qielli
Një natë u hidhëruan me yjet
Dhe e morën me vete
Dhimbjen e dashurisë
Është e vërtetë
Sytë e kaltër janë edhe si era
Kur zbardh drita
Ngadalë i tretin shikimet
Përtej peizazhit të panjohur
Është e vërtetë
Sytë e kaltër janë si gjithësia

DHOMA GJYSMË E ZBRAZËT

Të gjitha sendet e dobishme
Janë vendosur në njërin anë
Si dikur shenjat e buzëve
Në faqen e majtë
Në njërin anë
Sende të buta si pambuku
Në anën tjetër
Sende të padurueshme
Si mërzia
Mbi tavolinë
Orari i rregullave të lojës
Dhoma gjysmë e zbrazët
Ana tjetër e zymtë
Si hidhërimi i pritjes
Ana tjetër e ftohtë
Pa ndiesi shpirtërore
Ana tjetër e errët
Si pikturë abstrakte
Plot sende
Mbështetur një nga një për muri
Disa fjalë të harruara me dyshim
Pastaj rrethi i intrigave
Vazot e luleve të thara
Ku mungon e kuqja
Diku në fund të dhomës
Mungon edhe përmallimi i buzëqeshjes
E vetmja prekje
Në rendin simbolik të gjërave
Në të dy anët

SI NJË SHTRËNGATË

Kur nëna më lindi mua
Qielli ishte plot re të bardha
Vetëm një re e zezë
Ishte larguar në shenjë proteste
Bashkë me ngjyrat rebele të ylberit
Pesë javët e para nëna luante me jetën
Në spitalin e mushkërive në qytetin e Pejës
(Bjeshkët e Nemuna luanin me dhimbjen)
Kur i përfytyrohej bota tjetër
Apo çasti kur i krihte flokët para pasqyrës
Apo kur tri herë në ditë
Lëshonte nga një ofshamë pa fund
Pesë javët e para nëna luante me jetën
Në spitalin e mushkërive në qytetin e Pejës
(Bjeshkët e Nemuna luanin me dhimbjen)
Një imazh hiper-real i vetënjohes
Diçka si ekspresionizmi abstrakt
I gjërave me shpirt në fyt
Në shkallën zero të frymëzimit

Studioja e skulptorit DP, ndodhet në njërin nga ato rrugicat e spërdredhura dhe të ngushta si intimiteti, që kanë në të dyja anët porta të vjetra druri dhe kopshte me muzikë zogjsh dhe dekore stinësh...

Kjo rrugicë të shpie gjer lart te Qyteti Studenti dhe, vërtet në çastin kur mbërrita aty, studentët po ngjiteshin grupe - grupe, duke u fjalosur dhe duke qeshur potershëm herë pas here.

Sapo m'u shfaq përballë, te hyrja e studios së tij, DP m'u duk i shqetësuar, madje, i sëmurë. Eh, i shkreti artist, arsyetova me vete, pale çfarë pune ka në dorë dhe, i rri mendja aty ditë e natë, gjersa ta përfundojë. Kështu duhet të ishte, por a thua të më kishte thirrur me dëshirë dhe padurim, pikërisht për t'i shprehur ndonjë mendim për punën që kishte në dorë?

- E, - m'u drejtua, duke më vështruar me sytë e zmadhuar dhe, duke më zgatur dorën eshtake që i dridhej prerazi, si të kishte rënë në rrymë elektrike - a pyete njeri për të ta rrëfyer rrugën? Sa ke pa shkëlur këtu?

- Nuk kam shumë, jo.

S' ishte mirë, s' ishte mirë, ose më saktë, nuk ishte në atë gjendjen e rëndomtë të përditshmërisë rrjedhëse; ishte i kapur nga ethe dhe pashmangshme përndezëse dhe pickuese të krijimit. Por kishte edhe një lloj gjallërie, që nuk i përkiste as moshës dhe as tipit të tij. Dale dale...

- Është rrëmujë e madhe këtu, si gjithmonë, por një studio skulptori, nuk mund të jetë përveçse kështu. - m'u kthye me të hyrë brenda. E kur kishte ndodhur të mos ia shprehte këtë shfaqësim të panevojshëm kujtdo që i shkëlur në derë?

- Ja, edhe vaska e baltës; - vazhdoi - çdo herë ndiej nevojën ta përmend atë. Është e njëjta balta me atë që Krijuesi ynë përdori për të mburjtur njeriun e parë! - Dhe shpërtheu në një gaz të papërmbajtshëm, që e çeli dhe e solli në humor. - Ti vështro ca rreth e rrotull, ndërkohë unë po të zbuloj bustin e Gavril Darës. Ka filluar të bëjë vapë dhe, që të mos më plasaritet dhe, të më vejë dëm tërë mudi, e kam spërkatur rregullisht me ujë dhe e kam mbështjellë me pece dhe celofan gjithë merak. Nuk është një zbulim si ata të pëdurimeve; eh, ka ende mjaft punë, gjersa ta lëshoj por edhe të më lëshojë. Çfarë po këqyr?

- Këtë bocetin këtu, që nuk e pati fatin të kthehej në monument. Asgjë nuk më pëlqen më shumë se bocetet! Kur realizohen, kur zmadhohen pra, në përmasat e parashikuara për t'u ngritur aty ku u është përcaktuar vendi, shpesh zhgënjehem, kur i vështroj; nuk e gjej dhe nuk e ndiej më atë spontanitetin e të modeluarit, ato preket përplot drithërime të mollëzave të gishtave që nuk e kuptoj përse rrafshohen dhe humbin, nuk e gjej më as edhe atë fantazinë e fillimit në formë dhe lëvizje. Shkurt nuk emocionohem dhe, kësaj largohem i pakënaqur.

E mbaj mend historinë e këtij boceti me këto tri vajzat e hazdisura. Erdhën e ta panë këtu në studio ata idiotët e komisionit, me në krye një anëtar të Byrosë, po po; një ish kovaç dhe, të kritikuan rëndë për gabimet ideologjike dhe politike të krijimtarisë tënde. Këto tri vajzat, të shfrynë me ton hakërrues, që kinse po rendin gjysmë të zhveshura, nuk mundën ta këndojnë kursesi Internacionalen, fjala vjen. Pastaj, ç'është ky shuk balte që po na vë përpara, bocet? Ti nuk qenke as serioz! Përse e kërkove komisionin kur nuk paske qenë gati...

I mbaj mend, i mbaj mend të gjitha; kemi biseduar gjerë e gjatë bashkë atëherë, harrove? Por të mos e zgjatim, sepse nuk dua të lëndohesh për së dyti.

- O, nuk lëndohem aspak. Kanë kaluar dhjetë vite tashmë. Ngjarjet, sado të rënda që të kenë qenë, zh dramatizohen kur kalon një kohë e gjatë, madje, nganjëherë aq shumë, sa nuk i tregon dot me seriozitet. Por ajo ngjarje, për pak më rroposi një herë e mirë. E ç' prisi ju nga burri i ruses, nxituan të helmonin opinionin ziliqarët e patalentuar,

KONSTANDIN DHAMO

Në studion e skulptorit DP

Tregim

duke ua rikujtuar të gjithëve origjinën e ish bashkëshortes sime. Ç't'u thoshe; gruaja ime e dashur kishte pesëmbëdhjetë vite që kishte ikur në punë të saj, në Leningrad, por atyre u interesonte ta përmendnin dhe ta aktualizonin martesën time me të. Në atë kohë ndjenja muaj e muaj të tërë pa prekur baltë me dorë, madje nuk vija as këtu në studio dhe nuk vizatoja as në shtëpi, duke besuar seriozisht se, nuk do të bëja kurrë më skulpturë. Por, si po të duket Gavrilin ynë? Hidhi një sy. Mos harro se, do ta çojnë në Itali, te fshati i tij i lindjes!

- Fytyra e tij që tani ka psikologji dhe karakter. Dhe, të ndjek me vështrimin e tij dhe të ndal. Por, sa të pikëlluar këta poetët arbëreshë, sa të pikëlluar! Është mesa duket, pikëllimi që i kaploi stërgjyshët e tyre me të lënë Arbërinë, pikëllim dhe dhembje që përçohet edhe sot e kësaj dite me të njëjtin densitet brez pas brezi...

- Seriozisht po flet?

- Të paktën në ndonjë shkrim në gazetë, kështu do të isha shprehur.

- Megjithatë, duken të kenë qenë burrërorë dhe konsekuentë.

- Ah, balta balta!

- Ç'ke me baltën...

- Por nuk më ke ftuar pikërisht për të më treguar Gavrilin, kështu?

- As unë vetë nuk e di se, për çfarë të kam ftuar pikërisht, por njeriu ka nevojë për gjithçka nga një mik. Ti je më i ri se unë por shpesh më jep këshilla shumë të dobishme.

- Ah; ja ku ta zëvendësova mjekun e përkorë të familjes! - e shpota dhe vazhdova: - Më ke thënë se, del vazhdimisht të dera e studios kur pushon ca dhe, pi cigare, duke ndjekur njëherësh me ëndje ecejaket e pashtershme të studentëve?

- Ah, sa me nostalgji të thekshme i ndjek! Çlodhem, kthjellohem dhe, marr pak ajër. Por, tjetër racë studentësh kemi qenë, fjala vjen ne dikur. Ajo pirja e cigares aty, te dera, është refreni që më shkëput sado pak nga orët e lodhshme të krijimit. Por, sa femra të bukura kalojnë herë pas here! Do ta kthejmë nga një gotë? Mbjaj raki të mrekullueshme unë këtu në studio, siç e di edhe zotrote. Me ata kolegët e mi, as rrihet dhe as bisedohet. I ka rrëgjuar dembelia dhe veçse zëdhallen kafeneve.

- Gëzuar dhe suksese! - e urova, kur ma mbushi gotën dhe rrëkëlleva një hurbë të mirë.

- I shoh ato femrat, por tashmë duhet thënë i shihja ato femrat që kalonin e kalonin përpara studios dhe, një ditë prej ditësh ndava njërin prej tyre, ashtu si edhe ai gjuetari sqimëtar, që e ndan njerën drenushë nga shoqet. Fillova t'i buzëqesh nga pak, por ndjellshëm që t'i tërhiqja gjithsesi vëmendjen, por kaq; nuk po përpara. Vendosa të vishesha më hijshëm, të krihesha e të rruhesha rregullisht, për t'u dukur ca më i ri dhe më tërheqës. Por iu ktheva vetes shpejt: ik or' spitullaq i drejt, se do të bëhesh qesharak. Dhe ja, vazhdova të dilja përsëri te dera kështu si murator.

- Pa shih pa shih, ç'u bëka këtej; dhe...

- Dhe, kur nuk ta mban, nuk ndodh asgjë interesante.

- Por ama nuk rrezikon, ndonëse sakaq squleshe dhe bjerresh.

- Posi posi; ajo, siç duket, argëtohej si të gjitha femrat e botës me ngërçin tim dhe, një

ditë, që nuk vonoi, ma ktheu buzëqeshjen përshëndetëse me kurajë dhe e vendosur.

Nuk vishet me shije dhe rrobat i ka mjaft të përdorura, për të mos thënë ndonjë fjalë tjetër, por ecën bukur, oh, pa dyshim bukur dhe ngacmueshëm. Beson, ka hundë të madhe, por jo të shëmtuar, sepse i harmonizohet për mrekulli mes atyre syve gri të mençur dhe faqeve të tërhequra.

E ngordhalaq që të mbytet me atë duhmën e shpifur të duhanit, iu gërmusha vetes, jepi tani, kuturis! Por kuturisi ajo. Më hyri në studio. Dje pra, dje. Po thithja si i babëzitur cigaren e tretë radhazi aty te dera, si të isha endacak; hahaha, kur ajo kaloi pranë meje, si gjithmonë së bashku me disa studentë të tjerë. Mbante një dosje të trashë, e mbante të mbështetur pranë zembrës, le të themi, mu si ato stakhanovistet e pllakateve që mbajnë veprat e shokur Enver dhe...

- Bobo, sa argëtohesh ti me këto krahasime të zararshme! Por mos harro se, edhe ato pllakatet ju i ideoni dhe i realizoni.

- Po po; dhe kur u shkëput nga grupi për të ardhur tek unë, vura re se, kishte një gjoks të përpjetë dhe arrogant. Si je, m'u drejtua në njëjës për afëri sigurisht, jo për mungesë mirësjelljeje dhe, më zgjati dorën. Nga mënyra sesi e ruajti buzëqeshjen, kuptova rrëmbyeshëm se, e pranonte trillin dhe aventurën. E kisha parë përherë pothuajse veçse në profil dhe, ashtu përballë m'u duk si tjetër njeri. Prit; edhe gojën e kishte të madhe, por femrave u shkon goja e madhe, ndoshta ngaqë buzët i kanë me forma më të plota. Për shembull, e ke parasysht Sofia Loren-in? Ha ha ha!

- Hë, ja u rrëfeve...

- Patjetër; kur rrëfeshesh, sikur mëson edhe se çfarë të bësh në vazhdim.

Kam shumë kureshtje të shoh një studio, u hap ajo; nuk kam parë ende ndonjë gjer më sot. Urdhëro, i thashë dhe i hapa udhë. Në këmbë kishte mbathur një palë gjysmësandale a gjysmëkëpucë, nuk di ta saktësoj, por kërcinjtë i kishte të gjatë dhe me pulpa të ngjeshura. Me të hyrë brenda, nisi të shohë bustet dhe kokat në të katër anët e studios dhe, një çast, m'u duk se u shantazhua nga gjithë ata sy që iu ngulën befaz njëherësh. I ndjeva erën e djersës, një erë të lehtë, në



fakt po të kishe parasysht se, ajo, patjetër që ishte kapluar nga emocioni dhe, veç kësaj vinte edhe drejt e nga rruga përplot diell, por unë, prej asaj ere, e thashë, të lehtë dhe të natyrshme, u kujtova dhe u ndërgjegjësova se, në studion time kisha një njeri të vërtetë, madje një femër, gjithë hire dhe zjarre rinie!

- Më rrëqethe...

- Përpara syve të saj, as pozoje dhe as shtireshe dot.

- Ndonëse e ke takuar veçse dje, ke menduar dhe ke ëndërruar aq shumë për të, sa ke shkuar disa muaj përpara. I premtove t'i bësh ndonjë portret, apo ndonjë shtatore, që do të quhej Aksionistja, apo Studentja?

- Çdo gjë nga këto që përmende ti mund të ndodhë. Dreqi ta hajë; nuk më hyri në studio armiku i klasës! Ma humbe fillin; e pra, mjaftoi thjesht ardhja e saj në studio që të të them i bindur se, filloi një periudhë e re e krijimtarisë sime; kam nxitje dhe vullnet për të punuar më me frymëzim dhe i shoh qartë ditët që do të vijë dhe, entuziazmohem. Çfarë efekti të menjëherëshëm më bëri ajo femër; o, i jam mirënjohës!

- Nuk shpëtojme dot ne nga perifraximet e teksteve të sloganeve. Dëgjo profesor, sikundër edhe je; atë periudhën e re të krijimtarisë tënde artistike, të periudhës sime, po të duash ti, apo të kujdo tjetër artisti apo shkrimtari shqiptar, e ka në dorë ekskluzivisht vetëm Partia, me plenumet dhe direktivat e saja. Ty të takon vetëm të presësh dhe më pas t'i pasqyrosh drejtpërdrejt këto mësimet të vyera në punët e tua. Çfarë diskutuam ne qëparë për atë bocetin e atyre vajzave që i kishte zënë pranvera? Sa naiv bëhet njeriu, kur bie në dashuri, qoftë edhe për të dhjetën herë...

- The atë që pate merak; unë nuk do të ndërroj stil dhe, sigurisht që nuk do të përqafoj ndonjë izëm dekadent; të pëlqen kështu? Thashë me sinqeritet se, tani e tutje do të ngulem përsëri në studio nga mëngjesi deri në mbrëmje.

- Folët shumë?

- Po, u bëmë llafazanë të dy dhe nuk lamë gjë pa e pyetur njëri - tjetrin.

- Mirë mirë, por do të të trokasim dhunshëm te dera ndonjë ditë dhe, do të futen drejt e brenda ata të këshillit të lagjes, pensionistët apo veteranët me xhaketa ushtarake pa spaleta si robërit e luftës, do të ta gjejnë të vluarën me brekë apo, mos e pyet, nudo, duke pozuar gjithë naze dhe, do të të marrin në qafë përfundimisht; fut femra të përdala në studion e shtetit, do të të akuzojnë.

- Ajo gruaja ime ruse, të cilën e njoha pak a shumë në të njëjtën rrethanë, që njoha edhe këtë shqiptaren tonë, kur ishte studente edhe ajo dhe, na kalonte çdo mëngjes përpara atelieve, gruaja ime e dikurshme ruse pra, që nuk dua t'ia zë emrin në gojë, sepse tronditem, po bën jetën e vet prej shumë vitesh atje në Leningradin e largët, me agime borealë kaleodoskopikë, pa u ngacmuar dhe pa u shqetësuar prej askujt: as letra as fotografi, as telefonata dhe, as bëhet e çnuk bëhet...

Atëherë, çfarë pres unë këtu në Tiranë, vetmitar si të isha asket? A jam apo nuk jam i divorcuar zyrtarisht? Kjo studentja ime na qenkësh në vit të fundit, paskësh punuar edhe nja tre vite si mësuese në fshat para se t'i dilte e drejta e studimit, kështu që edhe në më shkrepë të marr, të martohem, desha të them, por mezi më dalin disa fjalë përcaktuese, nuk do të kemi ndonjë ndryshim moshe kushedi se çfarë. Sa vajti ora? Oho, a e di ti që, pas pak, ajo do t'ia behë këtu? Ata veteranët me uniformat pa grada nuk kanë çfarë të më bëjnë më, dëgjove?

E shkreta vajzë! Ku ta dish, këtë herë do të ketë hedhur pak parfum në trup dhe, do të ketë veshur edhe ndonjë bluzë që do t'ia ketë marrë hua shoqes së dhomës! Sepse ndoshta nuk e di ende që u bë e imja qoftë edhe me atë erën e lehtë ndjellëse të një njeriu të njëmendtë...

1.

Nga të gjitha sekretet e botës, ai i krijimit ka qenë që nga fillimi më i mistershëm. Kjo është arsyeja pse popujt dhe fetë gjithmonë e kanë lidhur fenomenin e krijimit me idenë e hyjnisë. Se, nëse mund ta kuptojmë plotësisht atë që ekziston si fakt, atëherë çdo herë do të kemi një ndjesi të së mbinatyrshmes, hyjnore, kur diçka shfaqet papritur aty ku më parë s'kishte gjësend - si lindja e një fëmije, ose kur nën mbulesën e natës një lule shpërthen papritur nga toka e zhveshur. Por aty ku mrekullia jonë është më e madhe, më e prirë drejt nderimit dhe, mund të them më e shenja, është kur kjo gjë e porsalindur nuk është kalimtare, kur nuk venitet si lulja, nuk vdes si qenia njerëzore, por mbijeton gjatë gjithë kohës, e përjetshme si qielli, toka, deti, dielli, hëna dhe yjet, veprimet e të cilave nuk janë të njerëzimit, por të perëndive.

Kjo habi e përjetshme se diçka mund të lindë nga asgjëja dhe megjithatë të sfidojë kohën, ndonjëherë na lejon të ekzistojmë në një sferë tjetër: atë të artit. Ne e dimë se çdo vit prodhohen 10,000, 20,000, 50,000 libra. Jemi të vetëdijshëm se krijohen 10,000 piktura; kompozohen një milion ritme muzikore. Asnjë nga këto nuk është shkak për surprizë për ne. Që shkrimtarët dhe poetët të shkruajnë libra na duket po aq e natyrshme sa fakti që librat shtypen nga shtypshkronjat, libërlidhen nga shtypshkronjat, shiten nga shitësit e librave. Është thjeshtë fenomen i prodhimit, jo ndryshe nga pjekja e bukës, qepja e këpucëve ose çorapeve. Shenja e parë e një mrekullie është kur një nga këto libra, një nga këto kanavacë, për shkak të gjendjes së saj të përsosmërisë, jeton më gjatë se epoka në të cilën lindi dhe më pas shumë epoka të tjera. Në këtë rast, dhe vetëm në këtë rast, ne ndiejmë se gjenialiteti është mishëruar në një njeri të caktuar dhe se misteri i krijimit riprodhohet në një veper. Është një mendim prekës: ja ku është një njeri i krijuar njësoj si çdo tjetër; ai fle në një shtrat, ha në një tavolinë, është i veshur si pjesa tjetër prej nesh. E kalojmë pranë në rrugë; ndoshta ishim në shkollë bashkë, ishim ulur në të njëjtën bankë; asgjë nga jashtë nuk sugjeron se ai është ndryshe nga ne dhe megjithatë papritmas këtij njeriu i ndodh diçka që i mohohet pjesës tjetër prej nesh. Ai e ka thyer atë ligj që na mban të gjithëve nën magji, ai ka pushtuar kohën; dhe ndërsa ne zhdukemi, pa lënë gjurmë, ai vazhdon. Dhe pse? Në mënyrë unike sepse ai e kreu këtë akt hyjnor të krijimit ku diçka lind nga asgjëja dhe ajo që zakonisht është kalimtare në këtë rast ndodh të vazhdojë. Sepse në shfaqjen e tij zbulohet sekretin më i thellë i botës sonë: sekretin e krijimit.

2.

Çfarë ka arritur një njeri i tillë? Merrni pjesën e jashtme. Ai, nëse do të ishte muzikant, ka zgjedhur një përzierje notash nga diapazoni tonal dhe i ka grupuar ato në një mënyrë të veçantë për të sjellë një melodi që ka dhuratën e rezonancës emocionale me qindra mijëra dëgjues, duke i trazuar përgjithmonë shpirtin e miliona njerëzve në kontinentet më të largëta. Nëse ai është piktor, atëherë me ndihmën e shtatë ngjyrave të spektrit dhe alternimit të dritës dhe hijes, ai krijon një pikturë e cila, pasi ta kemi parë, projektohet thellë në shpirtin tonë. Nëse ai është poet, ai ka marrë disa qindra fjalë nga 50,000 ose 100,000 fjalë nga të cilat përbëhet gjuha jonë, dhe i ka mbledhur ato në një mënyrë të tillë që ato përbëjnë një poemë të pavdekshme. Ose po të jetë dramaturg, një rrëfimtari përmes formave të ndryshme, ai ka krijuar personazhe që na duken aq të njohur sa mund të jenë edhe vëllezër ose miq, njerëz që - si ai - zotërojnë fuqinë hyjnore për të mbijetuar kohën. Përmes këtij akti të jashtëm, ai e ka përmbysur ligjin e natyrës: ka farkëtuar një substancë që sfidon vdekjen. Nga një tingull në ajër, ai ka formuar diçka që na prek thellë, diçka shumë më të qëndrueshme se druri ose guri i kësaj shtëpie. Tek ai qëndron e pavdekshmeja dhe - mund ta

Stefan Zweig sekreti i krijimit artistik

Përktheu dhe përgatiti Xhevair Lleshi

themi me besim - hyjnorja zbulohet përmes tokësorës.

Megjithatë, **me çfarë mjetesh** e ka arritur kjo qenie e vetmuar këtë mrekulli? Me çfarë mjetesh ai dhe vetëm ai, midis miliona njerëzve, duke përdorur të njëjtat materiale të disponueshme për të gjithë, gjuhën, ngjyrën, tingullin, e ka krijuar veprën e tij të artit? Çfarë është kjo forcë sekrete me të cilën është pajisur ai? Si krijon artisti i vërtetë? Si mund të shfaqet një mrekulli i tillë ende në një botë pa perëndi?

Unë besoj se të gjithë ne në një moment apo në një tjetër e kemi bërë këtë pyetje vetes, qoftë duke qëndruar para kanavacës së një mjeshtri të vjetër, qoftë kur një varg poezie prek thellësitë e shpirtit tonë, qoftë duke dëgjuar të magjepsur një simfonie nga Mozarti ose Beethoveni. Mendoj se të gjithë e kanë pyetur veten me habi të madhe, dhe pikërisht për shkak të kësaj habie, se si një individ i vetëm mund të prodhonte këtë veper mbinjerëzore. Dhe madje do të guxojta të thosha se kushdo që qëndron para një vepre arti dhe *nuk* i ngre këto pyetje, nuk habitet me konfigurimin e tyre sekret, nuk ka asnjë marrëdhënie kuptimplote me artin dhe kurrë nuk do ta ketë. Është elementi më i mirë i zemrës sonë njerëzore të preket nga madhështia dhe misteri i këtyre veprave dhe është elementi më i mirë i shpirtit njerëzor për ta zbuluar këtë mister. Kushdo që kërkon një marrëdhënie të duhur me këto vepra duhet ta bëjë këtë me një ndjenjë të dyfishtë. Ai së pari duhet të pranojë me përlulësi se ato ekzistojnë përtej aftësisë së tij, përtej jetës kalimtare. Por në të njëjtën kohë ai duhet të përpiqet me mendim të fuqishëm për të kuptuar se si kjo shkëndijë hyjnore e brendshme mund të ndodhë në domenin tonë tokësor. Ai duhet të përpiqet të kuptojë të pakuqshmen.

3.

